



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 46

Tiranë – E hënë, 30 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 17/2015 datë 5.3.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për programin e reformimit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës – faza II..... 1957
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2, datë 13.3.2015	Për plotësimin e standardeve të përgjithshme bazë në sigurinë e aviacionit civil të përcaktuara në aneksin e udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”..... 1984
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3, datë 13.3.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil” në fushën e aerodromeve, menaxhimit të trafikut ajror dhe shërbimeve të lundrimit ajror..... 1989
Urdhër i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 33, datë 25.2.2015	Për miratimin e rregullores “Mbi kërkesat për vlerësimin dhe zbatimin e ndryshimeve që lidhen me sigurinë në shërbimet e trafikut ajror”..... 2003
	Ndreqje gabimi..... 2010



LIGJ
Nr. 17/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
KUADËR TË FINANCIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT
TË EUROPËS PËR PROGRAMIN E
REFORMIMIT TË QENDRËS
SPITALORE UNIVERSITARE TË
TIRANËS – FAZA II

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja kuadër e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për programin e reformimit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës – faza II, nëpërmjet një huaje prej 15 930 000 eurosh dhe një granti prej 1 500 000 eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.3.2015

Shpallur me dekretin nr. 9000, datë 19.3.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

LD 1841 (2014)
LLDS-7-TA (2014)

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM
TË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR
PROGRAMIN E REFORMIMIT TË
QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE TË
TIRANËS – FAZA II

Banka për Zhvillim të Këshillit të Europës, një organizatë ndërkombëtare me seli në adresën 55, Avenue Kléber, F-75116 Paris (Francë) (më poshtë

e referuar si “CEB” ose “Banka”), nga njëra anë, dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave (më poshtë i referuar si “Huamarrësi” sipas Huas (të përcaktuar më poshtë) ose “Vendi Përfitues” sipas Grantit të LLDS-së (të përcaktuar më poshtë) dhe së bashku me CEB, “Palët” dhe individualisht të referuara si “Palë”), nga ana tjetër.

Duke marrë në konsideratë se:

A) Në bazë të kërkesës për hua dhe kërkesës për grantin e LLDS-së, të paraqitur nga Republika e Shqipërisë si shtet anëtar i CEB-it në datën 22 maj 2014, të miraturar nga Këshilli Administrativ i CEB-it në datën 13 qershor 2014;

B) Duke pasur parasysh Protokollin e Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet të Këshillit të Europës, të datës 6 mars 1959;

C) Duke pasur parasysh Rregulloren e Huas të CEB-it, të miraturar nga Rezoluta 1562 e Këshillit Administrativ të CEB-it (2013) (më poshtë e referuar si “Rregullorja e Huas”);

D) Duke pasur parasysh Politikën e Financimit të Projektit dhe Huas të CEB-it (më poshtë e referuar si “Politika e Huas”), të miraturar nga Rezoluta 1562 e Këshillit Administrativ të CEB-it (2013);

E) Duke pasur parasysh Politikën Mjedisore të CEB-it të miraturar nga Rezoluta 1530 e Këshillit Administrativ të CEB-it, (2010) (më poshtë e referuar si “Politika Mjedisore”);

F) Duke pasur parasysh Udhëzimet e Prokurimit të CEB-it të miraturar nga Këshilli Administrativ i CEB-it në muajin shtator 2011 (më poshtë të referuara si “Udhëzimet e Prokurimit”).

G) Duke pasur parasysh Politikën e CEB-it mbi Llogarinë e Dividendëve Socialë (më poshtë e referuar si “LLDS”), të miraturar nga Rezoluta 1554 e Këshillit Administrativ të CEB-it (2013) (më poshtë e referuar si “Politika e LLDS-së”);

H) Duke pasur parasysh Politikën e LLDS-së, Këshilli Administrativ i CEB-it ka miraturar në bazë të miratimit të tij të Projektit në datën 13 qershor 2014, një kontribut granti nga LLDS-ja për në Vendin Përfitues në një shumë totale maksimale prej 1,500,000 eurosh (më poshtë i referuar si “Granti i LLDS-së”) për financimin e asistencës teknike të nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e Projektit, siç përcaktohet hollësisht më poshtë në



shtojcën 5 të tij (më poshtë e referuar si “Asistenca Teknike e Projektit”);

I) Duke pasur parasysh vendin përfitues, pas dhënies së pëlqimit të plotë për Grantin e LLDS-së dhe për zbatimin e Projektit dhe Asistencës Teknike të Projektit që parashikohen në këtë Marrëveshje,

si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

1. INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Termat e mëposhtëm kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

“Marrëveshje” nënkupton këtë marrëveshje kuadër financimi, duke përfshirë shtojcat e saj.

“Alokim” nënkupton: i) në kontekstin e Huas angazhimit e një Transhi të Huas nga Huamarrësi për pjesët e pranueshme përbërëse të Projektit të përcaktuara sipas shtojcës 1 edhe nëse ky Transh Huaje nuk është paguar ende sipas Projektit; dhe ii) në kontekstin e Grantit të LLDS-së angazhimit e një Transhi Granti nga Vendi Përfitues për aktivitetet e pranueshme të Asistencës Teknike të Projektit A të përcaktuar sipas shtojcës 5, edhe nëse ky Transh Granti nuk është paguar ende sipas Asistencës Teknike të Projektit.

“Periudha e Alokimit” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 6.2.

“Ditë Pune” nënkupton:

Në lidhje me pagesat në euro, çdo ditë në të cilën operon TARGET 2 (Sistemi i Transferimit Ekspres të Automatizuar Transeuropian të Shlyerjes Bruto në Kohë Reale).

“Datë e Mbylljes” nënkupton datën 30 shtator 2019, e cila është data: i) e përcaktuar sipas shtojcës 1 (Përshkrimi i Projektit) të kësaj Marrëveshjeje nga e cila nuk mund të kërkohej disbursime të mëtejshme nga Huaja nga ana e Huamarrësit; dhe ii) të përcaktuar sipas shtojcës 5 (Përshkrimi i Asistencës Teknike të Projektit) të kësaj Marrëveshjeje nga e cila nuk mund të kërkohej disbursime të mëtejshme nga Granti i LLDS-së nga Vendi Përfitues.

“Raport Përfundimi” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 7.1.

“Monedhë” nënkupton, për qëllimet e Marrëveshjes, euron.

“Marrëveshje e Përcaktimit të Interesit të Shtuar” nënkupton marrëveshjen për përcaktimin e interesit të shtuar midis dy datave dhe numrin e Faqe | 1958

ditëve në një vit të përcaktuar në njoftimin përkatës të disbursimit.

“Instrument Borxhi” nënkupton: i) çdo hua ose formë tjetër të borxhit/detyrimit financiar; ii) një instrument, duke përfshirë ndonjë faturë ose pasqyrë llogarie që provon ose përbën detyrim për shlyerjen e një huaje, depozite, parapagimi ose shtyrje të ngjashme huaje (duke përfshirë pa kufizim, ndonjë shtyrje huaje sipas një marrëveshjeje rifinancimi ose riskedulimi); iii) obligacion, notë, garanci borxhi, dëftesë borxhi ose provë tjetër të ngjashme të borxhit financiar; ose iv) një instrument që provon një garanci të një detyrimi që përbën borxh financiar të një tjetri.

“Normë Kamatëvonese” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.9.

“Datë Disbursimi” nënkupton datën në të cilën një Transh planifikohet të disbursohet sipas një Njoftimi të zbatueshëm Disbursimi.

“Njoftim Disbursimi” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.3 (b).

“Kërkesë Disbursimi” nënkupton, siç e kërkon konteksti ose një Kërkesë për Disbursim Granti ose një Kërkesë për Disbursim Huaje.

“Konfirmim i Parakohshëm Rimbursimi” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.7.

“Kosto e Parakohshme Rimbursimi” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.7.

“Datë e Parakohshme Rimbursimi” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.7.

“Njoftim i Parakohshëm Rimbursimi” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.7.

“Datë e Hyrjes në Fuqi” nënkupton datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes që rrjedh nga Klauzola 18.

“BE” nënkupton Bashkimin Europian.

“Direktivat e BE-së mbi Prokurimin” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 6.5.

“EURIBOR” nënkupton nivelin e përqindjes në vit (të rrumbullakosur, nëse është e nevojshme, me njëqind të mijtën e ardhshme të një pikë për qind, me gjysma të rrumbullakosura) të kuotuar në faqen e Rojter-it EURIBOR01 (ose në një faqe të ardhshme që zëvendëson faqen e Rojter-it EURIBOR01) në ose rreth orës 11 paradite me kohën e Brukselit në Datën e Caktimit të Interesit si normën e Federatës Bankare të BE-së për depozitat me afat në Euro në tregun ndër-bankar të BE-së për të njëjtën



periudhë si Periudha përkatëse e Interesit.

Nëse Periudha përkatëse e Interesit nuk është e njëjtë si një periudhë e kuotuar nga Rojter, EURIBOR i zbatueshëm do të jetë niveli i përqindjes në vit që rrjedh nga një interpolim linear duke iu referuar dy (2) normave të EURIBOR-it për depozitat me afat në euro, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë të muajve të plotë më të shkurtër pasues dhe tjetra për një periudhë të muajve të plotë më të gjatë pasues sesa kohëzgjatja e Periudhës përkatëse të Interesit.

“Euro” dhe shenja “EUR” nënkupton monedhën e ligjshme të shteteve anëtare të BE-së, të cilat e miratojnë herë pas here si monedhën e tyre në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktatit të BE-së dhe Traktatit mbi Funkzionimin e BE-së ose traktatet e tjera pasardhëse.

“Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut” nënkupton Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të datës 4 nëntor 1950, CETS n° 5, të ndryshuar herë pas here.

“Karta Sociale Europiane” nënkupton Kartën Sociale Europiane të datës 3 maj 1996, CETS n° 163, të ndryshuar herë pas here.

“Përfituesit Përfundimtarë” përcaktohen sipas shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje si grupi që përfiton nga ndikimet sociale të Projektit.

“Normë Fikse Interesi” nënkupton normën e interesit në vit të përcaktuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Normë e Ndryshueshme Interesi” nënkupton normën e interesit në vit të përcaktuar me anë të shtesës ose zbritjes së Marzhit të përcaktuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit për ose nga, sipas rastit, Norma Referuese.

Për shmangien e dyshimit, kur përcaktimi i një Norme të Ndryshueshme Interesi rezulton në një normë negative interesi (për shkak të një Norme të kuotuar negative Referuese, për operimin e një Marzhi që zbritet nga Norma Referuese ose për rrethana të tjera), interesi që duhet të paguhet nga Huamarrësi për Periudhën e Interesit do të konsiderohet zero.

“Kërkesë për Disbursimin e Grantit” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklausolës 4.3 (a).

“Transh Granti” nënkupton një shumë të disbursuar ose që duhet të disbursohet nga Granti i LLDS-së.

“Data e Caktimit të Interesit” nënkupton, për qëllime të përcaktimit të një Norme të Ndryshueshme Interesi, ditën që bie dy (2) Ditë Pune para ditës së parë të Periudhës së Interesit, nëse nuk përcaktohet ndryshe në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

“Datat e Pagesës së Interesit” nënkupton datat për pagesën e interesit që i korrespondojnë Periudhës përkatëse të Interesit të përcaktuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Periudhë Interesi” nënkupton periudhën që fillon në një Datë Pageze Interesi dhe që përfundon në ditën që bie menjëherë para Datës së mëpasshme të Pagesës së Interesit, me kusht që Periudha e parë e Interesit e zbatueshme për secilin Transh të fillojë në Datën e Disbursimit dhe të përfundojë në ditën që bie menjëherë para Datës së ardhshme të Pagesës së Interesit.

“Hua” nënkupton Huan e dhënë Huamarrësit nga CEB me anë të Marrëveshjes.

“Shumë Huaje” nënkupton shumën e përcaktuar sipas nënklausolës 4.1.

“Kërkesë për Disbursimin e Huas” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklausolës 4.3 (a).

“Transh Huaje” nënkupton një shumë të disbursuar ose që duhet të disbursohet sipas Huas.

“Situatë e Mosfunksionimit të Tregut” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklausolës 4.10.

“Ndryshim Material Negativ” nënkupton çdo rast që, sipas mendimit të CEB-it: i) dëmton materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij financiare sipas Marrëveshjes; ose ii) ndikon negativisht te ndonjë Garanci e dhënë nga Huamarrësi ose një palë e tretë për të siguruar përmbushjen e duhur të detyrimeve financiare të Huamarrësit sipas Marrëveshjes.

“Datë Maturimi” nënkupton Datën e fundit të Shlyerjes së Principalit për secilin Transh të përcaktuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Marrëveshje e Ditës Pasuese të Punës të Ndryshuar” nënkupton një marrëveshje me anë të së cilës nëse një datë e caktuar do të binte në një ditë që nuk është Ditë Pune, kjo datë do të ishte dita e parë e ardhshme që është Ditë Pune nëse ajo ditë nuk bie në muajin e ardhshëm kalendarik, dhe në këtë rast ajo datë do të ishte dita e parë pararendëse që është Ditë Pune.



“Datë (a) e Shlyerjes së Principalit” nënkupton datën(at) për shlyerjen(t) e principalit sipas secilit Transh të përcaktuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Periudhë e Shlyerjes së Principalit” nënkupton në lidhje me secilin Transh, periudhën që fillon nga Data e Disbursimit të tij deri në Datën e Maturimit.

“Raport Progresi” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 7.1.

“Praktika të Ndaluara” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 6.8.

“Projekt” nënkupton skemat e investimeve të pranueshme të përcaktuara sipas shtojcës 1 që duhet të financohen pjesërisht me Huan miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it me ref. LD 1841 (2014).

“Llogari Projekti” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.2.

“Agjenci e Zbatimit të Projektit” (më poshtë e referuar si “AZP”) nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë si entin juridik që, me delegim të Huamarrësit, është përgjegjëse për zbatimin e Projektit dhe Asistencës Teknike të Projektit.

“Njësi e Zbatimit të Projektit” (më poshtë e referuar si “NJZP”) nënkupton ekipin e caktuar nga AZP-ja në ngarkim të menaxhimit ditë pas dite të Projektit dhe Asistencës Teknike të Projektit të përcaktuar sipas klauzolës 6.

“Asistencë Teknike e Projektit” nënkupton aktivitetet e pranueshme të përcaktuara sipas shtojcës 5 që duhet të financohen me Grantin e LLDS-së të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it me ref. LLDS-7-TA (2014) në mbështetje të Projektit.

“Situatë e Planifikuar e Progresit të Punimeve” nënkupton: i) në kontekstin e Huas, raportin e shpenzimeve të pranueshme për të gjitha pjesët përbërëse, ndaj kostos totale të pranueshme të Projektit të përcaktuar sipas shtojcës 1, ku shpenzimet e pranueshme përfshijnë shpenzime të ndodhura, si dhe ato që pritet të ndodhin për një periudhë të caktuar kohe që nuk tejkalon gjashtë (6) muaj nga data e Raportit të fundit të Progresit; dhe ii) në kontekstin e Grantit të LLDS-së, raportin e shpenzimeve të pranueshme për të gjitha aktivitetet, me koston totale të pranueshme të Asistencës Teknike të Projektit sipas shtojcës 5, ku shpenzimet e pranueshme përfshijnë shpenzimet e ndodhura, si dhe ato që pritet të ndodhin për një periudhë të caktuar kohe që nuk tejkalon gjashtë (6)

muaj nga data e Raportit të fundit të Progresit.

“Normë Referuese” nënkupton EURIBOR-in për një Transh me Normë të Ndryshueshme Interesi të caktuar në euro.

“Garanci” nënkupton çdo marrëveshje ose masë që krijon një shkallë preferenciale, të drejtë preferenciale pagese, kolateral ose garanci të çfarëdolloj natyre që mund të ofrojë të drejta të përmirësuara për palët e treta.

“Llogari e Posaçme” ka kuptimin e përcaktuar sipas nënklauzolës 4.2.

“Situatë e Punimeve” nënkupton: i) në kontekstin e Huas, raportin e shpenzimeve të pranueshme të ndodhura për të gjitha pjesët përbërëse të Projektit, me koston totale të pranueshme të Projektit; dhe ii) në kontekstin e Grantit të LLDS-së, raportin e shpenzimeve të pranueshme të ndodhura për të gjitha aktivitetet e Asistencës Teknike të Projektit, me koston totale të pranueshme të Asistencës Teknike të Projektit.

“Marzh” nënkupton, në lidhje me një Transh me Normë të Ndryshueshme Interesi, marzhin fiks ndaj Normës Referuese (që është ose plus ose minus) të përcaktuar në pikë bazë në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Transh” nënkupton, siç e kërkon konteksti, ose një Transh Granti, ose një Transh Huaje.

1.2 Interpretimi

Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, referencat ndaj:

a) kësaj Marrëveshjeje interpretohen si referenca ndaj kësaj Marrëveshjeje të plotësuar, të ndryshuar ose të ridekluaruar herë pas here;

b) “Klauzola”, “nënklauzola” dhe “pika” interpretohen si përkatësisht referenca ndaj klauzolave, nënklauzolave dhe pikave të kësaj Marrëveshjeje; dhe

c) fjalët që nënkuptojnë numrin njëjës përfshijnë numrin shumës dhe anasjellas.

1.3 Titujt

Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë asnjë domethënie ligjore dhe nuk cenojnë interpretimin e saj.

2. KUSHTET

Huaja jepet sipas kushteve të përgjithshme të Marrëveshjeve të Huas dhe kushteve të veçanta të Marrëveshjes.

Granti i LLDS-së jepet sipas kushteve të veçanta të Marrëveshjes.



3. QËLLIMI

3.1 Huaja

CEB-i i jep Huan Huamarrësit, i cili e pranon atë vetëm për qëllimin e financimit të Projektit të përshkruar sipas shtojcës 1.

Çdo ndryshim në mënyrën sesi zbatohet Huaja që nuk ka marrë miratimin e CEB-it do të përbëjë një rast në lidhje me nenin 3.3 (h) të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë rimbursimin, pezullimin ose anulimin e parakohshëm të Huas sipas kushteve të neneve 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara) të Rregullores së Huas.

3.2 Granti i LLDS-së

CEB-i i jep Grantin e LLDS-së Vendit Përfitues, i cili e pranon atë vetëm për qëllimin e financimit të Asistencës Teknike të Projektit të përshkruar sipas shtojcës 5.

Çdo ndryshim në termat dhe kushtet e Asistencës Teknike të Projektit i komunikohet me shkrim CEB-it me njoftim paraprak të arsyeshëm dhe i nënshtrohet pëlqimit paraprak me shkrim të CEB-it. Nëse ndodh ndonjë ndryshim që sipas mendimit të CEB-it, mund të cenojë zbatimin e Asistencës Teknike të Projektit ose në rast shkeljeje nga Vendi Përfitues, të termave dhe kushteve të Asistencës Teknike të Projektit, CEB rezervon të drejtën për të pezulluar, anuluar ose kërkuar shlyerjen e menjëhershme të Grantit të LLDS-së. Megjithatë, Palët bien dakord se do të zhvillojnë konsultime me njëra-tjetrën para depozitimit të këtij pretendimi.

4. KUSHTET FINANCIARE TË HUAS

4.1 Shuma e Huas

Shuma e Huas është: 15,930,000 euro (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë euro).

4.2 Disbursimi i Huas

Huaja disbursohet në transhe.

Shuma e secilit Transh përcaktohet sipas Situatës së Progresit të Punimeve dhe/ose Situatës së Planifikuar të Progresit të Punimeve. Shuma e Transhit të parë nuk tejkalon 50 për qind (50%) të Shumës së Huas.

Disbursimet duhet të kryhen në Llogarinë e Projektit.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Huamarrës dhe Vend Përfitues, nëpërmjet

Ministrit të Financave, hap: i) në Bankën e Shqipërisë, Banka Qendrore e Shqipërisë me seli në Tiranë, një llogari të dedikuar për Projektin dhe Asistencën Teknike të Projektit në të cilën CEB-i do të transferojë Huan dhe të ardhurat e Grantit të LLDS-së (“Llogaria e Projektit”); dhe ii) në një bankë tregtare, një llogari të dedikuar për Projektin dhe Asistencën Teknike të Projektit në të cilën Ministria e Financave do të transferojë Huan dhe të ardhurat e Grantit të LLDS-së që duhet të shfrytëzohet nga NJZP-ja (“Llogaria e Posaçme”). Republika e Shqipërisë, nëpërmjet AZP/NJZP-së, i komunikon CEB-it të dhënat e këtyre llogarive pas hapjes së tyre.

4.3 Procedura e Disbursimit

Secili Transh disbursohet pas procedurës së përcaktuar më poshtë:

a) Kërkesa për Disbursim

Para secilit disbursim, pas konsultimit paraprak ndërmjet Huamarrësit dhe CEB-it, Huamarrësi duhet t'i paraqesë CEB-it një kërkesë disbursimi kryesisht në formën e përcaktuar sipas shtojcës 3 (më poshtë e referuar si “Kërkesë për Disbursimin e Huas”).

Një Kërkesë për Disbursimin e Huas përcakton:

i) Monedhën(at) dhe shumën(at) e propozuara për Transhin;

ii) Datën e Disbursimit; kjo Datë Disbursimi është një Ditë Pune që bie të paktën pesë (5) Ditë Pune, por jo më vonë se njëzet (20) Ditë Pune pas datës së Kërkesës të Disbursimit të Huas;

iii) Datën (Datat) e Shlyerjes së Principalit, duke përfshirë Datën e Maturimit, duke marrë në konsideratë se Periudha për Shlyerjen e Principalit për secilin Transh nuk duhet të tejkalojë njëzet (20) vjet, përfshirë një periudhë pa pagim interesi jo më të gjatë se pesë (5) vjet;

iv) Normën maksimale fikse të Interesit ose Marzhit maksimal ndaj Normës Referuese;

v) Periudhën e Pagesës së Interesit dhe Datat e Pagesës së Interesit;

vi) Marrëveshjen e Shtimit të Interesit dhe Ditët e Punës; dhe

vii) Llogarinë e Projektit të Huamarrësit për pagesa.

Secila Kërkesë për Disbursimin e Huas e paraqitur CEB-it është e parevokueshme, nëse nuk bihet dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i.

b) Njoftimi i Disbursimit

Nëse CEB-i merr një Kërkesë për Disbursimin



e Huas që është e pajtueshme me kushtet e Kërkesës për Disbursimin e Huas të përcaktuara në nënklauzolën 4.3 (a) më lart dhe nëse të gjitha Kushtet e tjera përkatëse të Disbursimit të përcaktuara në nënklauzolën 4.5 (Kushtet e Disbursimit) më poshtë janë përmbushur, CEB duhet t'i paraqesë Huamarrësit një njoftim disbursimi kryesisht në formën e përcaktuar sipas shtojcës 3 (më poshtë i referuar si “Njoftim Disbursimi”). Secili Njoftim Disbursimi dërgohet të paktën pesë (5) Ditë Pune para Datës së propozuar të Disbursimit.

Një Njoftim Disbursimi duhet të specifikojë:

- i) Monedhën(at) dhe shumën(at) për Transh-in;
- ii) Datën e Disbursimit;
- iii) Datën(at) e Periudhës së Shlyerjes të Principalit, duke përfshirë Datën e Maturimit;
- iv) Normën Fikse të Interesit ose Marzhit ndaj Normës Referuese;
- v) Periudhën e Pagesës së Interesit dhe Datat e Pagesës së Interesit;
- vi) Marrëveshjen për Përcaktimin e Interesit të Shtuar dhe Ditët e Punës; dhe
- vii) Llogarinë e Projektit të Huamarrësit dhe llogarinë e CEB-it për pagesa.

Një Njoftim Disbursimi që është në pajtim me elementet e përfshira në një Kërkesë për Disbursim Huaje përbën angazhim të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për të marrë hua nga CEB dhe nga ana e CEB-it për t'i disbursuar Huamarrësit Transhin sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në Njoftimin e Disbursimit.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse CEB-i nuk ka dërguar një Njoftim Disbursimi brenda njëzet (20) Ditësh Pune pas marrjes së një Kërkesë për Disbursimin e Huas, Kërkesa përkatëse për Disbursimin e Huas do të konsiderohet e anuluar.

4.4 Periudha e Disbursimit

Nëse nuk bihet dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i, Huamarrësi nuk do të ketë të drejtë:

- i) të lëshojë një Kërkesë për Disbursimin e Huas për Transhin e Parë pas dymbëdhjetë (12) muajve pas Datës së Hyrjes në Fuqi;
- ii) të lëshojë ndonjë Kërkesë tjetër për Disbursimin e Huas pas tetëmbëdhjetë (18) muajve pas disbursimit të fundit; ose
- iii) të lëshojë ndonjë Kërkesë tjetër për Disbursimin e Huas pas Datës së Mbylljes të përcaktuar sipas shtojcës 1.

Faqe | 1962

4.5 Kushtet e Disbursimit

a) Kushtet pararendëse të disbursimit të Transhit të Parë:

i) Një opinion ligjor në gjuhën angleze i lëshuar nga Ministri i Drejtësisë që konfirmon në masë të pranueshme për CEB-in, kryesisht në formën e përcaktuar sipas shtojcës 2, se Marrëveshja është nënshkruar sipas rregullave nga përfaqësues të autorizuar të Huamarrësit dhe se Marrëveshja është e vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme në përputhje me kushtet e saj në juridiksionin e Huamarrësit.

ii) Të dhëna në gjuhën angleze, në masë të pranueshme për CEB-in, të personit(ave) të autorizuar për të nënshkruar Marrëveshjen dhe Kërkesat e Disbursimit në emër të Huamarrësit, së bashku me modelin e nënshkrimit(eve) të këtij personi (këtyre personave), të vërtetuar/a nga Ministri i Financave.

iii) Çdo kusht tjetër të përcaktuar si Kusht/e Specifik/e sipas shtojcës 1 (Përshkrimi i Projektit).

b) Kushtet pararendëse të disbursimit të ndonjë Transhi pasues:

i) Në rast se ka pasur një ndryshim në lidhje me personin(at) e autorizuar për të nënshkruar Kërkesat e Disbursimit në emër të Huamarrësit, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Financave, i jep CEB-it të dhëna të përditësuara të personit(ve) të autorizuar për nënshkrimin e Kërkesave korresponduese të Disbursimit në emër të Huamarrësit, së bashku me modelin/et e vërtetuar/a të nënshkrimit(eve) të këtij personi(ave).

ii) Raporti i Progresit që konfirmon, në masën e pranueshme nga CEB-i, alokimin e të paktën nëntëdhjetë për qind (90%) të Transhit të mëparshëm.

iii) Çdo kusht tjetër i përcaktuar si Kusht/e Specifik/e në shtojcën 1 (Përshkrimi i Projektit) të kësaj Marrëveshjeje.

4.6 Shlyerja

Në çdo Datë të Shlyerjes së Principalit, Huamarrësi do të shlyejë principalin e secilit Transh sipas Datës së Shlyerjes së Principalit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Njoftimin në fuqi të Disbursimit.

4.7 Rimbursimi i parakohshëm

a) Praktikat procedurale

Nëse në çdo rast të specifikuar në këtë Marrëveshje që i referohen kësaj nënklauzole,



Huamarrësi duhej të rimbursojë para afatit të maturimit të gjitha ose një pjesë të një Transhi, Huamarrësi do t'i dërgojë të paktën një (1) muaj para një njoftim paraprak me shkrim CEB-it (më poshtë i referuar si “Njoftimi i Rimbursimit të Parakohshëm”), duke specifikuar shumat që duhet të rimbursohen, datën në të cilën do të kryhet rimbursimi (më poshtë e referuar si “Data e Rimbursimit të Parakohshëm”) dhe pas konsultimit paraprak me CEB-in në lidhje me shumat, nëse ka të tilla, që mund të dalin në përputhje me nënparagrafin 4.7 (b), edhe Kostot maksimale të Rimbursimit të Parakohshëm. Data e Rimbursimit të Parakohshëm caktohet në një Datë të Pagesës së Interesit, përveç se në rastet kur është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i.

Pas marrjes së Njoftimit të Rimbursimit të Parakohshëm, CEB duhet t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim me shkrim (më poshtë i referuar si “Konfirmimi i Rimbursimit të Parakohshëm”) jo më vonë se 5 Ditë Pune para Datës së Rimbursimit, që tregon interesin e shtuar për shkak të Kostos së Rimbursimit të Parakohshëm në përputhje me nënklauzolën 4.7 (b).

Një Konfirmim i Rimbursimit të Parakohshëm në përputhje me elementet e përfshira në një Njoftim të Rimbursimit të Parakohshëm përbën një angazhim të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për të rimbursuar shumat përkatëse ndaj CEB-it sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në Konfirmimin e Rimbursimit të Parakohshëm.

Nëse Huamarrësi rimbursos pjesërisht një transh, shuma e rimbursuar do të aplikohet proporcionalisht për çdo shlyerje të principalit të papaguar. Në një rast të tillë, Konfirmimi i Rimbursimit të Parakohshëm duhet të përfshijë një plan të përditësuar të shlyerjes, i cili është detyrues për Huamarrësin.

b) Kostot e Rimbursimit të Parakohshëm

Kostot e Rimbursimit të Parakohshëm që rezultojnë nga rimbursimi i parakohshëm në përputhje me nënklauzolën 4.7 (a) përcaktohen nga CEB-i në bazë të kostove të tij për transferimin e shumës që do të rimbursohet nga Data e Rimbursimit të Parakohshëm deri në Datën e Maturimit, përfshirë ndonjë kosto tjetër që lidhet me lëshimin e ndonjë marrëveshjeje kryesore mbrojtëse. Kostot e transferimit do të caktohen mbi bazën e diferencës midis normës fillestare dhe

normës së transferimit që do të caktohet nga CEB-i në bazë të kushteve të tregut në datën e Njoftimit të Rimbursimit të Parakohshëm.

4.8 Përcaktimi i Interesit

Huamarrësi paguan interesin mbi principalin e secilit Transh herë pas here, të papaguar gjatë secilës Periudhë të Interesit në Normë Interesi Fikse /Normë Interesi të Ndryshueshme të përcaktuar në Njoftimin e Disbursimit në fuqi.

Interesi: i) rritet, duke përfshirë ditën e parë të Periudhës së Interesit, por duke përjashtuar ditën e fundit të Periudhës së Interesit; dhe ii) është i detyrueshëm dhe i pagueshëm në Datat e Pagesës së Interesit të përcaktuara në Njoftimin e Disbursimit në fuqi. Interesi do të llogaritet në bazë të Marrëveshjes së Përcaktimit të Interesit të Shtuar siç specifikohet në Njoftimin Përkatës të Disbursimit.

Në rastin e Transheve me Normë të Ndryshueshme Interesi, CEB-i përcakton në çdo Datë të Përcaktimit të Interesit normën e interesit të zbatueshme gjatë Periudhës përkatëse të Interesit, në përputhje me Marrëveshjen, dhe menjëherë njofton për këtë Huamarrësin. Çdo përcaktim nga CEB-i është i formës së prerë, përfundimtar dhe detyrues për Huamarrësin përveç se në rastet kur Huamarrësi vlerëson në masën e pranueshme për CEB-in se një përcaktim i tillë është kryer me gabime të dukshme.

4.9 Kamatëvonesa

Në rast se Huamarrësi nuk arrin të paguajë, plotësisht ose pjesërisht, ndonjë shumë sipas Marrëveshjes, dhe pavarësisht nga çdo mjet tjetër në dispozicion të CEB-it sipas marrëveshjes ose ndryshe, Huamarrësi do të paguajë interesin përkatës mbi shumën të tilla të papaguara nga data e caktuar deri në datën e marrjes së kësaj pagese nga CEB-i me një normë interesi në vit të barabartë me një muaj të EURIBOR-it të kuotuar në datën e dhënë plus dyqind e pesëdhjetë pikë bazë (250 pb) (më poshtë e referuar si “Kamatëvonesa”).

Kamatëvonesa e zbatueshme përditësohet çdo tridhjetë (30) ditë kalendarike.

4.10 Situata e Mosfunksionimit të Tregut

CEB-i do të njoftojë menjëherë Huamarrësin sapo të vihet në dijeni për ndonjë Situatë të Mosfunksionimit të Tregut që mund të ketë ndodhur.



Për qëllimet e Marrëveshjes, “Situata e Mosfunksionimit të Tregut” u referohet rrethanave të mëposhtme:

a) Faqja elektronike e Agjencisë Rojter që i referohet përkufizimit të EURIBOR-it nuk tregon të dhënat e kërkuara ose nuk është e aksesueshme.

Në rast të një Situate të tillë të Mosfunksionimit të Tregut, EURIBOR-i që do të zbatohet do të jetë sa norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga CEB-i si mesatarja aritmetike e normave, Huat e të cilave në euro, në një sasi të njëjtë apo të afërt të krahasueshme me shumën e Huas në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë ose afërsisht të krahasueshme me Periudhën relative të Interesit, janë ofruar në Datën e Përcaktimit të Interesit nga tri (3) banka kryesore në tregun ndërbankar të BE-së, të zgjedhur nga CEB-i. Nëse janë paraqitur të paktën dy (2) kuotime, EURIBOR-i që do të zbatohet për atë Datë të Përcaktimit të Interesit do të jetë sa mesatarja aritmetike e të gjitha kuotimeve të ofruara.

Nëse jepet vetëm një (1) kuotim, EURIBOR-i që do të zbatohet do të jetë norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga CEB-i si mesatare aritmetike e normave, Huat e të cilave në euro, në një sasi të njëjtë apo afërsisht të krahasueshme me shumën e Huas në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë apo afërsisht të krahasueshme me Periudhën relative të Interesit, janë ofruar në Ditën e dytë të Punës pas fillimit të Periudhës përkatëse të Interesit nga ana e bankave të mëdha në tregun ndërbankar të BE-së të zgjedhur nga CEB-i.

b) CEB-i konstaton se nuk është e mundur të përcaktohet Norma e zbatueshme Referuese në përputhje me paragrafin (a) më sipër.

Në rastin e një Situate të tillë të Mosfunksionimit të Tregut, Norma e Ndryshueshme e Interesit do të zëvendësohet me normën që shpreh si një normë përqindjeje në vit koston e CEB-it për financimin e Huas nga çfarëdo burimi të zgjedhur nga CEB-i në mënyrë të arsyeshme.

c) Në çdo kohë, kur midis dorëzimit të Njoftimit të Disbursimit dhe Datës së Disbursimit, CEB-i konstaton në mënyrë të arsyeshme se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme dhe të papritura të një natyre ekonomike, financiare, politike apo rrethana të tjera të jashtme që ndikojnë negativisht në qasjen e CEB-it të burimet e tij të financimit.

Faqe | 1964

Në rastin e një Situate të tillë të Mosfunksionimit të Tregut, CEB-i ka të drejtë të anulojë pa kosto disbursimin e planifikuar.

Në rastin e Situatave të Mosfunksionimit të Tregut të parashikuara në pikat “a” dhe “b” më sipër:

i) Kur kërkohet nga Huamarrësi, Palët, duke vepruar në mirëbesim, hyjnë në bisedime për një periudhë prej jo më shumë se tridhjetë ditë (30) kalendarike, në mënyrë që të bien dakord mbi një alternativë të EURIBOR-it që do të zbatohet. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, Huamarrësi mund të procedojë me rimbursim të parakohshëm në Datën e Pagesës së Interesit në vijim sipas kushteve të përcaktuara në nënklauzolën 4.7.

ii) CEB-i ka të drejtë, që duke vepruar në mirëbesim dhe në konsultim me Huamarrësin, në masën që është praktikisht e mundur, të ndryshojë kohëzgjatjen e çdo Periudhe pasuese të Interesit për tridhjetë (30) ditë kalendarike ose një periudhe më të shkurtër, duke i dërguar Huamarrësit një njoftim për këtë. Çdo ndryshim i tillë i një Periudhe të Interesit do të hyjë në fuqi në datën e specifikuar nga CEB-i në këtë njoftim.

Nëse CEB-i konstaton se Situata përkatëse e Mosfunksionimit të Tregut nuk ekziston më, atëherë, në varësi të ndonjë Situate ekzistuese apo në vijim të Mosfunksionimit të Tregut, Norma e Ndryshueshme e Interesit dhe / ose Periudha e zbatueshme e Interesit për çdo transh përkatës do të ndryshojë, nga dita e parë e Periudhës së Interesit në vijim në atë të llogaritjes në përputhje me Normën e Ndryshueshme të Interesit dhe Periudhën e Interesit të specifikuar në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

4.11 Pagesat

Të gjitha shumat e kërkueshme nga Huamarrësi mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje do të paguhet në Monedhën e secilit transh në llogarinë e CEB-it që përcaktohet në Njoftimin e Zbatueshëm të Disbursimit. Çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet në një Ditë Pune sipas Marrëveshjes së Përcaktimit të Ditës së Punës Pasuese të Ndryshuar. Çdo pagesë konsiderohet e paguar kur CEB-i ka marrë shumën e duhur në llogarinë e tij.

Huamarrësi ose banka e udhëzuar nga Huamarrësi, sipas rastit, i dërgon CEB-it një njoftim me shkrim për pagesën, të paktën pesë (5) Ditë Pune para pagesës së çdo shume sipas kësaj Marrëveshjeje.



5. KUSHTET FINANCIARE TË GRANTIT TË LLDS-së

5.1 Shuma e Grantit të LLDS-së

CEB-i, në mënyrën e përmendur në paragrafin 5.2 më poshtë, vë në dispozicion të Vendi Përfitues Grantin e LLDS-së në një vlerë totale maksimale prej 1,500,000 € (një milion e pesëqind mijë eurosh).

5.2 Disbursimi i Grantit të LLDS-së

Në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha kushteve standarde për disbursim në lidhje me: a) Transhin e parë të përcaktuar në nënparagrafët 4.5 (a) (i) dhe 4.5 (a) (ii), (Kushtet standarde për disbursimin e transhit të parë) dhe Republikën e Shqipërisë nëpërmjet AZP-së /NJZP-së duke komunikuar me CEB-in për të dhënat e Llogarisë së Projektit dhe llogarinë e posaçme; dhe b) çdo transh pasues të përcaktuar në nënparagrafët 4.5 (b) (i) dhe 4.5 (b) (ii) (Kushtet pararendëse për disbursimin e çdo transhi të mëvonshëm), sipas rastit, që përmbushet pas marrjes së një kërkesë të plotësuar në mënyrë të rregullt dhe të nënshkruar për Transhin e Grantit të LLDS-së nga Vendi Përfitues, kryesisht në formën e përcaktuar në shtojcën 6 (Kërkesë Disbursimi e Grantit të LLDS-së (Model) për të cilën (“Kërkesë Disbursimi e Grantit të LLDS-së”), CEB-i do të disbursojë shumën e Grantit të LLDS-së në, minimumi dy (2) Transhe.

Shuma e Transhit të Grantit të parë nuk duhet të tejkalojë 10 për qind (10%) të shumës së Grantit të LLDS-së.

Shuma e secilit Transh të Grantit pasues do të përcaktohet në përputhje me Statusin e Progresit të Punëve dhe / ose të Statusit të Planifikuar të Progresit të Asistencës Teknike të Projektit.

Disbursimi i çdo Transhi të Grantit të mëvonshëm do t'i nënshtrohet një Raporti Progresi që konfirmon pranimin nga ana e CEB-it për alokimin e të paktën nëntëdhjetë për qind (90%) të Transhit të Grantit të mëparshëm.

Disbursimet duhet të bëhen në Llogarinë e Projektit.

Granti i LLDS-së paguhet në euro (EUR). Të gjitha llogaritë dhe dokumentet financiare duhet të shprehen në euro gjatë raportimit të CEB-i.

5.3 Periudha e Disbursimit

Përveç kur është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i, Vendi Përfitues nuk ka të drejtë të lëshojë një Kërkesë Disbursimi të Grantit të LLDS-së pas Datës së Përfundimit të specifikuar në shtojcën 5 të kësaj Marrëveshjeje.

5.4 Shlyerja

Çdo balancë e mbetur e pashpenzuar deri në Datën e Përfundimit apo çdo shlyerje e Grantit të LLDS-së sipas Marrëveshjes do t'i kthehet CEB-it në euro, përveçse në rastet kur bihet dakord ndryshe ndërmjet palëve.

6. ZBATIMI I PROJEKTIT

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Huamarrës, do të zbatojë Projektin dhe, në cilësinë e saj si Vend Përfitues, do të zbatojë Asistencën Teknike të Projektit në pajtim me Marrëveshjen.

Republika e Shqipërisë ka caktuar Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) si Agjencinë e Zbatimit të Projektit. Republika e Shqipërisë garanton që të caktojë një personel NJPZ-je të përshtatshme dhe të mirëpajisur gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të projektit. Në veçanti, NJPZ-ja duhet të jetë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në shtojcën 1.

Në çdo rast, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Huamarrës dhe Vend Përfitues, mbetet përgjegjëse e vetme në përputhje me detyrimet e saj të bazuara në këtë Marrëveshje.

Mosrespektimi i sipërmarrjeve të zbatimit të projektit në lidhje me Projektin, siç përcaktohet në këtë klauzolë 6 përbën, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e zbatueshme e Rregullores së Huas, një rast në kuptimin e nenit 3.3 “h” të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë: i) shpenzime përkatëse të kontratës të deklaruara të papërshtatshme për Alokimin sipas Projektit; dhe/ose ii) rimbursim të parakohshëm, pezullim ose anulim të Huas, të plotë ose të pjesshëm, sipas kushteve të nenit 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara) të Rregullores së Huas.

Në rast të mosrespektimit të përmbushjes së detyrimeve të zbatimit të projektit në lidhje me Asistencën Teknike të Projektit sipas parashikimit të kësaj klauzole 6, CEB-i rezervon të drejtën të



pezullojë, të anulojë ose të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të Grantit të LLDS-së. Para se të ngrihet një pretendim i tillë, do të kryhen konsultime paraprake midis palëve.

6.1 Detyrimi i kujdesit të arsyeshëm

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, nëpërmjet AZP-së dhe NJZP-së do të tregojë të gjithë kujdesin dhe zellin e duhur, dhe do të ushtrojë të gjitha mjetet që zakonisht përdoren (duke përfshirë, por pa u kufizuar te mjetet ligjore, financiare, menaxheriale dhe teknike) të nevojshme për zbatimin e duhur të Asistencës Teknike të Projektit dhe të Projektit.

6.2 Periudha e Alokimit

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Huamarrës, do të alokojë çdo Transh të Huas brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas Datës së Disbursimit përkatës, dhe në cilësinë e Vendit Përfitues, do të Alokojë çdo Transh të Grantit brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas Datës përkatëse të Disbursimit (secila e referuar si “Periudhë Alokimi”).

Nëse një Transh i Huas i disbursuar nga CEB-i nuk është alokuar ose është alokuar vetëm pjesërisht brenda Periudhës së Alokimit, Huamarrësi do të rimbursojë shumat e paalokuara ndaj CEB-it në përputhje me nënklauzolën 4.7, përveçse në rastet e marrjes së një kërkesë të justifikuar për një shtyrje të Periudhës së Alokimit nga Huamarrësi nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe kur CEB-i bie dakord të zgjasë Periudhën e Alokimit.

Nëse një Transh i Grantit i disbursuar nga CEB-i nuk është alokuar ose është alokuar vetëm pjesërisht brenda Periudhës së Alokimit, Vendi Përfitues do të rimbursojë shumat e paalokuara ndaj CEB-it në pajtim me nënklauzolën 5.4, përveçse në rastet e marrjes së një kërkesë të justifikuar për një zgjatje të Periudhës së Alokimit nga Vendi Përfitues nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe kur CEB-i bie dakord të zgjasë periudhën e Alokimit.

6.3 Kostot e Projektit

Transhet e disbursuara sipas Huas nuk duhet të tejkalojnë shtatëdhjetë për qind (70%) të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të Projektit dhe transhet e disbursuara nga Granti i LLDS-së nuk duhet të kalojnë njëqind për qind (100%) të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të Asistencës Teknike të Projektit, dhe

për shmangien e dyshimit, ato kufizohen në shumën e Huas të përcaktuar në nenin 4.1 të kësaj Marrëveshjeje dhe shumës së Grantit të LLDS-së të përcaktuar në nenin 5.1.

Nëse shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të Asistencës Teknike të Projektit ose të Projektit, ose të dyja së bashku, sipas rastit, rriten apo rishikohen për çfarëdo arsye, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës duhet të garantojnë që burimet financiare shtesë për përfundimin e Asistencës Teknike të Projektit ose Projektit, ose nga të dyja së bashku, sipas rastit, të vihen në dispozicion pa iu referuar CEB-it. Planet për financimin e shpenzimeve të rritura do t'i komunikohen CEB-it pa vonesë.

6.4 Sipërmarrjet Specifike të Projektit

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrësi do të garantojnë që:

i) i gjithë trualli, të drejtat mbi pronat e paluajtshme dhe lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit janë në dispozicion në kohën e duhur;

ii) të gjitha sendet pasurore dhe impiantet në kuadër të Projektit janë të siguruara dhe të mirëmbajtura në mënyrë të përhershme dhe në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare; dhe

iii) çdo kërkesë tjetër e specifikuar si Kushte të Veçanta në shtojcën 1 (Përshkrimi i Projektit) dhe 5 (Përshkrimi i Asistencës Teknike të Projektit) të kësaj Marrëveshjeje është në përputhje me të.

6.5 Prokurimi

Prokurimi i furnizimeve, i punëve dhe i shërbimeve që financohen në bazë të Asistencës Teknike të Projektit dhe Projektit do të kryhet në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit të CEB-it. Sipas zgjedhjes së CEB-it, do të përdoren dokumentet tenderuese të Bankës Botërore dhe kontrata FIDIC me formularët e tyre përkatës.

Kufijtë mbi të cilët Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrësit, do t'i kërkojnë të garantojnë furnizimet, punimet dhe shërbimet nëpërmjet procedurave ndërkombëtare të prokurimit, janë ata që aplikohen nën direktivat përkatëse të Prokurimit të BE-së, të përditësuara herë pas here dhe të publikuara në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian (FZBE).

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:



“Direktivat e Prokurimit të BE-së” i referohen: i) Direktivës 2014/25 /BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 26 shkurt 2014 mbi prokurimet nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorët e shërbimeve postare dhe Direktiva e shfuqizuar 2004/17/KE; dhe/ose ii) direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, e datës 26 shkurt 2014 mbi prokurimin publik dhe direktiva e shfuqizuar 2004/18/ KE, e ndryshuar herë pas here.

Plani i Prokurimit (siç ky term përcaktohet në bazë të Udhëzimeve të Prokurimit) (dhe në çfarëdo përditësimi të tyre) që përcakton metodat e prokurimit për secilën kontratë, duhet të paraqiten te CEB-i për miratim. Pas marrjes, CEB-i do të informojë Huamarrësin për çështjet e shqyrtimit që CEB-i do të kryejë për çdo kontratë.

6.6 Mjedisi

Huamarrësi do të zbatojë Projektin në përputhje me kërkesat e përcaktuara në politikën mjedisore.

6.7 Të drejtat e njeriut

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, do të garantojë që zbatimi i Asistencës Teknike të Projektit dhe i Projektit të mos shkaktojë asnjë shkelje të: i) Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; dhe/ose ii) Kartës Sociale Europiane.

6.8 Integriteti

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, merr përsipër se nuk do të kryejë, si dhe asnjë person, me pëlqimin e saj apo me dijeninë paraprake të saj nuk do të kryejë, në lidhje me zbatimin e Asistencës Teknike të Projektit dhe të Projektit, ose të zbatimit të çdo kontrate sipas Asistencës Teknike të Projektit ose Projektit, asnjë praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të marrëveshjes së fshehtë (më poshtë të referuara bashkërisht si “Praktika të Ndaluara”).

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

i) Një “Praktikë Korruptive” nënkupton ofrimin, dhënie, marrjen apo kërkimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme te veprimet e një pale tjetër.

ii) Një “Praktikë Mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, përfshirë një keqpër-

faqësim, që me dashje ose nga pakujdesia çorienton apo synon të çorientojë një palë për të marrë një përfitim financiar ose përfitime të tjera, ose për të shmangur një detyrim.

iii) Një “Praktikë Shtrënguese” nënkupton cenimin ose dëmtimin, apo rrezikun për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë palë apo pronën e palës për të ndikuar në mënyrë të paligjshme te veprimet e një pale.

iv) Një “Praktikë e Marrëveshjes së Fshehtë” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë dhe duke ndikuar në mënyrë të paligjshme te veprimet e një pale tjetër.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, merr përsipër të informojë CEB-in, nëse ai duhet të informohet për çdo fakt ose informacion në lidhje me kryerjen e ndonjë Praktike të tillë të Ndaluara. Për këtë qëllim, njohja e çdo anëtarit të NJZP-së do të gjykohet si njohja e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, merr përsipër:

i) të ndërmarrë masa në kohë siç mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga CEB-i për të hetuar dhe/ose të përfunduar ndonjë Praktikë të dyshuar si të Ndaluara;

ii) të informojë CEB-in në lidhje me masat e marra për të kërkuar dëmshpërblim nga personat përgjegjës për çdo humbje që rezulton nga ndonjë Praktikë e tillë e Ndaluara; dhe

iii) të lehtësojë çdo hetim që CEB-i mund të kryejë në lidhje me ndonjë akt të tillë.

Ministri i Shëndetësisë është përgjegjës për kontaktet me CEB-in për qëllime të kësaj nënklauzole.

6.9 Transparenca

Huaja: Huamarrësi do të informojë Përfituesit Përfundimtarë që projekti është financiar pjesërisht nga CEB-i, nëpërmjet mjeteve të duhura të komunikimit, si njofimet përkatëse në faqet përkatëse të internetit, komunikatat për shtyp, broshurat apo ekspozimin e posterave /plakatatave pranë impianteve/ ambienteve përkatëse të Projektit / objekteve. Në çdo rast, informacioni i dhënë Përfituesit Përfundimtar do të shfaqë në një mënyrë të përshtatshme emrin dhe logon e CEB-it.



Granti i LLDS-së: Vendi Përfitues do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që kontratat e shërbimit dhe produktet e prodhuara në kuadër të aktiviteteve të financuara nga Granti i LLDS-së të pranojnë dhe të publikojnë kurdoherë që këto aktivitete janë kryer me fonde nga LLDS-ja me anë të CEB-it.

Publikimet që lidhen me Projektin ose Asistencën Teknike të Projektit, në çfarëdo forme dhe me çfarëdo mjeti, duke përfshirë edhe internetin: i) do të mbajnë në mënyrë të dukshme logon e CEB-it; dhe ii) do të mbajnë shprehjen e mëposhtme apo të ngjashme me të: “Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës”.

7. MONITORIMI

7.1 Raportimi

a) Raportet e Progresit

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, nëpërmjet NJZP-së, do t'i dërgojë CEB-it një raport progresi (më poshtë i referuar si “Raport Progresi”) mbi baza gjashtëmujore dhe para çdo Kërkese Disbursimi, me përjashtim të kështit të parë.

Shtojca 4 e kësaj Marrëveshjeje ofron një model që përcakton informacionin minimal që kërkohet nga CEB-i. Gjithashtu, mund të përdoren formatet alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

b) Raporti i Përfundimit

Pas përfundimit të Projektit / Alokimit të plotë të Transheve, Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, nëpërmjet NJZP-së, do të paraqesë një raport për përfundimin (më poshtë i referuar si “Raport i Përfundimit”), duke përfshirë edhe një vlerësim të ndikimit social të Projektit.

Raporti Përfundimtar do të përfshijë edhe një vlerësim të përdorimit dhe ndikimit të Grantit të LLDS-së. Raporti i Përfundimit duhet të konsiderohet i pranueshëm edhe nga CEB-i.

7.2 Vizitat

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, merr përsipër të presë vizita të favorshme monitorimi / teknike / apo vlerësimi, duke përfshirë edhe lehtësimin e vizitave dhe aksesit në ambientet/kontraktuesit përkatës të Projektit, të personelit të CEB-it ose palëve të treta të caktuara.

7.3 Auditimet

Republika e Shqipërisë merr përsipër të sigurojë për CEB-in, mbi baza vjetore, një opinion të auditimit mbi Llogarinë e Posaçme të kryer nga një auditues i jashtëm. Audituesi i jashtëm i tillë do të kontraktohet nga Ministria e Financave. Nëse kostot e auditimit financohen me të ardhurat e Huas ose Grantit të LLDS-së, Republika e Shqipërisë merr përsipër kontraktimin e një audituesi të jashtëm në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit të CEB-it.

Nëse Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, nuk respekton ndonjë nga sipërmarrjet e saj sipas Marrëveshjes, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, merr përsipër të pranojë në mënyrë të favorshme ndonjë auditim në ambientet e projektit, të kryer nga anëtarët e personelit të CEB-it ose palët e treta të caktuara, i cili do të përballohet financiarisht nga Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues ose Huamarrës, sipas rastit.

7.4 Informacioni mbi Projektin

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, nëpërmjet NJZP-së, do të mbajë regjistra llogarie në lidhje me: i) Asistencën Teknike të Projektit; dhe ii) Projektin, të cilët do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke treguar në çdo periudhë kohe, statusin e progresit të Asistencës Teknike të Projektit dhe Projektit, i cili do të regjistrojë të gjitha veprimet e bëra dhe do të identifikojnë sendet pasurore dhe shërbimet e financuara ose pjesërisht të financuara, sipas rastit, nëpërmjet: i) Grantit të LLDS-së; dhe ii) Huas.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, nëpërmjet NJZP-së, do t'i paraqesë CEB-it në kohën e duhur çdo informacion apo dokument në lidhje me financimin ose zbatimin e Asistencës Teknike të Projektit dhe të Projektit (duke përfshirë në veçanti problemet e mjedisit dhe prokurimit), bazuar në një kërkesë të arsyeshme të CEB-it.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si Vend Përfitues dhe Huamarrës, nëpërmjet NJZP-së, do të informojë menjëherë CEB-in për çdo rast që mund të ketë një ndikim negativ material në zbatimin e Asistencës Teknike të Projektit apo të Projektit, duke përfshirë, por pa u kufizuar te:



i) çdo veprim apo ankesë të iniciuar ose çdo kundërshtim të ngritur nga ndonjë palë e tretë ose çdo ankesë reale të marrë nga Huamarrësi ose çdo padi ligjore materiale që ka filluar ose rrezikon të ndodhë kundër saj në lidhje me prokurimin, çështjet mjedisore apo të tjera që ndikojnë në Asistencën Teknike të Projektit ose Projektin; dhe

ii) çdo miratim ose çdo amendament për ndonjë ligj, rregull apo rregullore (ose në zbatimin apo interpretimin zyrtar të ndonjë ligji, rregulli ose rregulloreje).

Çdo rast që mund të ketë një ndikim negativ material në zbatimin e Projektit do të përbënte një rast në kuptimin e nenit 3.3 “h” të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë rritje të rimbursimit të parakohshëm, pezullimin ose anulimin e Huas sipas kushteve të neneve 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i huave të papaguara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i huave të papaguara) të Rregullores së Huas.

Në rast të ndodhjes së një ndikimi të pafavorshëm në realizimin e Asistencës Teknike të Projektit, CEB-i rezervon të drejtën të pezullojë, të anulojë ose të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të Grantit të LLDS-së. Para se të ngrihet një pretendim i tillë, do të zhvillohen konsultime midis palëve.

7.5 Informimi i Huamarrësit

Huamarrësi duhet të informojë menjëherë CEB-in për çfarëdo Ndryshim të Pafavorshëm Material. Çdo Ndryshim i Pafavorshëm Material do të përbënte një rast bazuar në nenin 3.3 “h” të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë rritje të rimbursimit të parakohshëm, pezullimin ose anulimin e Huas sipas kushteve të nenit 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i huave të papaguara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i huave të papaguara) të Rregullores së Huas.

Mospërmbushja e Detyrimeve me Efekt të Tërthortë

Fakti që, në vijim të çdo mospagimi në lidhje me këtë marrëveshje, Huamarrësit i kërkohet, mund t'i kërkohet ose do t'i kërkohet, pas skadimit të ndonjë periudhe kontraktuale të zbatueshme mospagimi pa interes, do t'i kërkohet ose mund t'i kërkohet të parapagujë, të shlyejë ose të përfundojë para maturitetit çdo Instrument Borxhi afatmesëm/afatgjatë ose angazhimi në lidhje me ndonjë instrument tjetër borxhi është anuluar ose

pezulluar, do të përbënte një rast në kuptimin e nenit 3.3 “h” të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huas sipas kushteve të nenit 3.3 (rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i huave të papaguara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i huave të papaguara) të Rregullores së Huas.

8. PARI PASSU

Mosrespektimi i dispozitave të përcaktuara sipas klauzolës 8 do të përbënte një rast në lidhje me nenin 3.3(h) të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë rimbursim, pezullim ose anulim të parakohshëm të Huas sipas kushteve të neneve 3.3 (Rimbursimi i Parakohshëm i Huave të Disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara) të Rregullores së Huas.

8.1 Klasifikimi

Huamarrësi garanton që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen dhe do të klasifikohen në shkallë jo më të ulët sesa *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera aktuale dhe të ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura sipas Instrumenteve të tij të Borxhit.

Në veçanti, Huamarrësi nuk do të kryejë (ose autorizojë) ndonjë pagesë në lidhje me një Instrument tjetër të tillë Borxhi (pavarësisht nëse janë planifikuar sipas rregullave apo ndryshe), nëse:

i) CEB-i bën një kërkesë të disbursimit të parakohshëm sipas nenit 3.3 të Rregullores së Huas; ose

ii) një rast ose rast i mundshëm mospagimi sipas ndonjë Instrumenti të pasiguar dhe jo të varur Borxhi të Huamarrësit ose ndonjë prej mjeteve apo instrumenteve të tij ka ndodhur dhe është duke vazhduar.

Megjithatë, pagesa në lidhje me të cilën mundësohet ky Instrument Borxhi, nëse Huamarrësi:

i) paguan në të njëjtën kohë; ose

ii) vendos mënjatë në një llogari të caktuar për pagesën në Datën e ardhshme të Pagesës së Interesit

një shumë të barabartë me të njëjtin raport të principalit të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje si raportin që pagesa sipas këtij Instrumenti Borxhi ruan ndaj borxhit total të papaguar sipas atij instrumenti.

Për këtë qëllim, çdo pagesë e një Instrumenti Borxhi që është kryer nga të ardhurat e emetimit të



ndonjë dokumenti tjetër të nënshkruar kryesisht nga të njëjtët persona si mbajtës të pretendimeve sipas Instrumentit të Borxhit, nuk do të merret në konsideratë.

8.2. Garancia

Nëse Huamarrësi i jep një pale të tretë një Garanci për përmbushjen e ndonjë Instrumenti Borxhi, Huamarrësi do të informojë në kohë CEB-in në lidhje me synimet e saj dhe nëse kjo kërkohet nga CEB-it, do t'i japë CEB-it brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e CEB-it, një Garanci të njëjtë ose të barasvlershme për përmbushjen e detyrimeve të tij financiare sipas kësaj Marrëveshjeje.

Kjo dispozitë nuk zbatohet ndaj një Garancie:

a) të krijuar ndaj pronës në kohën e blerjes vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes ose për pagesën e borxhit të shkaktuar për qëllim financimi të blerjes së kësaj prone;

b) të krijuar gjatë zhvillimit normal të transaksioneve bankare dhe sigurimit të një Instrumenti Borxhi që maturohet jo më vonë se një (1) vit pas datës në të cilën është shkaktuar fillimisht; ose

c) të miratuar më parë nga CEB-i.

8.3 Klauzola me anë të përfshirjes

Nëse ndonjë instrument afatmesëm/afatgjatë Borxhi i Huamarrësit përfshin klauzola në lidhje me një humbje klasifikimi, raporte financiare ose *pari passu* që janë më të rrepta sesa ndonjë dispozitë e barasvlershme e kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të informojë për këtë CEB-in dhe me kërkesë të CEB-it, me anë të një njoftimi me shkrim do të kryejë brenda periudhës së përcaktuar në njoftimin e CEB-it, një amendim të kësaj Marrëveshjeje për dhënien e një dispozite të barasvlershme në favor të CEB-it.

8.4 Parapagimi për Palët e Treta

Nëse Huamarrësi parapaguan plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të vullnetshme ose ndryshe, ndonjë instrument afatmesëm/afatgjatë Borxhi, Huamarrësi do të informojë për këtë CEB-in.

Në këtë rast dhe me kërkesë të CEB-it, Huamarrësi do t'i rimbursojë CEB-it shumat e disbursuara sipas Huas në përputhje me nënklauzolën 4.7 në raport të tillë që shuma e parapaguar ka me Instrumentin korrespondues të Borxhit. Sa më sipër nuk lidhet me parapagesat për qarkullimin e shumave të Huas që mbeten të

hapura për tërheqje në bazë të të njëjta kushteve pas këtij parapagimi.

Për qëllime të Marrëveshjes, "Parapagim" nënkupton një shlyerje para maturitetit.

9. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton se:

a) organet e tij kompetente e kanë autorizuar të lidhë Marrëveshjen dhe i kanë dhënë nënshkruesit(ve) autorizim për këtë, në pajtim me ligjet, dekretet, rregulloret, statutet dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të;

b) ekzekutimi dhe dorëzimi, përmbushja e detyrimeve të tij dhe pajtueshmëria me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje:

i) nuk është në kundërshtim ose konflikt me ndonjë ligj të zbatueshëm, statut, rregull ose rregullore ose vendim, dekret apo leje së cilës i nënshtrohet;

ii) nuk është në kundërshtim ose konflikt me ndonjë marrëveshje ose Instrument tjetër Borxhi detyrues për të cilin mund të pritej në mënyrë të arsyeshme që të shkaktonte ndonjë Ndryshim Negativ Material;

c) asnjë rast apo rrethanë e pazgjidhur që përbën mospërmbushje të detyrimeve sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër ose Instrumenti Borxhi që është detyrues për të ose së cilës u nënshtrohen sendet e saj pasurore që mund të priten në mënyrë të arsyeshme të shkaktojnë një Ndryshim Negativ Material;

d) një pale të tretë nuk i është dhënë asnjë Garanci në shkelje të nënklauzolës 8.2;

e) nuk ka filluar ose nuk rrezikon të fillojë asnjë procedurë gjyqësore, arbitrazhi ose administrative ose para ndonjë gjykate, gjykate arbitrazhi apo agjencie që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme të shkaktonte një Ndryshim Negativ Material (sipas dijenisë dhe besimit të tij më të mirë);

f) ka marrë një kopje të Rregullores së Huas, Politikës së Huas, Politikës Mjedisore dhe Udhëzimeve të Prokurimit dhe i ka regjistruar ato sipas rregullave.

Përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme konsiderohen të përsëritura në datën e nënshkrimit të secilës Kërkesë Disbursimi. Çdo ndryshim në lidhje me përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme për të gjithë periudhën e Huas duhet të njoftohet dhe çdo dokument mbështetës i jepet menjëherë CEB-it.



Nëse ndonjë prej përfaqësimeve dhe garancive të mësipërme është ose rezulton të ketë qenë e pasaktë ose çorientuese në ndonjë aspekt të caktuar, kjo do të përbënte një rast në lidhje me nenin 3.3 “h” të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë pezullim, anulim ose rimbursim të parakohshëm të Huas sipas kushteve të nenit 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i huave të disbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara) të Rregullores së Huas.

10. PALËT E TRETA

Brenda objektit dhe përdorimit të Huas, Huamarrësi nuk mund të paraqesë ndonjë fakt në lidhje me marrëdhëniet e tij me palët e treta, me qëllim shmangien e përmbushjes, qoftë plotësisht ose pjesërisht, të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja.

CEB-i nuk mund të përfshihet në mosmarrëveshje që mund të lindin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta dhe kosto, të çfarëdolloj natyre, të shkaktuara nga CEB-i në bazë të ndonjë pretendimi dhe në veçanti të gjitha kostot ligjore ose gjyqësore, duhet të jenë në ngarkim të Huamarrësit.

11. MOSHEQJA DORË

Në asnjë rast, duke përfshirë vonesën ose ushtrimin e pjesshëm, nuk do të prezumohet se CEB-i ka hequr dorë në mënyrë të heshtur nga ndonjë e drejtë e dhënë atij nga Marrëveshja.

12. DELEGIMI

Huamarrësi nuk mund të delegojë ose të transferojë ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes, pa pëlqimin paraprak me shkrim të CEB-it.

CEB-i mund të delegojë të gjithë ose ndonjë pjesë të të drejtave dhe përfitimeve të tij ose të transferojë të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave, përfitimeve dhe detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes.

13. LIGJI RREGULLUES

Marrëveshja rregullohet nga rregullat e CEB-it të përcaktuara në dispozitat e nenit 1, paragrafi 3 i Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959) të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet të Këshillit të Europës (të datës 2 shtator 1949) dhe, së dyti, nëse është e nevojshme, nga ligji francez.

14. MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve të Marrëveshjes i nënshtrohen arbitrazhit sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të Rregullores së Huas.

Palët bien dakord të mos përfitojnë nga ndonjë privilegj, imunitet ose legjislacion para ndonjë autoriteti juridiksional ose autoriteti tjetër, qoftë kombëtar apo ndërkombëtar, me qëllim kundërshtimin e zbatimit të një vendimi të paraqitur sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të Rregullores së Huas.

Në ndonjë padi ligjore që lind nga kjo Marrëveshje, vërtetimi i CEB-it në lidhje me ndonjë shumë të kërkueshme ose normë interesi të zbatueshme sipas Marrëveshjes, në mungesë të një gabimi të hapur, do të jetë e dhënë *prima facie* e kësaj shume ose norme interesi.

15. NJOFTIMET

Çdo njoftim ose komunikim tjetër që duhet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje për CEB-in ose Huamarrësin duhet të jetë me shkrim dhe konsiderohet të jetë dhënë ose bërë sipas rregullave kur dërgohet me postë rekomande ose faks nga njëra Palë tek adresa ose numri i faksit të Palës tjetër të përcaktuar më poshtë:

Për Huamarrësin dhe Vendin Përfitues:

Ministria e Financave

Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Faks: +355 4 222 8494

Për CEB-in:

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës

55 Avenue Kléber

75116 Paris

Francë

Në vëmendje të: Drejtorit, Departamenti i Projekteve

Faks: +33 1 47 55 37 52

Kopje për: Drejtorin, Bashkëpunimi dhe Strategjia Europiane

Faks: +33 1 47 55 71 55

Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera që duhet të jepen ose bëhen sipas Marrëveshjes, duhet të jenë në gjuhën angleze ose frënge ose,



nëse janë në një gjuhë tjetër, duhet të shoqërohen me një përkthim të vërtetuar të gjuhës angleze ose frënge kur kjo kërkohet nga CEB-i.

Pa cenuar vlefshmërinë e ndonjë njoftimi të dërguar me faks sipas paragrafëve të mësipërm, një kopje e secilit njoftim të dorëzuar me faks duhet të dërgohet edhe me postë rekomande te Pala përkatëse jo më vonë se në Ditën e mëpasshme të Punës.

Njoftimet e lëshuara nga Huamarrësi në bazë të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, kur kërkohen nga CEB-i, duhet t'i dërgohen CEB-it së bashku me të dhëna të pranueshme për autoritetin e personit ose personave të autorizuar për nënshkrimin e këtij njoftimi në emër të Huamarrësit dhe modelet e nënshkrimeve të vërtetuara të këtij personi ose këtyre personave.

16. TAKSAT DHE SHPENZIMET

Huamarrësi paguan, në masën e zbatueshme, të gjitha taksat, detyrimet, tarifat dhe shumat e tjera të vendosura të çdo lloji natyre, duke përfshirë detyrimin e vulës dhe tarifat e regjistrimit që lindin nga nënshkrimi, regjistrimi ose zbatimi i Marrëveshjes ose ndonjë dokumenti të lidhur me të, si dhe nga krijimi, realizimi, regjistrimi ose zbatimi ndonjë Sigurimi ose Garancie të kërkuar sipas Marrëveshjes.

Huamarrësi mbulon të gjitha tarifat dhe shpenzimet (duke përfshirë kostot ligjore, profesionale, bankare ose të shkëmbimit) të shkaktuara në lidhje me: i) përgatitjen, nënshkrimin, realizimin, zbatimin dhe përfundimin e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë dokumenti të lidhur me të; ii) çdo ndryshim, shtese ose heqjeje dorë në lidhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë dokumenti të lidhur me të; dhe iii) përgatitjen, nënshkrimin, realizimin, menaxhimin dhe zbatimin e ndonjë Sigurimi /Garancie të kërkuar sipas Huas.

Pavarësisht nga sa më sipër, neni 4.7 (Kostoja e Arbitrazhit) e Rregullores së Huas zbatohet në lidhje me kostot e arbitrazhit të përcaktuara sipas klauzolës 14.

17. LIRIMI NGA DETYRIMET

Pas shlyerjes të të gjithë principalit të papaguar sipas Huas, si dhe pagimit të të gjitha

interesave dhe shpenzimeve të tjera që rrjedhin nga Marrëveshja, duke përfshirë në veçanti shumat sipas nënklauzolës 4.9 dhe klauzolës 16, Huamarrësi do të lirohet plotësisht nga detyrimet e tij ndaj CEB-it, me përjashtim të atyre të përcaktuara në klauzolën 6 më sipër për qëllime të një vlerësimi të mundshëm të Projektit, të cilat nuk duhet të zhvillohen më vonë se dy (2) vjet pas shlyerjes të të gjithë principalit të papaguar sipas Huas.

18. HYRJA NË FUQI

Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga Palët dhe ratifikimit nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

19. AMENDIMET

Çdo amendim ose ndryshim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bihet dakord sipas rregullave ndërmjet Palëve dhe të bëhet me shkrim.

Për Huamarrësin dhe Vendin Përfutues, Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë ndonjë amendim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm Datën e Mbylljes nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

Në dëshmi të kësaj, Palët kanë marrë masa për nënshkrimin e Marrëveshjes në dy (2) kopje origjinale, ku secila është njëlloj e vlefshme dhe kanë marrë masa që nënshkruesit e përcaktuar më poshtë të vendosin inicialet në secilën faqe të kësaj Marrëveshjeje në emrin e tyre. Një (1) kopje origjinale mbahet nga secila prej Palëve.

[•], më [•]

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Ministër i Financave
Paris, më [•].

Për Bankën për Zhvillim të Këshillit të Europës

[Guvernatori/Zëvendësguvernatori]



SHTOJCA 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

I.	LD	LD 1841 (2014)
	Huamarrësi	Republika e Shqipërisë
	Tipi i Huas	Hua Projekti për financimin e Fazës së dytë të Programit të Reformës për Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës (QSUT)
	Shuma e Huas	15,930,000 EURO
	Miratimi nga Këshilli Administrativ i CEB-it	13 qershor 2014
II.	Sektori(ët) e veprimit	Shëndetësia
	Punët/komponentët e planifikuar	Projekti është faza e dytë e Programit të Reformës (PR) të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës (QSUT). Faza e parë e PR të QSUT-së është financuar nga një hua e disbursuar prej 14 milionë USD të dhënë nga CEB-i në vitin 2005. Faza e dytë e Projektit lidhet me përfundimin e punimeve në godinën kryesore të QSUT-së, dy kate shtesë dhe rehabilitimin e godinës së Mjekësisë së Përgjithshme të ndodhur afër godinës kryesore. Ajo përbëhet nga katër komponentë: 1. zgjerimi i godinës kryesore të fazës së parë, 2. rehabilitimi/rindërtimi i godinës së Mjekësisë së Përgjithshme, 3. komponenti i teknologjisë së informacionit (IT), 4. asistencë teknike dhe trajtim.
	Vendndodhja	QSUT-ja ndodhet në pjesën verilindore qendrore të Tiranës.
	Përfituesit përfundimtarë	Popullsia shqiptare dhe anëtarët e personelit të QSUT-së. Studentët pasuniversitarë do të përfitojnë nga infrastruktura e përmirësuar.
	Kostoja totale e Projektit	Llogaritur në shumën 24,900,000 EURO
	Plani i financimit	EURO 15,930,000 Huaja e CEB-it dhe EURO 1,500,000 Asistenca Teknike e CEB-it EURO 17,430,000 CEB-i total (70%) EURO 7,470,000 Qeveria e Shqipërisë (30%) Shpërndarja e llogaritur e kostove në bazë të zërave, pa TVSH: Godina kryesore EURO 12,470,000 Godina e Mjekësisë së Përgjithshme



		i) Ndërtimi dhe/ose rehabilitimi i: a) spitaleve publike; b) infrastruktura e shërbimeve publike mjekësore, duke përfshirë ato të specializuara në ndihmën për popullatat vulnerabil; ii) përshtatja e këtyre ambienteve me qëllim lehtësimin e aksesueshmërisë së tyre dhe qarkullimin e personave me lëvizshmëri të reduktuar. Projektet mund të përfshijnë trajnimin për personelin e specializuar në sektorët socialë dhe shëndetësorë. Brenda kuadrit të projekteve të shëndetësisë, financimi mund të jepet edhe për infrastrukturën bazë, si për shembull, mbledhja dhe trajtimi i ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta, duke përfshirë mbetjet toksike.
	Kostot e pranueshme	Kostot e pranueshme për financimin e CEB-it mund të përfshijnë: i) Koston e sondazheve ose studimeve (teknike, ekonomike ose tregtare, inxhinierike), si dhe koston e mbikëqyrjes teknike të projektit. Këto kosto nuk duhet të tejkalojnë 5% të koston totale të projektit, nëse nuk janë të justifikuara; ii) Ndërtimi/rinovimi/modernizimi ose blerja e godinave të lidhura drejtpërdrejt me një projekt; iii) Instalimi i infrastrukturës bazë, si për shembull, rrjetet e kanalizimeve të ujërave të zeza, furnizimi me ujë, energjia dhe telekomunikacioni, asgjësimi dhe trajtimi i ujërave të zeza, rrugët etj.; iv) Blerja e materialeve, pajisjeve dhe makinerive, si dhe kostot përkatëse të lidhura me trajnimin e personelit; v) Kontingjencat për kostot e paplanifikuara (teknike dhe/ose ngritjet e çmimeve), nëse përfaqësojnë mbulimin financiar në lidhje me ndryshimet e mundshme në sasinë e punës së kërkuar, llojin dhe sasinë e pajisjeve që duhet të blihen ose metodën e realizimit të projektit; vi) Kostot e lidhura me trajnimin profesional dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik; vii) Kostot e lidhura me pagat/rrogat për Njësinë e Zbatimit të Projektit; viii) Kostot e lidhura me auditimin financiar të pavarur për Huan dhe shfrytëzimin e Grantit. Kostot ose investimet financiare (pagimi i borxheve, rifinancimi, tarifët e interesit etj.) nuk mund të përfshihen në koston e llogaritur të projektit dhe nuk mund të financohen nga CEB-i. Kostot dhe taksat e lidhura me TVSH-në përjashtohen nga kostot e pranueshme.
	Kushtet Specifike	KUSHTET SHITESË PËR DISBURSIM NË BAZË TË NËNPARAGRAFIT 0 (Kushtet pararendëse të disbursimit të Transhit të parë): Republika e Shqipërisë nëpërmjet AZP/NJZP-së i komunikon CEB-it të dhënat e Llogarisë së Projektit dhe Llogarinë e Posaçme. Reparti i sterilizimit i ndërtuar dhe i pajisur nën Fazën e Parë duhet të vihet në përdorim. - NËNPARAGRAFI 4.5 (b) (iii) (Kushtet pararendëse të disbursimit për ndonjë Transh pasues): Disbursimi pasues varet nga marrja e një “Plani Transferimi për Pacientin”, duke përfshirë ndarjen në faza gjatë rinovimit të godinës së “Mjekësisë së Përgjithshme”. SIPËRMARRJET SPECIFIKE SHITESË TË PROJEKTTIT SIPAS NËNKLAUZOLËS 6.5: Për koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve për zbatimin e projektit, MSH-ja do të përdorë NJZP-në e krijuar për fazën e parë



		të QSUT-së të financuar nga CEB-i. Burime shtesë duhet të identifikohen dhe shfrytëzohen brenda një kohe sa më të shpejtë nga miratimi i Huas për të ndarë përgjegjësitë financiare dhe prokurimit, si dhe për të ndihmuar NJZP-në për menaxhimin e asistencës teknike.
IV.	Ndikimi social	Nëpërmjet përfundimit të fazës së dytë të QSUT-së, projekti do të përmirësojë ndjeshëm qasjen ndaj kujdesit të mirë cilësor spitalor për popullsinë shqiptare. Më shumë se 65,000 pacientë trajtohen në spital në vit; nga kjo shumë pothuajse 50% vijnë nga jashtë Tiranës. Ky projekt do të zbatojë kritere të reja për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe koordinimin midis departamenteve mjekësore. Në të njëjtën kohë, ai do të ofrojë ambiente të përmirësuara mjekësore dhe pajisje mjekësore moderne. Duke qenë një Spital Universitar, ai do të ofrojë edhe mundësi akademike dhe kërkimore për studentët e mjekësisë dhe në përgjithësi për personelin mjekësor.

SHTOJCA 2 MODEL I OPINIONIT LIGJOR

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës
55, Avenue Kléber
F-75116 Paris
Në vëmendje të: Departamentit të Projekteve
Kopje për: Zyrën e Drejtuesit të Departamentit Ligjor

[VENDOSNI DATËN]

Lënda: Marrëveshje Kuadër Financimi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës dhe Republikës së Shqipërisë

I/e nderuar zotëri/zonjë

Unë, [●], në cilësinë time si ëVENDOSNI TITULLIN (për shembull, Ministër i Financave, Drejtues i Shërbimeve Ligjore)], kam vepruar si këshilltar ligjor për çështje të së drejtës ëVENDOSNI JURIDIKSIONIN] në Republikën e Shqipërisë (“Huamarrësi” dhe “Vendi Përfitues”) në lidhje me Marrëveshjen Kuadër të Financimit ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (“CEB”) dhe Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e saj si Huamarrës dhe Vend Përfitues, të datës [●] dhe në fuqi që prej datës [●] (“Marrëveshja”) dhe jap këtë opinion në bazë të nenit [●] të Marrëveshjes.

Për qëllime të këtij Opinioni, kam shqyrtuar një kopje të Marrëveshjes dhe të dokumenteve, akteve ose traktateve të tjera që i kemi çmuar të nevojshme ose të dëshirueshme për shqyrtim, me qëllim dhënien e këtij opinioni.

Termat e përcaktuar në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në të, nëse nuk përcaktohet ndryshe.

Sa më sipër, jam i mendimit se:

1. Cilësia, fuqia dhe autoriteti. Republika e Shqipërisë ka cilësinë, fuqinë dhe autoritetin ligjor për të lidhur Marrëveshjen dhe për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Autorizimet e brendshme. Të gjitha masat e kërkuara nga Republika e Shqipërisë për nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes, duke përfshirë çdo autorizim të kërkuar nga organet e saj kompetente, janë marrë në mënyrë efektive dhe sipas rregullave. Në veçanti, nuk kërkohet asnjë masë e mëtejshme nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të ekzekutimit nga një përfaqësues i Republikës së Shqipërisë i autorizuar sipas rregullave, me qëllim lëshimin e një Kërkese për Disbursimin e Grantit ose një Kërkese për Disbursimin e Huas, sipas rastit, në bazë të Marrëveshjes.

3. Nënshkrimi dhe vlefshmëria e duhur. Marrëveshja është nënshkruar sipas rregullave nga [VENDOSNI EMRIN E NËNSHKRUESIT]] përfaqësuesi(t) e autorizuar sipas rregullave të Republikës së Shqipërisë dhe sjell sipërmarrje ligjërish të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë.



4. Autorizimet e jashtme, miratimet publike dhe depozitimet. Asnjë autorizim, miratim, licencë, përjashtim, depozitim, noterizim ose regjistrim nuk kërkohet në [VENDOSNI JURIDIKSIONIN] në lidhje me nënshkrimin, dorëzimin ose përmbushjen e Marrëveshjes, me qëllim shkaktimin e sipërmarrjeve ligjërish të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë dhe që Marrëveshja të jetë e pranueshme në bazë të të dhënave provuese në [VENDOSNI JURIDIKSIONIN].

5. Detyrimet Tatimore/të Vulës. Nënshkrimi i Marrëveshjes nuk i nënshtrohet asnjë detyrimi tatimor ose vule në [VENDOSNI JURIDIKSIONIN].

6. Zgjedhja e ligjit. Respektimi nga Republika e Shqipërisë i rregullave të CEB-it, të përcaktuara në dispozitat e nenit 1, paragrafi 3 të Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959) të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet të Këshillit të Europës (të datës 2 shtator 1949) dhe, së dyti, ndaj ligjeve të Francës, është ligjërish të vlefshëm dhe detyrues për Republikën e Shqipërisë sipas ligjeve të [VENDOSNI JURIDIKSIONIN].

7. Arbitrazhi. Paraqitja nga Republika e Shqipërisë në Gjykatën e Arbitrazhit të përcaktuar sipas kapitullit 4 të Rregullores së Huas të CEB-it në lidhje me ndonjë mosmarrëveshje që lind nga Marrëveshja, është ligjërish detyruese dhe e vlefshme për Republikën e Shqipërisë. Çdo vendim i kësaj Gjykate Arbitrazhi është i zbatueshëm në [VENDOSNI JURIDIKSIONIN] në pajtim me kushtet e nenit 3 të Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959) të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet të Këshillit të Europës (të datës 2 shtator 1949).

Me respekt,

[●]

[VENDOSNI EMRIN DHE POZICIONIN]

SHTOJCA 3

KËRKESË PËR DISBURSIMIN E HUAS (MODEL)

Në vëmendje të:

Drejtorit, Departamenti i Projekteve

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës

55, Avenue Kleber

75116 Paris, Francë

Faks: +33 (0) 1 47 55 37 52

LD 1841 (2014) – [●] Transhi i Huas

Duke iu referuar Marrëveshjes Kuadër të Financimit të datës [●] (më poshtë e referuar si “Marrëveshja”) ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (më poshtë e referuar si CEB) dhe [HUAMARRËSIT] (më poshtë i referuar si “Huamarrës”), [HUAMARRËSI] me anë të kësaj i kërkohet CEB-it, në përputhje me nënklauzolën 4.3 (a) të Marrëveshjes, të procedojë me disbursimin e një Transhi sipas termave dhe kushteve specifike të përcaktuara më poshtë.

Termat e përcaktuar në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në të, nëse nuk përcaktohet ndryshe.

Monedha/shuma	[●]		
Data e Disbursimit	[●]		
Periudha e Shlyerjes së Principalit	[●] vjet ëduke përfshirë një periudhë pa pagim interesi prej [●] vjetësh]		
Data (t) e Shlyerjes së Principalit	[●]		
Data e Maturitetit	[●]		
Norma e Interesit	Fiks	[●] në vit	
	E ndryshueshme	Norma referuese:	[[●]-muaj EURIBOR/VENDOSNI NDONJË NORMË TJETËR REFERUESE] në vit



		Marzhi	[●] pikët bazë në vit
Periudha e Interesit	[tremujore] ëgjashtëmujore] në shuma të prapambetura		
Datat e Pagesës së Interesit	Pagesa e interesit do të kryhet në datën [●] çdo vit dhe për herë të parë më [●]		
Marrëv. për Interesin e Shtuar	Marrëveshja për Ditën Pasuese të Punës të Ndryshuar		
Ditë pune	Çdo ditë në të cilën operon TARGET 2 (Sistemi i Transferimit Ekspres të Automatizuar Transeuropian të Shlyerjes Bruto në Kohë Reale).		
Llogaria e Projektit të Huamarrësit	Emri i Përfituesit		
	Banka e Përfituesit	Emri	[●]
		Qyteti	[●]
		SWIFT	[●]
		IBAN	[●]
		Referenca	[●]
	Banka korrespondente (nëse është e zbatueshme)	Emri	[●]
		Qyteti	[●]
		SWIFT	[●]
		IBAN	[●]

[●], në datën [●].

Për Huamarrësin

[vendosni EMRIN/EMRAT/POZICIONIN/POZICIONET]

NJOFTIM DISBURSIMI (MODEL)

LD 1841 (2014) – [●] Transhi i Huas

Në përgjigje të Kërkesës suaj për Disbursimin e Huas të datës [●], duke iu referuar Marrëveshjes Kuadër të Financimit të datës [●] (më poshtë e referuar si “Marrëveshja”) ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (më poshtë e referuar si CEB) dhe eHUAMARRËSIT (më poshtë i referuar si “Huamarrës”), me anë të kësaj CEB-i i njofton Huamarrësit në përputhje me nënklausolën 4.3 (b) të Marrëveshjes, termat dhe kushtet e disbursimit të Transhit përkatës.

Termat e përcaktuar në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në të nëse nuk përcaktohet ndryshe.

Monedha/shuma	[●]		
Data e Disbursimit	[●]		
Periudha e Shlyerjes së Principalit	[●]vjet ëduke përfshirë një periudhë pa pagim interesi prej ë[●] vjetësh]		
Data(t) e Shlyerjes së Principalit	[●]		
Data e Maturitetit	[●]		
Norma e Interesit	Fikse	[●] në vit	
	E ndryshueshme	Norma Referuese:	[[●]-muaj EURIBOR/VENDOSNI NDONJË NORMË TJETËR REFERUESE] në vit
		Marzhi	[●]] pikët bazë
Periudha e Interesit	ëtremujore] ëgjashtëmujore] në shuma të prapambetura		
Datat e Pagesës së Interesit	Pagesa e interesit do të kryhet në datën [●] çdo vit dhe për herë të parë më [●]		
Marrëv. për Interesin e Shtuar	Marrëveshja për Ditën Pasuese të Punës të Ndryshuar		
Ditë Pune	Çdo ditë në të cilën funksionon TARGET 2 (Sistemi i Transferimit Ekspres të Automatizuar Transeuropian të Shlyerjes Bruto në Kohë Reale).		
Llogaria e Projektit të Huamarrësit	Emri i Përfituesit		
	Banka e Përfituesit	Emri	[●]
		Qyteti	[●]
		SWIFT	[●]
		IBAN	[●]
		Referenca	[●]



	Banka korrespondente (nëse është e zbatueshme)	Emri	●
		Qyteti	●
		SWIFT	●
		IBAN	●
Llogaria e CEB-it	Emri i Përfituesit	Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës	
	SWIFT e Përfituesit	CEFPFRPP	
	Banka e Përfituesit	Emri	DeutscheBank
		Qyteti	Frankfurt (Gjermani)
		SWIFT	DEUTDEFF
		IBAN	DE44 5007 0010 0928 7384 00

Paris, në datën [●]

Për CEB-in

ëVENDOSNI EMRIN (AT)/POZICIONI (POZICIONET)]

SHTOJCA 4 RAPORTE PROGRESI

LD 1841 (2014) – Shtojca 4 Raport Monitorues

TABELA E LËNDËS

Shtojca 4a	Raport Narrativ
Shtojca 4b	Tabela 1 Kostot
Shtojca 4c	Tabela 2A Plani i Prokurimeve
Shtojca 4d	Tabela 2B Lista e Kontratave të Dhëna
Shtojca 4e	Tabela 3A Shfrytëzimi i Huas së CEB-it
Shtojca 4f	Tabela 3B Shfrytëzimi i LLDS-së
Shtojca 4g	Tabela 4 Burimet Financiare
Shtojca 4h	Tabela 5 Grafiku i Aktiviteteve
Shtojca 4i	Përmbushja e Projektit- Treguesit e Ambienteve/Shërbimeve

Shtojca 4j Përmbushja e Projektit- Treguesit Sektorialë

Shënim: Shtojcat 4a deri 4j janë modele dhe mund të ndryshohen me pëlqimin e të dyja Palëve.

Shtojca 4a

RAPORT NARRATIV MONITORUES

LD 1841 (2014) Financimi i Pjesshëm i Fazës 2 Rehabilitimi i Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës - QSUT Përmbledhje e Statusit të Projektit	
Kostoja e Llogaritur e Projektit të Pranueshëm: 24 900 000 EURO Shuma e Miratuar e Huas së CEB-it: 15 930 000 EURO Shuma e Miratuar e LLDS-së: 1 500 000 EURO Maks. % e pjesës së CEB-it: 70%	Objektivat: Nëpërmjet përfundimit të fazës së dytë të QSUT-së, projekti do të përmirësojë ndjeshëm qasjen në kujdesin e mirë cilësor spitalor për popullatën shqiptare. Më shumë se 65,000 pacientë trajtohen në vit në Spital; nga ky numër pothuajse 50% vijnë nga jashtë Tiranë. Ky projekt do të zbatojë kritere të reja për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe koordinimin midis departamenteve mjekësore. Në të njëjtën kohë do të ofrojë ambiente mjekësore të rinovuara dhe pajisje moderne mjekësore. Duke qenë një Spital Universitar, do të ofrojë edhe mundësi akademike dhe kërkimore për studentët e mjekësisë dhe në përgjithësi për personelin mjekësor.
% të Disbursuara ëdata] sipas LLDS-së: Huaja e CEB-it:	Historiku i Disbursimit (fundi i periudhës) (Informacion i bashkëlidhur i Përditësuar i Disbursimit, shihni tabelat 3 dhe 4)



	Aktual (sipas datës së raportit të progresit)	EURO
	I planifikuar (gjashtë muajt e ardhshëm)	EURO
	HUAJA E CEB-it	
	Aktual (sipas datës së raportit të progresit)	EURO
	I planifikuar (gjashtë muajt e ardhshëm)	EURO
Burime të tjera të planifikuara financimi: Buxheti i Shtetit	Historiku i Disbursimit (fundi i periudhës) (Informacion i bashkëlidhur i Përditësuar i Disbursimit, shihni tabelat 3 dhe 4)	
	Aktual (sipas datës së raportit të progresit)	EURO
	I planifikuar (gjashtë muajt e ardhshëm)	EURO
Data e hyrjes në fuqi: Data e mbylljes: 30.9.2019 Vitet e zbatimit:	Agjencia Zbatuese: Ministria e Shëndetësisë	

Përmbledhje e Statusit të Projektit:

Statusi i zbatimit deri tani është si më poshtë, sipas komponentit dhe shërbimeve/ambienteve:

1. Godina kryesore

a) Përshkrimi teknik:

Objekti: përfundimi i punimeve për godinën kryesore (faza e parë) kati i tretë dhe i katërt – rreth 5,600 metra katrorë

Përshkrimi i aktiviteteve të propozuara në periudhën aktuale:

-
-

b) Avancimi i Komponentëve:

Fitimi i Pronësisë së Truallit dhe Përgatitja

Studimet dhe Projektimi

Punimet

Grafiku i rishikuar për periudhën e ardhshme të raportimit (ose deri në fund të projektit)

c) Kostoja dhe Financimi i Projektit:

Përmbledhje e Disbursimit

Qarkullimi i Fondeve nga Burimi Financues

Përmbledhje e Përditësuar e Shpenzimeve të shkaktuara dhe të paguara

Shpenzimet e ardhshme dhe kostoja totale

d) Arritjet:

Rezultatet e arritura

Devijimet

Problemet e hasura

2. Godina e Mjekësisë së Përgjithshme

a) Përshkrimi teknik:

Objekti: Sipërfaqja totale e rehabilitimit është 9,000 metra katrorë me rreth 240 shtretër (225 në terapi të përgjithshme dhe 15 në terapi intensive) dhe 15 ambiente për dializa. Vlerësohet se godina e rindërtuar do të ofrojë hapësira të mjaftueshme për shërbimet e mëposhtme: kardiologji; gastro-hematologji; endokrinologji; hematologji; nefrologji dhe departamente për dializën.

Përshkrimi i aktiviteteve të propozuara në periudhën aktuale:

-
-

b) Avancimi i Komponentëve:

Fitimi i Pronësisë së Truallit dhe Përgatitja

Studimet dhe projektimi

Punimet

Grafiku i rishikuar për periudhën e ardhshme të raportimit (ose deri në fund të projektit)

c) Kostoja dhe financimi i Projektit:

Përmbledhje e Disbursimit

Qarkullimi i Fondeve nga Burimi Financues

Përmbledhje e Përditësuar e Shpenzimeve të shkaktuara dhe të paguara

Shpenzimet e ardhshme dhe kostoja totale

d) Arritjet:

Rezultatet e arritura

Devijimet



Problemet e hasura

3. Teknologjia e Informacionit (IT)

a) Përshkrimi teknik:

Objekti: Komponentët e IT-së do të përfshijnë harduerin dhe softuerin. Gjatë vlerësimit u vendos se paketa do të përfshijë modulet e mëposhtme:

- Sistemi i Administrimit të Pacientëve;
- Sistemi i Kontrollit të Stokëve (furnizimet mjekësore, produktet e konsumueshme dhe barnat);
- Regjistri i Pronave të Paluajtshme (pajisjet mjekësore; mobilimet; pajimet etj.);
- Menaxhimi Financiar;
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Telemjekësia.

Trajnimi në lidhje me përmirësimin e sistemit të pacientëve të shtruar dhe ambulatorë duhet të merret gjithashtu në konsideratë gjatë fazës së dytë. Trajnimi shtesë për menaxhimin spitalor dhe personelin që punon në godinat e ndërtuara gjatë fazës 1 dhe 2 do të ofrohet të paktën në lidhje me shfrytëzimin e burimeve dhe procesin e punës.

Përshkrimi i aktiviteteve të propozuara në periudhën aktuale:

-

-

b) Avancimi i Komponentëve:

Studimet dhe Projektimi

Punimet

Grafiku i rishikuar për periudhën e ardhshme të raportimit (ose deri në fund të projektit)

c) Kostoja dhe Financimi i Projektit:

Përmbledhje e Disbursimit

Qarkullimi i Fondeve nga Burimi Financues

Përmbledhje e Përditësuar e Shpenzimeve të shkaktuara dhe të paguara

Shpenzimet e ardhshme dhe kostoja totale

d) Arritjet:

Rezultatet e arritura

Devijimet

Problemet e hasura

4. Asistenca Teknike dhe Trajnimi

a) Përshkrimi teknik:

Objekti: Ky komponent do të mbulojë, ndër të tjera, përgatitjen e skicave, mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit; listën e pajisjeve mjekësore dhe mobilime mjekësore (në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë), mbikëqyrjen e instalimit të mallrave të përmendura më lart dhe do të ndihmojë Ministrinë e Shëndetësisë për përgatitjen e agjendës për realizimin e punimeve në godinën e Mjekësisë të Përgjithshme, si për shembull:

1. Mbulon nevojat e Njësisë së Zbatimit të Projektit nga muaji janar 2014 derisa Projekti të ratifikohet nga Parlamenti shqiptar;

2. Ndihmon Spitalin për vënien në përdorim të njësisë së centralizuar të sterilizimit që është ndërtuar dhe pajisur në katin e poshtëm përdhës të godinës kryesore, duke përfshirë trajnimin e personelit.

(1) Realizon përgatitjen teknike të Projektit mbi bazën e Master Planit të Përditësuar, duke përfshirë Projektimin Paraprak, Projektimin e detajuar, Specifikimet, Preventivët

3. Përcakton, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë, listën dhe specifikime të pajisjeve mjekësore, mobilimeve mjekësore, si dhe pajisje dhe mobilime të tjera (jomjekësore).

4. Përgatit përmbajtjen teknike të dosjeve të Tenderit dhe ofron mbështetje për autoritetet shqiptare gjatë vlerësimit të tenderit dhe kontraktimit si për punimet dhe për pajisjet.

5. Përgatit Planin e Transferimit për pacientët, duke përfshirë ndarjen në faza gjatë rinovimit të godinës së "Mjekësisë së Përgjithshme".

6. Kryen mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, duke përfshirë instalimin e të gjitha mallrave dhe pajisjeve.

7. Ndjek testimin dhe vënien në funksionim të të gjitha pajisjeve, duke përfshirë pajisjet mjekësore.

8. Ndihmon Njësinë e Zbatimit të Projektit për përgatitjen e një Manuali të Operacioneve dhe Mirëmbajtjes për këtë fazë 2 të Projektit.

9. Harton module trajnimi dhe për trajnimin e personelit përkatës në lidhje me elementet e reja funksionale dhe pajisjet e reja të fazës 2. Ky hap përfshin trajnimin e personelit kyç të identifikuar për kryerjen e trajnimit pas përfundimit të projektit.

Përshkrimi i aktiviteteve të propozuara në periudhën aktuale:

-

-

b) Avancimi i Komponentëve:



Studimet dhe Projektimi

Punimet

Grafiku i rishikuar për periudhën e ardhshme të raportimit (ose deri në fund të projektit)

c) Kostoja dhe Financimi i Projektit:

Përmbledhje e Disbursimit

Qarkullimi i Fondeve nga Burimi Financues

Përmbledhje e Përditësuar e Shpenzimeve të shkaktuara dhe të paguara

Shpenzimet e ardhshme dhe kostoja totale

d) Arritjet:

Rezultatet e arritura

Devijimet

Problemet e hasura

5. Aktivitetet e prokurimit

- Të financuara nga LLDS-ja

Plani i Prokurimeve

Rezultatet e ofertave

Zbatimi i kontratave

- Huaja e Financuar e CEB-it

Plani i Prokurimeve

Rezultatet e ofertave

Zbatimi i kontratave

- Buxheti i Financuar i Shtetit

Plani i Prokurimeve

Rezultatet e ofertave

Zbatimi i kontratave

6. Transparenca

(Njoftimet publike, tabela afishimi në sheshin e ndërtimit, artikuj në media/gazeta: lista e artikujve, burimet, datat dhe faqja/faqet e artikujve që përmendin CEB-in dhe/ose partnerë të tjerë; përkthimi i artikujve që përmendin CEB-in dhe/ose partnerë të tjerë nga pikëpamja e cilësisë.)

7. Çështje aktuale specifike të lidhura me Projektin (nëse ka)

8. Çështje aktuale të lidhura me personelin (nëse ka)

Plani i Propozuar i Veprimit për zgjidhjen e çështjeve (nëse ka):

Çështjet	Plani i Veprimit	Në ngarkim	Data e pritshme

SHTOJCA 5

PËRSHKRIMI I ASISTENCËS TEKNIKE PËR PROJEKTIN

Referenca:	LLDS-7-TA (2014)
Përfutuesi:	Republika e Shqipërisë
Njësia Zbatuese:	Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet Njesisë së Zbatimit të Projektit (NJZP) të krijuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë
Miratimi nga Këshilli Administrativ i CEB-it:	13 qershor 2014
Shuma e miratuar:	1 500 000 EURO
Objektivat:	A) Në fazën e hershme përgatitore që nënkupton kohën kur Projekti ratifikohet nga Parlamenti shqiptar, Granti i LLDS-së do të mbështesë AZP-në dhe NJZP-në nëpërmjet ofrimit të fondeve për aktivitetet e mëposhtme: 1. Mbulimi i pagave (tre anëtarë personeli) dhe kostot rrjedhëse të Njesisë së Zbatimit të Projektit (NJZP) që është krijuar për Projektin nga muaji janar 2014 e në vazhdim, dhe derisa Projekti të ratifikohet nga Parlamenti shqiptar; 2. Të ndihmojë Spitalin për të vënë në përdorim repartin e centralizuar të sterilizimit që u ndërtua dhe u pajis gjatë fazës së parë (kati i poshtëm përdhes i “Spitalit të Ri”), duke përfshirë ritrajnimin e personelit. B) Në fazat e përgatitjes dhe zbatimit, synimi i Asistencës Teknike (AT) është të ndihmojë: i) Ministrinë e



	Shëndetësisë; ii) Njësinë e Zbatimit të Projektit; dhe iii) Spitalin për të përgatitur dhe zbatuar Projektin. Objekti i kësaj Asistence Teknike, përfshin: 3. Realizimin e përgatitjes teknike të Projektit mbi bazën e Master Planit të rishikuar, duke përfshirë Projektimin Paraprak, Projektimin e Detajuar, Specifikimet, Preventivët; 4. Përcaktimin, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë, të listës dhe specifikimeve të pajisjeve mjekësore, mobilimeve mjekësore, si dhe pajisjeve dhe mobilimeve të tjera (jomjekësore); 5. Përgatitjen e përmbajtjes teknike të Dosjeve të Tenderit; 6. Përgatitjen e një Plani Transferimi për pacientët, duke përfshirë ndarjen në faza gjatë rinovimit të godinës së “Mjekësisë së Përgjithshme”; 7. Realizimin e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, duke përfshirë instalimin e të gjitha mallrave dhe pajisjeve; 8. Ndjekjen e testimit dhe vënies në funksionim të të gjitha pajisjeve, duke përfshirë pajisjet mjekësore; 9. Ndihmën për Njësinë e Zbatimit të Projektit për përgatitjen e Manualit të Operacioneve dhe mirëmbajtjen për këtë fazë të dytë të Projektit; 10. Hartimin e moduleve të trajnimit dhe trajnimit e stafit përkatës në lidhje me elementet funksionale të reja dhe pajisjet e reja të fazës së dytë. Ky përfshin trajnimin e stafit kryesor të identifikuar për kryerjen e trajnimit pas përfundimit të projektit. 9. Të ndihmojë Njësinë e Zbatimit të Projektit për hartimin e Manualit të Operacioneve dhe Mirëmbajtjes për fazën e mëparshme të parë të Projektit, duke përfshirë përkthimin e dokumenteve kryesore në gjuhën shqipe; 10. Të ndihmojë Njësinë e Zbatimit të Projektit dhe Drejtorin e Spitalit për hartimin e Planit të Operacioneve dhe Mirëmbajtjes, duke përfshirë përkthimin e dokumenteve kryesore në gjuhën shqipe; 11. Mbi bazën e moduleve ekzistuese të trajnimeve që janë përgatitur në fazën I, stafi përkatës duhet të trajnohet në lidhje me elementet dhe pajisjet e reja funksionale të fazës I. Ky hap përfshin “trajnimin e trajnerëve” pas përfundimit të projektit; 12. Të ndihmojë Njësinë e Zbatimit të Projektit dhe Drejtorin e Spitalit për përcaktimin e një strategjie afatgjatë trajnimi dhe hartimin e një Plani Menaxhimi të Trajnimit për të gjithë personelin; 13. Të ndihmojë drejtorin e Spitalit për përgatitjen e një Plani të Menaxhimit Mjedisor (PME), duke përfshirë të gjitha çështjet e pazgjidhura të identifikuara në sistemin e furnizimit me energji dhe raportet e Studimit të Ndikimit Mjedisor, si dhe një plan veprimi afatmesëm për zbatimin e këtij PME-je; ky duhet të përfshijë një strategji për menaxhimin e mbetjeve. 14. Të implementojë paketën sinjalizuese për ambientet e ndërtuara sipas fazës I.		
Vendndodhja:	Tiranë, Republika e Shqipërisë		
Analiza e kostos indikative:	Aktiviteti	Milion EURO	Financuar nga Granti i LLDS-së
	Pagat e Njësisë së Zbatimit të Projektit sapo Marrëveshja të ratifikohet nga Parlamenti shqiptar	0.05	Plotësisht
	Asistencë ndaj QSUT-së për të vënë në përdorim repartin e centralizuar të sterilizimit	0.02	Plotësisht
	Shërbime të nënkontraktuara të konsulencës teknike për përgatitjen e projektimit të detajuar dhe paraprak, duke përfshirë pajisjet mjekësore, pajisje dhe mobilime të tjera, si dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, duke përfshirë instalimin, testimin dhe vënien në funksionim të pajisjes, dhe Plani i Transferimit	1.20	Plotësisht
		0.02	
	Komponenti i trajnimit për fazën II (duke përfshirë hartimin e moduleve të trajnimit, personelin trajnues, përfshirë menaxherët, “trajnimin e trajnerëve”)	0.12	Plotësisht
	Asistenca teknike për menaxhimin e QSUT-së	0.07	Plotësisht
	Kontingjenca	0.02	Plotësisht
	Kostoja totale e Aktivitetit	1.5	
Grafiku indikativ:	01 nëntor 2014 – 31 dhjetor 2018 Asistenca Teknike do të jetë funksionale deri në përfundimin e projektit, aktualisht të planifikuar në vitin 2018.		
Data e përfundimit:	30 shtator 2019		



Pranueshmëria:	Projekti i Asistencës Teknike është i pranueshëm në përputhje me Politikën e LLDS-së. Granti i LLDS-së është për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e projektit. Asistenca Teknike e Projektit lehtëson Projektin (duke iu referuar numrit LD 1841 (2014)).
Produktet dhe rezultatet e pritshme:	Produktet e pritshme të aktiviteteve, janë: - i) të vërë në përdorim repartin e centralizuar të sterilizimit që është ndërtuar dhe pajisur sipas fazës I dhe të ketë personel të trajnuar funksional për përdorimin e repartit të sterilizimit - ii) të ketë konsulencë të specializuar për Njësinë e Zbatimit të Projektit në përgatitjen teknike të projektit, duke përfshirë ofrimin e Projektimit Paraprak, Projektimit të Detajuar, Specifikimet, Preventivët etj, në bazë të Master Planit të Përditësuar; të ketë një listë dhe specifikime të pajisjeve mjekësore, mobilimeve mjekësore dhe pajisjeve e mobilimeve të tjera (jomjekësore) të nevojshme për funksionimin e spitalit, duke përfshirë testimin e tyre dhe pasjen e një Plani Transferimi për pacientët gjatë rinovimit të godinës së “Mjekësisë së Përgjithshme”; - iii) të ndihmohet dhe këshillohet Njësia e Zbatimit të Projektit për përgatitjen e dosjeve të Tenderit dhe çështje të tjera të lidhura me prokurimin dhe të kryhet mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit, duke përfshirë instalimin e të gjitha mallrave dhe pajisjeve; - iv) të ketë staf të trajnuar funksional për elementet e reja funksionale dhe pajisjet e fazës II dhe një Manual të Mirëmbajtjes dhe operacioneve për këtë fazë të dytë të Projektit të përgatitur dhe në përdorim.
Kushtet Specifike:	E pazbatueshme

SHTOJCA 6

KËRKESË PËR DISBURSIMIN E GRANTIT TË LLDS-së

(Model)

<Data, vendi>

Në vëmendje të:

CEB

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës

55 avenue Kléber

F – 75116 Paris

Titulli i Marrëveshjes Kuadër të Financimit: “PROGRAMI I REFORMËS MBI QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE TË TIRANËS (QSUT), FAZA II – Huaja e Projektit- Me Asistencë Teknike të financuar nga Granti i LLDS-së”

Numrat e Referencës: LD 1841 (2014) dhe LLDS-7-TA (2014)

Kërkesë për numrin e disbursimit: <Shënoni numrin>

I/e nderuar zotëri/zonjë,

Me anë të kësaj kërkoj disbursimin e <Shënoni numrin e Transhit të Grantit>Transhit të Grantit sipas Marrëveshjes Kuadër të lartpërmendur të Financimit.

Shuma e kërkuar është EURO < ...>.

Ju lutem gjeni bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme mbështetëse:

- ëRaport Progresi]

- Parashikimi i qarkullimit monetar

Disbursimi i Transhit të Grantit duhet të bëhet në Llogarinë e Projektit me të dhënat e mëposhtme:

Emri i mbajtësit:

Llogaria nr. IBAN:

SWIFT BIC:

Me anë të kësaj vërtetoj se informacioni në përmbajtje të kësaj Kërkese për Disbursimin e Grantit të LLDS-së për disbursimin e Transhit të Grantit është i plotë dhe i besueshëm.

Me respekt,

<Nënshkruesi i Autorizuar->

**UDHËZIM****Nr. 2, datë 13.3.2015**

**PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE TË
PËRGJITHSHME BAZË NË SIGURINË E
AVIACIONIT CIVIL, TË PËRCAKTUARA NË
ANEKSIN E UDHËZIMIT NR. 26, DATË
20.10.2010 “MBI RREGULLAT E
PËRGJITHSHME NË FUSHËN E SIGURISË
SË AVIACIONIT CIVIL”¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika (ç) të ligjit 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:**Neni 1****Objekti dhe qëllimi**

Ky udhëzim siguron plotësimin e standardeve të përgjithshme bazë të përcaktuara në anekset e udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010 “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar, me qëllim që:

- a) të përcaktojë metodat e lejuara të skanimit siç paraqiten në pjesën A të aneksit;
- b) të përcaktojë kategoritë e ndaluara të artikujve siç paraqiten në pjesën B të aneksit;
- c) të përcaktojë arsyet për dhënien aksesit në zonat ajrore dhe në zonat e kufizuara të sigurisë siç paraqiten në pjesën C të aneksit;
- d) të përcaktojë metodat për kontrollin e automjeteve, kontrollin e sigurisë së avionit dhe kërkimet e sigurisë së avionit siç paraqiten në pjesën D të aneksit;

e) të përcaktojë kriteret për njohjen e barasvlefshmërisë së standardeve të sigurisë të vendeve të treta, siç janë përcaktuar në pjesën E të aneksit;

f) të përcaktojë kushtet, sipas të cilave kargoja dhe posta ajrore do të skanohen ose do të jenë subjekt i kontrolleve të tjera të sigurisë dhe të përcaktojë procedurën e miratimit ose caktimit të agjentëve të rregullt, dërgueseve të njohur dhe dërguesve përgjegjës siç janë përcaktuar në pjesën F të aneksit;

g) të përcaktojë kushtet, sipas të cilave transportuesi ajror i postës dhe transportuesi ajror i materialeve do të skanohen ose do të jenë subjekt i kontrolleve të tjera të sigurisë siç janë përcaktuar në pjesën G të aneksit;

h) të përcaktojë kushtet, sipas të cilave furnizuesi ajror dhe furnizuesi i aeroportit do të skanohen ose do të jenë subjekt i kontrolleve të tjera të sigurisë, si dhe të përcaktojë procedurën e miratimit ose caktimit të furnizuesit të rregullt dhe furnizuesit të njohur siç janë përcaktuar në pjesën H të aneksit;

i) të përcaktojë kriteret për specifikimin e pjesëve kritike të zonave të kufizuara të sigurisë, siç janë përcaktuar në pjesën I të aneksit;

j) të përcaktojë kriteret të cilat duhet të zbatohen për rekrutimin e personave, të cilët do të imple-mentojnë ose do të jenë përgjegjës për imple-mentimin e skanimit, kontrollit të hyrjeve ose kontro-llave të tjera të sigurisë dhe instruktorët, si dhe të përcaktojë metodat e trajnimit për këta persona dhe për personat të cilët do të pajisen me fletë-hyrje aeroporti ose kartë identifikimi ekuipazhi siç janë përcaktuar në pjesën J të aneksit;

k) të përcaktojë kushtet, sipas të cilave do të zbatohen procedurat specifike të sigurisë ose përjashtimi nga kontrollet e sigurisë, siç janë përcaktuar në pjesën K të aneksit.

Neni 2**Përkufizimet**

Për qëllim të këtij udhëzimi, përkufizimet e mëposhtme do të kenë kuptimin si vijon:

1. “Furnizime të aeroportit” do të thotë të gjithë artikujt me qëllimin për t’u shitur, përdorur ose të disponueshëm në zonat e kufizuara të sigurisë së aeroportit;

2. “Furnizime në fluturim” do të thotë të gjithë artikujt që merren në bordin e avionit, me qëllimin për përdorim, konsumim ose për blerje nga pasagjerët ose ekuipazhi gjatë një fluturimi dhe që janë të ndryshëm nga:

- bagazhet e kabinës;

¹Ky udhëzim përaftron rregulloren e Komisionit nr. 272/2009/KE të 2 prillit 2009 “Plotësimin e standardeve të përbashkëta themelore mbi sigurinë e aviacionit civil të përcaktuar në shtojcën e rregullores (KE) nr 300/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit”.



- artikuj të mbartur nga persona që nuk janë pasagjerë;

- transportuesi ajror i postës dhe transportuesi ajror i mallrave;

3. “Furnizues i rregullt i furnizimit në fluturim” do të thotë një furnizues, ku procedurat e tij janë në përputhje me rregullat e përgjithshme të sigurisë dhe standardet e përcaktuara që lejojnë transportimin e furnizimit të fluturimit direkt në avion;

4. “Furnizues i njohur i furnizimeve në fluturim” do të thotë një furnizues, ku procedurat e tij janë në përputhje me rregullat e përgjithshme të sigurisë dhe standardet e përcaktuara që lejojnë transportimin e furnizimit të fluturimit tek një transportues ajror ose agent i rregullt, por jo direkt në avion;

5. “Furnizues i njohur i furnizimeve, të aeroportit” do të thotë një furnizues ku procedurat e tij janë në përputhje me rregullat e përgjithshme të sigurisë dhe standardet e përcaktuara që lejojnë transportimin e furnizimeve të aeroportit në zonat e kufizuara të sigurisë.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky udhëzim dhe aneksi bashkëlidhur si pjesë përbërëse tij, është detyrues dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Sanksionet

Autoriteti i Aviacionit Civil, për shkeljet e dispozitave të këtij udhëzimi, duhet të aplikojë masa administrative dhe/ose gjopa sipas përcaktimeve dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Zbatimi

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij udhëzimi dhe hartimin e procedurave teknike që detajojnë hapat për zbatim dhe mbikëqyrjen e proceseve të përcaktuara në të.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

ANEKSI

PJESA A

Metodat e lejuara të skanimit

Rregullat zbatuese të përcaktuara në nenin 4(3) të udhëzimit nr. 26 datë, 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar, mund të lejojnë përdorimin e metodave të mëposhtme të skanimit, në mënyrë individuale ose të kombinuara, si një mënyrë parësore ose dytësore të përcaktuara si më poshtë:

1. Për skanimin e personave aplikohen:

- a) kontroll me dorë;
- b) pajisja e detektorit metalik të kalueshëm (PDM);
- c) pajisja e detektorit metalik të kontrollit me dorë (PDMKD);
- d) qen për zbulimin e lëndëve plasëse;
- e) pajisje për zbulimin e gjurmëve eksplozive;
- f) skanerët e sigurisë të cilët nuk përdorin rrezatimin jonizues.

2. Për skanimin e bagazheve të kabinës, për artikujt e mbartur nga persona që nuk janë pasagjerë, për postën e transportuesit ajror dhe materialet e transportuesit ajror, përveç kur janë për ngarkim në pjesën mbajtëse (barkun) të avionit, për furnizimet në fluturim dhe furnizimet e aeroportit, do të aplikohet:

- a) kontroll me dorë;
- b) kontroll vizual;
- c) pajisje me rreze-X;
- d) pajisje me sistem për zbulimin e eksplozivëve (SDE);
- e) qen për zbulimin e eksplozivëve; dhe
- f) pajisje për zbulimin e gjurmëve të eksplozive.

3. Për skanimin e lëngjeve, aerosolëve (aerosols) dhe xhelrave (*gels*), do të aplikohen:

- a) duke e provuar ose duke e testuar në lëkurë;
- b) kontroll vizual;
- c) pajisje me rreze-X;
- d) pajisje me sistem për zbulimin e eksplozivëve (SDE);
- e) qen për zbulimin e eksplozivëve;
- f) pajisje për zbulimin e gjurmëve eksplozivëve (DGJE);
- g) shirita për testimin e reaksionit kimik;
- h) skanim për lëngjet në shishe.

4. Për skanimin e bagazheve të mëdha, kargos dhe postës ajrore, si dhe për postën e transportuesit ajror dhe materialet e transportuesit ajror, që do ngarkohen në pjesën mbajtëse (barkun) e avioni, do të aplikohen:

- a) kontroll me dorë;



- b) kontroll vizual;
- c) pajisje me rreze-X;
- d) pajisje me sistem për zbulimin e eksplozivëve (SDE);
- e) qen për zbulimin e eksplozivëve;
- f) pajisje për zbulimin e gjurmëve eksplozive (DGJE);
- g) dhomë/ambient simulimi;
- h) pajisja për detektimin e metaleve.

PJESA B

Kategoritë e artikujve që mund të jenë të ndaluar

Rregullat zbatuese të përcaktuara në nenin 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar, mund të ndalojnë, sipas kushteve të përcaktuara, futjen në zonat e kufizuara të sigurisë dhe në bordin e avionit të ndonjë ose të gjitha kategorive të artikujve të përcaktuar si më poshtë:

- a) armë, armë zjarri dhe pajisje të tjera që hedhin predha – pajisje të afta, ose që duken të mundshme që mund të përdoren për të shkaktuar dëmtime serioze duke shkarkuar lëndë të tilla;
- b) pajisje trullësë – pajisje të prodhuara në mënyrë që të trullojnë ose të bllokojnë;
- c) objekt me majë të mprehtë ose me cepa të mprehtë – objekte me majë të mprehtë ose me cepa të mprehtë të cilat mund të përdoren për shkaktimin e plagëve serioze;
- d) vegla pune – vegla të cilat mund të përdoren për të shkaktuar plagë serioze ose për të kërcënuar sigurinë e avionit;
- e) instrumente mpirës – objekte të cilat mund të përdoren për të shkaktuar plagë serioze kur të qëllonjë me to; dhe
- f) eksplozive, substanca djegëse dhe pajisje – eksplozive, substanca djegëse dhe pajisje të mundshme, ose në dukje të mundshme, të përdoren për shkaktimin e plagëve serioze ose të paraqesin rrezik të sigurisë së avionit.

PJESA B1

Lëngjet, aerosolët, xheli

Lëngjet, aerosolët dhe xheli duhet të lejohen të mbahen në zonat e kufizuara të sigurisë dhe në bordin e një avioni me kushtin që të jenë skanuar ose kur janë përjashtuar nga skanimi në përputhje me kërkesat dhe rregullat e përgjithshme bazë në përputhje me nenin 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar.

Faqe | 1986

PJESA C

Hyrja e kontrolluar: arsyet për dhënien e aksesit në zonën ajrore dhe në zonat e kufizuara të sigurisë

Hyrja e kontrolluar në zonën ajrore dhe në zonat e kufizuara të sigurisë duhet të jepet në përputhje me kriteret e mëposhtme:

1. Hyrja e kontrolluar në zonën ajrore mund të autorizohet vetëm nëse personat dhe automjetet kanë arsye legjitime për të hyrë atje.

Me qëllim që të arsyetohet hyrja e kontrolluar në zonën ajrore, personi duhet të pajiset me një autorizim të vlefshëm.

Me qëllim që të arsyetohet hyrja e kontrolluar në zonën ajrore, automjeti duhet të pajiset me një leje-kalim automjeti të vlefshme.

2. Hyrja e kontrolluar në zonat e kufizuara të sigurisë mund të autorizohet vetëm nëse personat dhe automjetet kanë arsye legjitime për të hyrë atje.

Me qëllim që të arsyetohet hyrja e kontrolluar në zonat e kufizuara të sigurisë, personi duhet të paraqesë një autorizim.

Me qëllim që të arsyetohet hyrja e kontrolluar në zonat e kufizuara të sigurisë automjeti duhet të mbajë në vend të dukshëm një lejë kalimi automjeti.

PJESA D

Metodat e lejuara për kontrollin e automjeteve, kontrollin e sigurisë së avionit dhe kërkimet e sigurisë së avionit

Rregullat zbatuese të përcaktuara në nenin 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar, mund të lejojnë përdorimin e metodave të mëposhtme për kontrollin e automjeteve, kontrollin e sigurisë dhe të kërkimit të sigurisë së avionit, në mënyrë individuale ose të kombinuara, si një mënyrë parësore ose dytësore dhe sipas kushteve të përcaktuara më poshtë:

- a) kontroll me duar;
- b) kontroll vizual;
- c) qen për zbulimin e eksplozivëve; dhe
- d) pajisje për zbulimin e gjurmëve të eksplozivëve (DGJE).

Në mënyrë që të vlerësohen metodat e skanimit duke përdorur teknologjitë e reja që nuk janë parashikuar në kohët e adoptimit të kësaj rregulloreje, rregullat zbatuese që do të përcaktohen sipas nenit 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së



aviacionit civil”, të ndryshuar, mund të lejojnë përdorimin e metodave të tjera mbi bazën e gjykimit dhe për një periudhë të kufizuar kohe me kushtin që gjykime të tilla nuk cenojnë nivelet e sigurisë në përgjithësi.

PJESA E

Kriteret për njohjen e barazvlefshmërisë së standardeve të sigurisë të Republikës së Shqipërisë-së nga KE

Komisioni Evropian mund të njohë barazvlefshmërinë e standardeve të sigurisë së Republikës së Shqipërisë/Autoritetit të Aviacionit Civil, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) Republika e Shqipërisë ka të dhëna të mira bashkëpunimi me Komunitetin dhe Shtetet Anëtare të tij;

b) Autoriteti i Aviacionit Civil vërteton që ka zbatuar standardet e pranueshme të sigurisë së aviacionit, duke përfshirë kontrollin e cilësisë;

c) Autoriteti i Aviacionit Civil ka vërtetuar që:

- në lidhje me pasagjerët dhe bagazhet e kabinës, masat e sigurisë janë zbatuar në mënyrë të barasvlershme me ato të përcaktuara në paragrafët 1, 3, 11, dhe 12 dhe pika 4.1 dhe 4.2 të aneksit të udhëzimit nr. 26, datë 20.10. 2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar.

- në lidhje me bagazhet e mëdha, masat e sigurisë janë zbatuar në mënyrë të barasvlershme me ato të përcaktuara në paragrafët 1, 3, 5, 11, dhe 12 të aneksit të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010 “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar.

- në lidhje me kargon dhe postën ajrore, masat e sigurisë janë zbatuar në mënyrë të barasvlershme me ato të përcaktuara në paragrafët 1, 3, 6, 11 dhe 12 të aneksit të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar.

- në lidhje me sigurinë e avionit, masat e sigurisë janë zbatuar në mënyrë të barasvlershme me ato të përcaktuara në paragrafët 1, 3, 11, dhe 12 dhe pika 4.1 dhe 4.2 të aneksit të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar.

PJESA F

Kargo dhe posta ajrore

1. Mallrat (cargo) dhe posta ajrore (mail): kushtet,

sipas të cilave ato do të skanohen ose janë subjekt i kontroleve të tjera të sigurisë.

Mallrat dhe posta ajrore që ngarkohen në avion duhet të skanohen, përveç;

a) kur ngarkesës i është bërë kontroll sigurie nga një agjent i rregullt dhe ngarkesa/ dërgesa ka qenë e mbrojtur nga ndërhyrje të paautorizuara që nga koha që i është bërë kontrolli i sigurisë;

b) kur ngarkesës i është bërë kontroll sigurie nga një dërgues i njohur dhe ngarkesa ka qenë e mbrojtur nga ndërhyrje të paautorizuara që nga koha që i është bërë kontrolli i sigurisë;

c) kur ngarkesës i është bërë kontroll sigurie nga një dërgues i njohur dhe ngarkesa ka qenë e mbrojtur nga ndërhyrje të paautorizuara që nga koha që i është bërë kontrolli i sigurisë, dhe kargo është transportuar në avionin e kargos ose e gjithë posta është transportuar në avionin e postës;

d) kur kargos dhe postës i është bërë kontroll sigurie në transit, siç kërkohet në pikën 6.1.2 të aneksit të udhëzimit të ministrit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së Aviacionit Civil”, të ndryshuar.

2. Kargo dhe posta ajrore: procesi për aprovimin ose caktimin e agjentit të rregullt, dërguesit të njohur dhe dërguesit përgjegjës

Për miratimin ose caktimin e agentëve të rregullt, dërgueseve të njohur dhe dërgueseve përgjegjës duhet të zbatohet procesi i mëposhtëm:

a) Agjentët e rregullt duhet të miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC).

Për t’u miratuar si një agjent i rregullt, aplikanti duhet të paraqesë në Autoritetin e Aviacionit Civil, dokumentacionin në standardet e sigurisë së aviacionit dhe më tej do të jetë subjekt i verifikimit në vend, në mënyrë që Autoriteti i Aviacionit Civil të sigurohet që aplikanti plotëson standardet e kërkuara.

b) Dërguesit e njohur duhet të miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC).

Për t’u miratuar si një dërgues i njohur, aplikanti duhet të paraqesë në Autoritetin e Aviacionit Civil, dokumentacionin në standardet e sigurisë së aviacionit dhe më tej do të jetë subjekt i verifikimit në vend në mënyrë që Autoriteti i Aviacionit Civil të sigurohet që aplikanti plotëson standardet e kërkuara.

Si një alternativë të miratimit Autoriteti i Aviacionit Civil mund të lejojë që një dërgues i njohur të përcaktohet nga një agjent i rregullt. Ky lejim do të jetë deri në një datë që do të përcaktohet në rregullat implementuese që do të adoptohen sipas



nenit 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar.

c) Dërguesit përgjegjës duhet të përcaktohen nga një agjent i rregullt.

Agjenti i rregullt, në mënyrë që të përcaktojë një subjekt si një dërgues përgjegjës, duhet të sigurohet që dërguesi përgjegjës i ardhshëm zotëron informacionin mbi standardet e sigurisë në aviacion, dhe pastaj t'i japë atij vlefshmërinë.

PJESA G

Posta e transportuesit ajror dhe materialet e transportuesit ajror, kushtet sipas të cilave ato duhet të skanohen ose të bëhen subjekt i kontrolleve të tjera të sigurisë

Posta dhe materialet e transportuesit ajror që do të ngarkohen në ndarjet e brendshme të avionit, duhet të skanohen si bagazh i madh ose të jenë subjekt i kontrollit të njëjtë të sigurisë si i kargos dhe postës.

Posta dhe materialet e transportuesit ajror që do të ngarkohen në ndonjë pjesë tjetër të avionit, e ndarë nga ajo për ngarkesat në përgjithësi, do të skanohen si bagazh kabine.

PJESA H

Furnizimet e fluturimit dhe furnizimet e aeroportit

1. Furnizimet e fluturimit dhe furnizimet e aeroportit: kushtet sipas të cilave ato do të skanohen ose bëhen subjekt i kontrolleve të tjera të sigurisë.

1.1 Furnizimet e fluturimit që do të ngarkohen në një avion do të skanohen, përveç rasteve:

a) kur furnizimit i është bërë kontroll sigurie nga një transportues ajror që e transporton furnizimin në avionin e tij dhe furnizimet kanë qenë të mbrojtura nga ndërhyrje të paautorizuara prej kohës kur i është bërë kontrolli i sigurisë deri kur është transportuar në avion; ose

b) kur furnizimit i është bërë kontroll sigurie nga një furnizues i rregullt dhe furnizimet kanë qenë të mbrojtura nga ndërhyrje të paautorizuara prej kohës që është bërë kontrolli i sigurisë deri kur është transportuar në avion ose, ku është e aplikueshme, për një transportues ajror ose për një tjetër furnizues të rregullt; ose

c) kur furnizimit i është bërë kontroll sigurie nga një furnizues i njohur dhe furnizimet kanë qenë të mbrojtura nga ndërhyrje të paautorizuara prej kohës që i është bërë kontrolli i sigurisë deri kur është

transportuar në avion ose për furnizuesi të rregullt.

1.2 Furnizimet e aeroportit duhet të skanohen përpara se të lejohen në zonat e kufizuara të sigurisë, përveç kur kontrollet e sigurisë për furnizimet janë kryer nga një furnizues i njohur dhe furnizimet kanë qenë të mbrojtura nga ndërhyrje të paautorizuara prej kohës që i është bërë kontrolli i sigurisë deri në momentin që janë futur në zonat e kufizuara të sigurisë.

2. Furnizimet e fluturimit dhe furnizimet e aeroportit: procesi për miratimin e ose përcaktimin e furnizueseve të rregulluar dhe furnizueseve të njohur.

2.1 Furnizuesit e rregullt të furnizimit në fluturim duhet të miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil në një datë që do të përcaktohet në rregullat implementuese që do të adoptohen sipas nenit 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar.

Në mënyrë që të miratohet si një furnizues i rregullt i furnizimeve në fluturim, aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin sipas standardeve të sigurisë së aviacionit dhe më tej do të jetë subjekt i verifikimit në vend që Autoriteti i Aviacionit Civil të sigurohet se aplikanti i plotëson standardet e kërkuara.

2.2 Furnizuesit e njohur të furnizimeve në fluturim do të përcaktohen nga operatori ose entiteti i cili dërgon furnizimin.

Në mënyrë që të miratohet si një furnizues i njohur i furnizimeve në fluturim, operatori ose entiteti të cilit i dërgohet furnizimi duhet të sigurohet që furnizuesi i njohur i mundshëm/ardhshëm zotëron informacion për standardet e sigurisë së aviacionit dhe t'i japë vlefshmërinë.

2.3 Furnizuesit e njohur të furnizimeve të aeroportit duhet të përcaktohen nga operatori i aeroportit.

Në mënyrë që të përcaktohet si një furnizues i njohur i furnizimeve të aeroportit, operatori i aeroportit duhet të sigurohet që furnizuesi i njohur i mundshëm/ardhshëm zotëron informacionin për standardet e sigurisë së aviacionit dhe pastaj t'i japë vlefshmërinë.

PJESA I

Kriteret për përcaktimin e pjesëve kritike të zonave të kufizuara të sigurisë

Përcaktimi i pjesëve kritike të zonave të kufizuara të sigurisë duhet të sigurojë që atje nuk ka përzierje të pasagjerëve të skanuar në nisje (të nisjes dhe të transitit) dhe bagazhet e tyre të kabinës, si dhe gjithashtu bagazhet e mëdha të skanuara në nisje (të nisjes dhe të transitit).



PJESA J

Rekrutimi i stafit dhe metodat e trajnimit

1. Kriteret për rekrutimin e stafit

Për rekrutimin personave të cilët do të implementojnë, ose do të jenë përgjegjës për implementimin e skanimit, kontrollit të hyrjeve ose kontrole tjera të sigurisë dhe instruktorët, do të zbatohen kriteret e mëposhtme:

a) ata duhet të kenë përfunduar me sukses kontrollin e pastërtisë së figurës ose kontrollin e parapënimin në përputhje me rregullat kombëtare; dhe

b) ata duhet të kenë të gjitha aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë me të cilat janë ngarkuar.

2. Metodatat e trajnimit

Rregullat zbatuese që do të përcaktohen sipas nenit 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar, mund të kërkojnë që:

a) personat që implementojnë, ose janë përgjegjës për implementimin, skanimin, kontrollin e hyrjeve ose kontrole të tjera të sigurisë;

b) instruktorët; dhe

c) personat të cilëve do t’u lëshohen kartë identifikimi hyrje aeroporti ose kartë identifikimi hyrje si ekuipazh;

të marrin trajnim teorik, praktik dhe trajnim në punë (OJT).

PJESA K

Kushtet në të cilat mund të zbatohen procedura specifike të sigurisë ose përjashtime nga kontrolli i sigurisë

Rregullat zbatuese që do të përcaktohen sipas nenit 4(3) të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, “Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, të ndryshuar, mund të lejojnë të zbatohen procedura specifike të sigurisë ose përjashtime nga kontrolli i sigurisë, me kushtin që:

a) procedura dhe përjashtimi janë përcaktuar nga ministri përgjegjës për transportin ajror ose nga Autoriteti i Aviacionit Civil; dhe

b) ka arsye objektive që justifikon procedurën dhe përjashtimin.

UDHËZIM

Nr. 3, datë 13.3.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 7.2.2011, “PËR RREGULLAT E PËRBASHKËTA NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL” NË FUSHËN E AERODROMEVE, MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR DHE SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR”²

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Objekti

1. Ky udhëzim do të zbatohet për:

a) projektimin, prodhimin, mirëmbajtjen, operimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të aeronautikës, si dhe personelit i cili është i përfshirë në projektimin, prodhimin dhe mirëmbajtjen e këtyre produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;

b) personelin dhe organizmat e përfshirë në operimin e avionit;

c) projektimin, mbarëvajtjen dhe operimin e aerodromeve, për personelin dhe organizmat e përfshirë në të, pa asnjë paragjykim për legjislacionin vendas mbi mjedisin dhe përdorimin e tokës, si dhe për ruajtjen e pjesëve rrethuese të aerodromit;

d) projektimin, prodhimin dhe mbarëvajtjen e pajisjeve të aerodromeve, si dhe të personelit dhe të organizmave të përfshirë në të;

²Ky udhëzim përafuron rregulloren nr. 1108/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 21 tetor 2009 që amendon rregulloren 216/2008 në fushën e aerodromeve, menaxhimit të trafikut ajror dhe shërbimeve të lundrimit ajror, dhe shfuqizon direktivën 2006/23/EC”.



e) projektimin, prodhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe të pjesëve përbërëse për menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimeve të lundrimit ajror (ATM/ANS), si dhe për personelin dhe organizmat e përfshira;

f) për ATM/ANS, si dhe personelin dhe organizmat e përfshira.

2. Ky udhëzim nuk do të zbatohet për:

a) produktet, pjesët, pajisjet, personelin dhe organizmat e përcaktuar në paragrafin 1(a) dhe (b) gjatë kryerjes së shërbimeve ushtarake, doganore, policore, kërkim shpëtimit, shkëmbimit të zjarrit, ruajtjes së zonës kufitare bregdetare, apo aktiviteteve të tjera të ngjashme;

b) aeroportet apo pjesë të tjera, si dhe pajisjet, personelin dhe organizmat të referuar në paragrafin 1 (c) dhe (d), të cilët janë të kontrolluar dhe janë në operim nga ushtria;

c) ATM/ANS, duke përfshirë sistemet dhe pjesët përbërëse, personelin dhe organizmat, të referuara në paragrafin 1 (e) dhe (f) që mundësohen apo vihen në dispozicion nga ushtria. Avionët e referuar sipas pikës (a) të këtij paragrafi, do të ndahen, aty ku është e mundur, nga avionët e tjerë.

3. Për aq sa mund të jetë praktike, pajisjet ushtarake të hapura për përdorim publik, referuar paragrafit 2(b) apo shërbimet e mundësuar nga personeli ushtarak për publikun, referuar në paragrafin 2(c), do të ofrojnë një nivel sigurie, së paku po aq efektiv sa parashikohen nga kërkesat thelbësore në shtojcën V(a) dhe V(b)."

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "d" ndryshohet si më poshtë:

"d) "Pjesët dhe pajisjet" nënkuptojnë çdo instrument, pajisje, mekanizëm, pjesë aparature, programe kompjuterike ose pjesë aksesore, duke përfshirë dhe pajisjet e komunikimit, i cili përdoret apo ka për qëllim të përdoret në kontrollin ose në operimin e avionit gjatë fluturimit; duhet të përfshijë pjesët e avionit, motorit, helikën, apo pajisje të tjera të përdorura për të manovruar avionin nga toka."

2. Pas shkronjës d shtohet shkronja "d/1", si më poshtë:

"d/1 "Përbërësit e ATM/ANS" nënkupton çdo përbërës sipas përcaktimeve në përkufizimet shtojca I (26) të udhëzimit të ministrit të Transporteve nr. 5 datë 3.6.2010 "Mbi krijimin e strukturës së Qiellit të Vetëm European (kuadri rregullator)". "

3. Shkronja "h" ndryshohet si më poshtë:

"h) "Operator" nënkupton çdo person fizik apo juridik i cili vepron apo sugjeron të operojë për një apo më shumë avionë, apo në një apo më shumë aerodrome."

4. Pas shkronjës "l", shtohen shkronjat "m", "n", "o", "p", "q", "r" dhe "s" me këtë përmbajtje:

"m) "Aerodrom" nënkupton një zonë të përcaktuar (përfshirë çdo ndërtesë, instalime apo pajisje) mbi tokë ose mbi ujë apo mbi një zonë të caktuar lundruese ose në det të hapur, e cila mund të përdoret pjesërisht ose plotësisht për nisjet, arritjet apo lëvizjet e avionit mbi sipërfaqe;

n) "Pajisje të aerodromit" nënkuptohet çdo pajisje, aparaturë, pajisje plotësuese, program kompjuterik apo aksesor, i cili përdoret apo ka si qëllim të përdoret dhe të kontribuojë gjatë operimit të një avioni në aerodrom;

o) "Vendqëndrim i avionit" nënkupton një zonë të përcaktuar e përdorur për vendosjen e avionit, me qëllim ngjitjen apo zbritjen e pasagjerëve, të postës, ngarkesës, furnizimit me karburant, parkimit apo mirëmbajtjes;

p) "Shërbimet e menaxhimit të vendqëndrimit të avionit" nënkupton çdo shërbim i përdorur për menaxhimin e aktiviteteve dhe lëvizjes së avionit dhe mjeteve mbi vendqëndrim e avionit;

q) "ATM/ANS" nënkupton menaxhimin e shërbimeve të trafikut ajror sipas përcaktimeve të shtojcës I(5) dhe shërbime të lundrimit ajror të përcaktuara në shtojcën I(2) të udhëzimit të ministrit të Transporteve nr. 5, datë 3.6.2010, "Mbi krijimin e strukturës së QVE (kuadri rregullator)", si dhe shërbime të cilat konsistojnë në përpunimin e të dhënave, formatimin dhe shpërndarjen e tyre për trafikun ajror të përgjithshëm me qëllim lundrimin ajror të sigurisë-kritike;

r) "Sistemet ATM/ANS" nënkupton çdo lloj kombinimi të pajisjeve dhe sistemeve të lidhura me sigurinë, të përcaktuara në shtojcën I(41) të udhëzimit të ministrit të Transporteve nr. 5, datë 3.6.2010, "Mbi krijimin e strukturës së QVE (kuadri rregullator)";

s) "Shërbimi i informacionit të fluturimit" nënkupton një shërbim i cili përdoret për qëllim të këshillimit dhe dhënies së informacionit në funksion të kryerjes së fluturimeve të sigurta dhe efikase."

Neni 3

Në nenin 4, pas pikës 3, shtohen paragrafët 3a, 3b dhe 3c me këtë përmbajtje:



“3a. Aerodromet të cilët përfshijnë pajisje, të lokalizuara në territorin e vendit tonë, të hapur për përdorim publik, si dhe që kanë shërbime të transportit ajror tregtar, si dhe operojnë me instrumente afrimi dhe nisjeje, dhe:

a) kanë një pistë të shtruar rreth 800 metra apo më shumë; ose

b) në mënyrë ekskluzive ofrojnë shërbime për helikopterë;

duhet të jenë në përputhje me këtë udhëzim. Personeli dhe organizmat e përfshirë në operimet e këtyre aerodromeve duhet të jenë në përputhje me këtë udhëzim.

3b. Me anë të shmangies nga kushtet e paragrafit 3a, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të vendosë të përjashtojë nga dispozitat e këtij udhëzimi një aerodrom, i cili:

- ka jo më shumë se 10000 pasagjerë në vit;
- ka jo më shumë se 850 lëvizje lidhur me ngarkesat e mallrave në vit.

Nëse një përjashtim i tillë nuk është në përputhje me objektivat e përgjithshëm të sigurisë të përcaktuara në këtë udhëzim apo me ndonjë rregullore apo udhëzim tjetër në fuqi, Komisioni Evropian, duke konsideruar parashikimet e marrëveshjes shumëpalëshe mund të marrë një vendim në përputhje me procedurat e sigurisë që të mos lejojë përjashtimet nga ky rast. Në raste të tilla, do të revokohet përjashtimi.

3c. ATM/ANS të ofruara në hapësirën ajrore të territorit të Republikës së Shqipërisë, ose hapësirë tjetër ku aplikohet udhëzimi i ministrit të Transporteve nr. 7, datë 3.6.2010, “Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda Qiellit të Vetëm Evropian” (Rregullore për hapësirën ajrore), në përputhje me nenin 1(1.2), duhet të jenë në përputhje me këtë udhëzim. Sistemet dhe përbërësit, personeli dhe organizmat të këtyre ATM/ANS duhet të jenë në përputhje me këtë udhëzim.”.

Neni 4

Në nenin 5, shkronjat “b” dhe “c” të paragrafit 2, riformulohen, si më poshtë:

“b) Masat referuar në paragrafin 5 mund të përcaktohen si një kërkesë për certifikim të pjesëve dhe pajisjeve. Certifikimi për pjesët dhe pajisjet jepet atëherë kur aplikuesi ka demonstruar që pjesët dhe pajisjet përputhen me specifikimet e detajuara të vlefshmërisë të fluturimit në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me kërkesat thelbësore referuar në paragrafin 1;

c) Asnjë avion nuk duhet të operojë, për aq kohë sa nuk disponon një certifikatë të vlefshme të gatishmërisë për fluturim. Certifikata mund të jepet atëherë kur aplikuesi ka demonstruar që avioni është në përputhje me tipin e dizajnuar të aprovuar sipas llojit të tij në certifikatë dhe që dokumentacioni relevant, inspektimet dhe testet tregojnë që avioni është në kushte të sigurta operimi. Certifikata e gatishmërisë për fluturim është e vlefshme për aq kohë sa nuk është pezulluar, revokuar apo përfunduar dhe për sa kohë që avioni është në përputhje me kushtet e gatishmërisë së fluturimit, të përcaktuara në pikën 1.d të shtojcës 1 dhe masat e përshtatura në përputhje me paragrafin 5.”.

Neni 5

Në nenin 7, paragrafi 4, riformulohet si më poshtë:

“4. Certifikata do të kërket për çdo pajisje fluturimi trajnuese e cila përdoret për trajnimin e pilotëve. Certifikata do të lëshohet atëherë kur aplikuesi ka demonstruar që pajisja përshtatet me rregullat e përcaktuara, të cilat sigurojnë përputhshmëri, sipas kërkesave thelbësore të përcaktuara në shtojcën III.”.

Neni 6

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi 1 zëvendësohet si më poshtë:

“1. Funksionimi i avionit referuar nenit 4 (1)(b) dhe (c) duhet të përputhet me kërkesat kryesore të përcaktuara në shtojcën IV, dhe nëse është e aplikueshme dhe me shtojcën Vb.”.

2. Shkronjat “a” dhe “g” të paragrafit 5 ndryshohen si më poshtë:

“a) kushtet që një avion të funksionojë në përputhje me kërkesat kryesore përcaktohen në shtojcën IV dhe nëse është e mundur dhe në shtojcën Vb;

g) kur operimet e avionit u referohen pikave (a)(ii) dhe pikave (d) dhe (h) të shtojcës II, në rastet kur përdoren për transport ajror tregtar, përcaktohen në shtojcën IV dhe nëse është e aplikueshme edhe në shtojcën Vb.”.

3. Në paragrafin 6, shtohet përmbajtja e mëposhtme:

“___ të merren në konsideratë aspektet e sigurisë lidhur me ATM/ANS.”

Neni 7

Pas nenit 8 shtohen nenet 8a, 8b dhe 8c, me përmbajtjen si më poshtë:



“Neni 8a
Aerodromet

1. Aerodromet, pajisjet dhe funksionimi i tyre do të respektojnë kriteret bazë të paraqitura në shtojcën Va dhe, nëse është e aplikueshme, shtojcën Vb.

2. Përputhshmëria e aerodromeve, pajisjeve të tyre dhe funksionimit të tyre me kriteret bazë do të vendosen në përputhje me si vijon:

a) Do të kërkohet një certifikatë në lidhje me çdo aerodrom. Certifikata dhe certifikimi i ndryshimeve të asaj certifikate do të lëshohen kur aplikuesi të ketë treguar që aerodromi plotëson bazën e certifikimit të aerodromit të paraqitur në pikën (b), dhe që aerodromi nuk ka asnjë tipar apo karakteristikë që e bën të pasigurt funksionimin e tij. Certifikata do të mbulojë aerodromin, funksionimin e tij dhe pajisjet e tij që kanë të bëjnë me sigurinë;

b) Baza e certifikimit për një aerodrom do të konsistojë si vijon:

i) Specifikimet e aplikueshme të certifikimit të lidhura me llojin e aerodromit;

ii) Dispozitat në bazë të të cilave është pranuar niveli i sigurisë; dhe

iii) Specifikimet teknike të detajuara të nevojshme kur veçoritë e projektimit të një aerodromi të veçantë ose eksperiencën në funksionim bëjnë ndonjë nga specifikimet e përmendura në pikën (i) të papërshtatshme për të siguruar përputhshmëri me kriteret bazë të paraqitura në shtojcën Va;

c) Masat e përmendura në paragrafin 5 që do të propozohen nga Komisioni Evropian, duke konsideruar parashikimet e marrëveshjes shumë-palëshe mund të përcaktojnë një kriter certifikimi në lidhje me pajisjet e aerodromit kritike për sigurinë. Certifikata për pajisje të tilla do të lëshohet kur aplikuesi të ketë treguar se pajisjet përmbushin specifikimet e detajuara të përcaktuara për të siguruar përputhjen me kriteret bazë sipas paragrafit 1;

d) Operatorët përgjegjës për funksionimin e aerodromeve do të demonstrojnë kapacitetet dhe aftësinë e tyre për të përmbushur përgjegjësitë e lidhura me privilegjet e tyre. Këto kapacitete dhe mjete financiare do të njihen nëpërmjet lëshimit të një certifikate të referuar në pikën (a). Ato mund të njihen gjithashtu nëpërmjet lëshimit të një certifikate të veçantë nëse Autoriteti i Aviacionit Civil e vendos një gjë të tillë. Privilegjet e operatorit të certifikuar dhe fusha e certifikatës, duke përfshirë një listë aerodromesh, do të specifikohen në certifikatë;

e) Në rastet kur nuk aplikohet pika (d), Autoriteti i Aviacionit Civil mund të vendosë që ofruesit e shërbimeve të vendqëndrimit të avionit në aerodrom do të lejohen të deklarojnë kapacitetet dhe aftësinë e tyre për të përmbushur përgjegjësitë e lidhura me shërbimet e siguruar.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që dispozitat janë të vendosura për të siguruar aerodromet kundrejt aktiviteteve dhe zhvillimeve në ambientet përreth aerodromit të cilat mund të shkaktojnë situata rreziku të papranueshme për avionët që përdorin atë aerodrom.

4. Operatorët e aerodromit do të monitorojnë aktivitetet dhe zhvillimet që mund të shkaktojnë rreziqe sigurie të papranueshme për aviacionin në rrethinat e aerodromit dhe të marrin, brenda kompetencave të tyre, masat përkatëse.

5. Masat e përcaktuara për të korrigjuar elementet jo thelbësore të kriterëve të referuara në këtë nen, duke e plotësuar atë, do të zbatohen në përputhje me procedurën rregullative.

Këto masa do të specifikojnë në veçanti:

a) kushtet për të përcaktuar dhe njoftuar një aplikues në lidhje me bazën e certifikimit të aplikueshme për një aerodrom;

b) kushtet për të përcaktuar dhe njoftuar një aplikues në lidhje me specifikimet e detajuara të aplikueshme për një aerodrom;

c) kushtet për të lëshuar, mbajtur, korrigjuar, pezulluar apo revokuar certifikatat e aerodromeve dhe certifikatën për pajisjet e aerodromit, duke përfshirë kufizime në operim të lidhura me projektimin specifik të aerodromit;

d) kushtet për operimin e një aerodromi në përputhje me kriteret bazë të paraqitura në shtojcën Va dhe, nëse është e aplikueshme, shtojca Vb;

e) kushtet për të lëshuar, mbajtur, korrigjuar, pezulluar apo revokuar certifikatat siç referohet në paragrafin 2(d);

f) përgjegjësitë e mbajtësve të certifikatave;

g) kushtet për pranimin dhe konvertimin e certifikatave të aerodromit të ZPEA-së sipas parashikimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, duke përfshirë masat që janë tashmë të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në bazë të devijimeve të njoftuara të aneksit 14 të Konventës së Çikagos, mbi “Aerodromet” përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi;

h) kushtet, për marrjen e vendimit për moslejimin e përjashtimeve të referuara në nenin 4(3b), duke përfshirë kriteret për aerodromet e mallrave, njoftimi



për aerodromet e përjashtuar dhe për rishikimin e bërë ndaj këtyre aerodromeve të përjashtuar;

i) kushtet sipas të cilave operimet do të ndalohen, kufizohen ose do t'u nënshtrohen kushteve të tjera në interes të sigurisë;

j) kushtet dhe procedurat për deklaratën dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimit të referuar në paragrafin 2(e).

6. Masat e referuara në paragrafin 5:

a) do të pasqyrojnë praktikën më të mira dhe moderne në fushën e aerodromeve dhe do të marrin parasysh Standardet e ICAO-s të aplikueshme dhe Praktikën e Rekomanduar, të bëra pjesë e legjislacionit tonë.

b) do të jenë në proporcion me përmasat, trafikun, kategorinë dhe kompleksitetin e aerodromit si edhe natyrën dhe volumin e operimeve në të;

c) do të marrin parasysh eksperiencën e funksionimit të aerodromeve në të gjithë botën dhe progresin teknik dhe shkencor;

d) do të lejojnë një reagim të menjëhershëm për të përcaktuar shkaqet e aksidenteve dhe incidenteve serioze;

e) do të parashikojnë fleksibilitetin e nevojshëm për të qenë në përputhje me rregullat sipas rastit.

Neni 8b ATM/ANS

1. Dispozitat e ATM/ANS do të jetë në përputhje me kriteret bazë të paraqitura në shtojcën Vb dhe, sa të jetë e mundur nga ana praktike, me shtojcën Va.

2. Ofruesit e ATM/ANS do t'u kërkohet të kenë një certifikatë. Certifikata do të lëshohet kur ofruesi i shërbimit ka treguar aftësinë dhe kapacitetet për të përmbushur përgjegjësitë e lidhura me privilegjet e ofruesit të shërbimit. Privilegjet e dhëna dhe qëllimi i shërbimeve të ofruara do të specifikohen në certifikatë.

3. Në rastet kur shmanget paragrafi 2, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të vendosë që ofruesit e shërbimeve mbi informacionin e fluturimit të lejohen të deklarojnë aftësitë dhe kapacitetin e tyre për të përmbushur përgjegjësitë e lidhura me ofrimin e shërbimeve.

4. Masat e referuara në paragrafin 6 mund të përcaktojnë një kriter për certifikim në lidhje me organizatat e angazhuara në projektimin, prodhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve ATM/ANS shumë të rëndësishëm për sigurinë dhe pjesët përbërëse të tyre. Certifikata për ato organizata do të lëshohet kur ato të kenë treguar aftësinë dhe kapacitetin e tyre për të

përmbushur përgjegjësitë e lidhura me privilegjet e tyre. Privilegjet e dhëna do të specifikohen në certifikatë.

5. Masat e referuara në paragrafin 6 mund të përcaktojnë një kriter për certifikim, ose në mënyrë alternative, miratimin nga ofruesi i shërbimit të ATM/ANS, në lidhje me sistemet ATM/ANS shumë të rëndësishme për sigurinë dhe pjesët përbërëse të tyre. Certifikata për ato sisteme dhe pjesët përbërëse të tyre do të lëshohet, ose do të jepet miratim, kur aplikuesi të ketë treguar që sistemet dhe përbërësit e tyre të respektojnë specifikimet e detajuara të përcaktuara për të siguruar përmbushjen e kriterëve thelbësorë të referuara në paragrafin 1.

6. Masat e nevojshme për zbatimin e këtij neni do të hartohen në përputhje me procedurën rregullative të Komisionit Europian, duke konsideruar parashikimet e marrëveshjes shumëpalëshe.

Këto masa do të specifikojnë në veçanti:

a) kushtet për sigurimin e ATM/ANS në përputhje me kriteret bazë të paraqitura në shtojcën Vb dhe, nëse është e aplikueshme, në shtojcën Va;

b) kushtet për përcaktimin dhe njoftimin tek një aplikues për specifikimet e detajuara për sistemet ATM/ANS dhe përbërësit e tyre;

c) kushtet për lëshimin, mbajtjen, korrigjimin, pezullimin ose revokimin e certifikatave sipas paragrafëve 2 dhe 4;

d) përgjegjësitë e mbajtësve të certifikatave;

e) kushtet dhe procedurat për deklaratën dhe për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimit sipas paragrafit 3;

f) kushtet sipas të cilave operimet do të ndalohen, kufizohen ose do t'u nënshtrohen disa kushteve në interes të sigurisë.

7. Masat sipas paragrafit 6:

a) do të pasqyrojnë praktikën më të mira dhe moderne në fushën e ATM/ANS;

b) do të jenë në proporcion me llojin dhe kompleksitetin e shërbimeve të ofruara;

c) do të marrin parasysh eksperiencën botërore të ATM/ANS, dhe progresin shkencor dhe teknik;

d) do të zhvillohen duke zbatuar për sa të jetë e mundur dispozitat përkatëse të:

- udhëzimit të ministrit të Transporteve nr. 5, datë 3.6.2010, "Mbi krijimin e strukturës së Qiellit të Vetëm Evropian (Kuadri rregullator)";

- udhëzimit të ministrit të Transporteve nr. 6, datë 3.6.2010 "Mbi dispozitat e Shërbimit të Navigimit Ajror në Qiellin e Vetëm Evropian (Rregullore për dispozitat e shërbimit);



- udhëzimit të ministrit të Transporteve nr. 7, datë 3.6.2010 “Mbi organizimin dhe përdorimin e Hapësirës Ajrore brenda Qiellit të Vetëm Evropian (Rregullore për hapësirën ajrore)”;

- udhëzimit të ministrit të Transporteve nr. 8, datë 3.6.2010 “Për ndërveprimin në Rrjetin Evropian të menaxhimit të Trafikut Ajror (Rregullore për ndërveprimin)”, dhe

të garantojnë mekanizmat kalimtarë për të siguruar vazhdimësinë e certifikatave të dhëna tashmë sipas këtyre udhëzimeve; fillimisht ato do të përfshijnë dispozitat e sigurisë së atyre udhëzimeve dhe, sipas nevojës, në rast të ndryshimeve të ardhshme, do të marrin parasysh progresin e fundit shkencor dhe teknik;

e) do të lejojnë një reagim të menjëhershëm për të përcaktuar shkaqet e aksidenteve dhe incidenteve serioze;

Neni 8c

Kontrollorët e trafikut ajror

1. Kontrollorët e trafikut ajror, si edhe personat dhe organizatat e përfshira në trajnimin, testimin, kontrollin ose vlerësimin mjekësor të kontrollorëve të trafikut ajror, do të përmbushin kriteret përkatëse të përcaktuara në shtojcën Vb.

2. Kontrollorëve të trafikut ajror do t’u kërkohet të kenë një licencë dhe një certifikatë mjekësore të përshtatshme për shërbimin e ofruar.

3. Licenca sipas paragrafit 2 do të lëshohet vetëm kur aplikuesi për licencë tregon se ai ose ajo i përmbush rregullat e vendosura për të siguruar përmbushjen e kriterëve bazë lidhur me njohuritë teorike, aftësitë praktike, aftësinë gjuhësore dhe eksperiencën sipas shtojcës Vb.

4. Certifikata mjekësore sipas paragrafit 2 do të lëshohet vetëm kur kontrollori i trafikut ajror përmbush rregullat e vendosura për të siguruar arritjen e kriterëve bazë mbi gjendjen shëndetësore sipas shtojcës Vb. Certifikata mjekësore mund të lëshohet nga ekzaminuesit mjeko-ajror ose nga qendrat mjeko-ajrore.

5. Privilegjet e kontrollorit të trafikut ajror dhe qëllimi i licencës dhe certifikatës mjekësore do të përcaktohen në këtë licencë dhe certifikatë.

6. Aftësia e organizatave trajnuese të kontrollorit të trafikut ajror, ekzaminuesit mjeko-ajror dhe qendrave mjeko-ajrore për të përmbushur përgjegjësitë e lidhura me privilegjet e tyre për sa i përket lëshimit të licencave dhe certifikatave

mjekësore do të njihet nga lëshimi i një certifikate.

7. Një certifikatë do t’u lëshohet organizatave të trajnimit, ekzaminuesve mjeko-ajror dhe qendrave mjeko-ajrore për kontrollorët e trafikut ajror që kanë treguar se përmbushin rregullat e vendosura për të siguruar respektimin e kriterëve përkatëse bazë sipas shtojcës Vb. Privilegjet e dhëna nga kjo certifikatë do të specifikohen aty.

8. Personat përgjegjës për ofrimin e trajnimit praktik ose për vlerësimin e aftësive të kontrollorëve të trafikut ajror duhet të kenë një certifikatë. Certifikata do të lëshohet kur personi përkatës ka treguar që ai ose ajo i përmbush rregullat e përcaktuara për të siguruar arritjen e kriterëve përkatëse bazë sipas shtojcës Vb. Privilegjet e dhëna nga kjo certifikatë do të specifikohen aty.

9. Pajisjet e trajnimit artificial do të përmbushin kriteret përkatëse bazë sipas shtojcës Vb.

10. Masat e përcaktuara për amendimin e elementeve joesenciale të këtij neni do të specifikojnë në veçanti:

a) kategoritë dhe aprovimet e ndryshme të licencave të kontrollorëve të trafikut ajror;

b) kushtet për lëshimin, mbajtjen, korrigjimin, kufizimin, pezullimin ose revokimin e licencave, kategoritë dhe miratimet e licencave, certifikatat mjekësore, aprovimet dhe certifikatat, kushtet sipas të cilave këto certifikata dhe aprovime nuk duhen kërkuar, gjithashtu do të parashikojnë edhe mekanizmat kalimtarë për të siguruar vazhdueshmërinë e aprovimeve dhe certifikatave të dhëna tashmë;

c) privilegjet dhe përgjegjësitë e mbajtësve të licencave, kategoritë dhe aprovimet e licencave, certifikatat mjekësore, aprovimet dhe certifikatat;

d) kushtet për pranimin dhe konvertim të licencave të kontrollorëve të trafikut ajror, si edhe kushtet për pranimin dhe konvertimin e certifikatave mjekësore kombëtare në certifikata mjekësore përgjithësisht të njohura.

11. Masat sipas paragrafit 10 do të reflektojnë modernizimin, duke përfshirë praktikën më të mira dhe progresin tekniko-shkencor, në fushën e trajnimit të kontrollorit të trafikut ajror. Fillimisht ato do të zhvillohen në bazë të dispozitave të urdhrit të ministrit të Transporteve nr. 117, datë 23.10.2012 “Për miratimin e rregullores mbi Rregullat e Detajuara për Licencat dhe Certifikatat e Kontrollorëve të Trafikut Ajror.”.



Neni 8

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi 1 zëvendësohet si më poshtë:

“1. Mjetet ajrore sipas nenit 4(1)(d), si edhe ekuipazhi dhe operimet e tyre, do të jenë në përputhje me standardet e aplikueshme ICAO. Në rast se nuk ka standarde të tilla, këto mjete ajrore dhe veprimtaria e tyre do të përputhen me kriteret sipas shtojcave I, III, IV dhe, nëse është e aplikueshme, shtojca Vb, me kusht që këto kriteret të mos bien ndesh me të drejtat e shteteve të tjera sipas konventave ndërkombëtare.”.

2. Në paragrafin 5, shtohet shkronja “e” si vijon:

“(e) merren parasysh aspektet e sigurisë lidhur me ATM/ANS.”.

Neni 9

Në nenin 10, paragrafi 1 zëvendësohet si vijon:

“1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të bashkëpunojë me Komisionin Evropian dhe EASA, me qëllim sigurimin e përmbushjes së këtij udhëzimi dhe rregullave të tij të zbatueshme.”.

Neni 10

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafët 4 dhe 5 zëvendësohen si vijon:

“4. Në pritje të hyrjes në fuqi të masave sipas neneve 5(5), 7(6) dhe 9(4) dhe mbarimit të çdo periudhe transitorie të zbatueshme sipas këtyre masave, certifikatat që nuk mund të lëshohen në përputhje me këtë udhëzim mund të lëshohen në bazë të rregulloreve kombëtare të tjera të aplikueshme, në fuqi.

5. Në pritje të hyrjes në fuqi të masave sipas nenit 8(5) dhe mbarimit të çdo periudhe transitorie të zbatueshme sipas këtyre masave, certifikatat që nuk mund të lëshohen në përputhje me këtë rregullore mund të lëshohen në bazë të rregulloreve kombëtare të tjera të aplikueshme në fuqi.”.

2. Pas paragrafit 5, shtohen paragrafët “5a” dhe “5b” si vijon:

“5a. Në pritje të hyrjes në fuqi të masave sipas nenit 8(5), 8c(10) dhe mbarimit të çdo periudhe transitorie të zbatueshme sipas këtyre masave, certifikatat që nuk mund të lëshohen në përputhje me këtë rregullore mund të lëshohen në bazë të rregulloreve kombëtare të tjera të aplikueshme në fuqi;

5b. Në pritje të hyrjes në fuqi të masave sipas nenit 8b(5) dhe mbarimit të çdo periudhe transitorie

të zbatueshme sipas këtyre masave, certifikatat që nuk mund të lëshohen në përputhje me këtë rregullore mund të lëshohen në bazë të rregulloreve kombëtare të aplikueshme ose, aty ku mund të zbatohet, në bazë të kriterëve përkatës të urdhrat të ministrit të Transporteve nr. 115, datë 23.10.2012, “Për miratimin e rregullores mbi kërkesat e përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror”.”.

Neni 11

Në nenin 13, shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon:

“Organet e kualifikuara nuk do të lëshojnë certifikata.”.

Neni 12

Në nenin 18, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c” zëvendësohet me përmbajtjen si vijon:

“c) lëshimi i specifikimeve të certifikimit, mënyrat e pranueshme të përputhshmërisë, si dhe çdo lloj materiali udhëzues për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi.”.

2. Shtohet shkronja “d” me përmbajtjen si vijon:

“d) merr vendimet e duhura për zbatimin e neneve 20, 21, 22, 22a, 22b dhe 23, duke përfshirë dhënien e përjashtimeve për mbajtësit e certifikatave që ajo ka lëshuar, nga kriteret e rëndësishme të përcaktuara nga ky udhëzim dhe rregullat e zbatueshme të tij në rast të rrethanave të paparashikueshme urgjente operationale ose nevojave operationale me një kohëzgjatje të kufizuar, me kusht që niveli i sigurisë të mos preket, që ato të jepen për një periudhë që nuk i kalon dy muaj, që për to të njoftohet Komisioni Evropian dhe të mos ripërtërihen.”.

Neni 13

Në nenin 19, shkronja “a” e paragrafit 2, zëvendësohet me përmbajtjen si vijon:

“a) specifikimet e certifikimit dhe mënyrat e pranueshme të përputhshmërisë; dhe”.

Neni 14

Pas nenit 21, shtohen neni 22a dhe neni 22b me përmbajtje si vijon:

“Neni 22a
ATM/ANS

Lidhur me ATM/ANS sipas nenit 4(3c) EASA:

a) do të zhvillojë, vetë ose nëpërmjet autoriteteve të



aviacionit kombëtar ose organeve të kualifikuara, inspektime dhe auditime të organizatave që certifikon;

b) do të lëshojë dhe do të ripërtërijë certifikata të organizatave të ndodhura jashtë territorit të vendit tonë, për ofrimin e shërbimeve në hapësirën ajrore të territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) do të lëshojë dhe do të ripërtërijë certifikata të organizatave që sigurojnë shërbime mbarë evropiane;

d) do të korrigjojë, do të pezullojë ose revokojë certifikatën përkatëse, kur kushtet sipas të cilave ishte lëshuar nuk plotësohen më ose nëse mbajtësi i certifikatës nuk përmbush detyrimet në përputhje me këtë udhëzim ose me rregullat e tij të zbatueshme.

Neni 22 b

Certifikimi i kontrollorit të trafikut ajror

Në lidhje me personat ose organizatat sipas nenit 8c(1), EASA:

a) do të zhvillojë, vetë ose nëpërmjet autoriteteve kombëtare të aviacionit apo organeve të kualifikuara, hetime dhe auditime të organizatave që ajo certifikon dhe, sipas rastit, personelit të tyre;

b) do të lëshojë ose do të ripërtërijë certifikatat e organizatave trajnuese të kontrollorit të trafikut ajror të ndodhura jashtë territorit të vendeve anëtare dhe, sipas rastit, personelit të tyre;

c) do të korrigjojë, do të pezullojë ose do të revokojë certifikatën përkatëse kur kushtet sipas të cilave ishte lëshuar nuk përmbushen më, ose nëse personi fizik ose juridik që mban certifikatën nuk përmbush detyrimet sipas këtij udhëzimi ose rregullave të tij të zbatueshme.”

Neni 15

Në shtojcën V, titulli ndryshohet si më poshtë:

“Kriteret për organe të kualifikuara sipas nenit 13 (“organ i kualifikuar” ose “organ”).”

Neni 16

Pas shtojcës V, shtohen “Shtojca Va” dhe “Shtojca Vb”, bashkëlidhur, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Neni 17

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij udhëzimi dhe hartimin e procedurave teknike, me qëllim përshtatjen e masave sipas parashikimeve vetë nenit 7 (nenet 8a, 8b dhe 8c) të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

SHTOJCA VA KRITERET BAZË PËR AERODROMET

A. Karakteristikat fizike, infrastruktura dhe pajisjet

1. Zona e lëvizjes

a) Aerodromet do të kenë një zonë të caktuar për uljen dhe ngritjen e mjeteve fluturuese, që plotëson kushtet vijuese:

i) Zona e uljes dhe e ngritjes do të ketë përmasa dhe karakteristika të përshtatshme për avionin që ka për qëllim ta përdorë atë.

ii) Zona e uljes dhe e ngritjes, ku është e zbatueshme, do të ketë një forcë mbajtëse të mjaftueshme për të lejuar operacionet e përsëritura për mjetin ajror të parashikuar. Ato zona që nuk janë parashikuar për operacione të përsëritura nevojitet të jenë të afta vetëm për të mbajtur mjetin ajror.

iii) Zonat e uljes dhe e ngritjes do të projektohen që uji të kullojë dhe të parandalojnë qëndrimin e ujit, i cili përbën një rrezik të papranueshëm për operacionet e mjeteve fluturuese.

iv) Pjerrësia dhe ndryshimet e pjerrësisë të zonës së uljes dhe ngritjes nuk do të duhet të krijojnë një rrezik që është i papranueshëm për veprimet e mjeteve fluturuese.

v) Karakteristikat e sipërfaqes së zonës së uljes dhe ngritjes do të jenë të përshtatshme për t'u përdorur nga mjeti ajror i përcaktuar; dhe

vi) Zona e uljes dhe e ngritjes duhet të jetë e lirë nga objekte që mund të krijojnë një rrezik të papranueshëm për veprimet e mjeteve fluturuese.

b) Aty ku ka disa zona të përcaktuara për ulje - ngritje, ato do të jenë të tilla që nuk do të krijojnë një rrezik të papranueshëm për veprimet e mjeteve fluturuese.

c) Zona e projektuar e ulje - ngritjes do të rrethohet nga zona të përcaktuara. Këto zona kanë për qëllim të mbrojnë fluturimin e mjeteve fluturuese mbi to gjatë operacioneve të ngritjes apo uljes ose për të zbutur pasojat e uljes së parakohshme, devijimin anash ose kapërcimit të zonës së ngritjes dhe të uljes, dhe do të plotësojnë kushtet vijuese:

i) këto zona do të kenë përmasa të përshtatshme për veprime të parashikuara të mjeteve fluturuese;



ii) pjerrësia dhe ndryshimet e pjerrësisë së këtyre zonave nuk duhet të krijojnë një rrezik të papranueshëm për veprimet e mjeteve fluturuese;

iii) këto zona duhet të jenë të lira nga objekte që mund të krijojnë një rrezik të papranueshëm për veprimet e mjeteve fluturuese. Kjo nuk duhet të parandalojë vendosjen e pajisjeve delikate në ato zona, nëse kërkohen për të ndihmuar veprimet e mjeteve fluturuese; dhe

iv) secila nga këto zona do të ketë një forcë mbajtëse të mjaftueshme për t'i shërbyer qëllimit të saj.

d) Ato zona të një aerodromi, me ambientet rrethuese menjëherë ngjitur me to, që përdoren për vendqëndrim taksish ose parkim të mjeteve fluturuese, do të projektohen të lejojnë veprime të sigurta të mjetit fluturues që pritet të përdorë ambientin e veçantë sipas të gjitha kushteve të planifikuara dhe do të plotësojnë kushtet vijuese:

i) këto zona do të kenë forcën mbajtëse të mjaftueshme për të rezistuar ndaj veprimeve përsëritëse të mjetit fluturues të përcaktuar, përveç zonave që janë të caktuara vetëm për përdorim rastësor të cilat vetëm nevojiten të jenë të afta për mbështetjen e mjetit fluturues;

ii) këto zona do të projektohen për kullimin e ujit dhe për të parandaluar qëndrimin e ujit në to, që do të ishte një rrezik i papranueshëm për veprimet e mjeteve fluturuese;

iii) pjerrësia dhe ndryshimet e pjerrësisë së këtyre zonave nuk duhet të krijojnë një rrezik të papranueshëm për veprimet e mjeteve fluturuese;

iv) karakteristikat e sipërfaqes së këtyre zonave do të jenë të përshtatshme për t'u përdorur nga mjeti fluturues i përcaktuar; dhe

v) këto zona duhet të jenë të lira nga objekte që mund të krijojnë një rrezik të papranueshëm për mjetet fluturuese. Kjo nuk duhet të parandalojë vendosjen e pajisjeve të parkimit të kërkuar për atë zonë për vende apo pozicione të përcaktuara.

e) Infrastrukturë tjetër me qëllim përdorimin e mjetit fluturues do të përcaktohet që përdorimi i asaj infrastrukture të mos krijojë rreziqe të papranueshme në përdorimin e mjetit fluturues.

f) Ndërtimet, ndërtesat, pajisjet, zonat e ruajtjes do të projektohen dhe vendosen në mënyrë që mos të krijojnë një rrezik të papranueshëm për operacionet e mjeteve fluturuese.

g) Do të sigurohen mjete të përshtatshme për të parandaluar hyrjen e personave të paautorizuar,

automjeteve të paautorizuara apo kafshëve me madhësi të mjaftueshme për të krijuar një rrezik të papranueshëm për operacionet e mjeteve fluturuese, në zonën e lëvizjes, duke respektuar dispozitat kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së kafshëve.

2. Heqja e pengesave

a) Për të mbrojtur procedimin e mjetit fluturues në një aerodrom për ulje, ose për nisjen e tij nga një aerodrom, do të përcaktohen zona dhe rrugë mbërritje dhe nisje. Këto rrugë dhe zona do t'i sigurojnë mjetit fluturues mospasjen e pengesave të ndodhura në zonën rrethuese të aerodromit duke marrë parasysh karakteristikat fizike lokale.

b) Kjo heqje pengesash do të jetë e përshtatshme me fazën e fluturimit dhe llojin e veprimeve të kryera. Ajo do të marrë, gjithashtu, parasysh pajisjet që përdoren për përcaktimin e pozicionit të mjetit fluturues.

3. Mjete ndihmëse pamore dhe jopamore dhe pajisjet e aerodromit

a) Mjetet ndihmëse do të jenë të përshtatshme për qëllimin, të njohshme dhe të sigurojnë informacion të qartë për përdoruesit sipas të gjitha kushteve operacionale të përcaktuara.

b) Pajisjet e aerodromit do të funksionojnë siç parashikohet nga kushtet operacionale të sipër-përmendura. Sipas kushteve operacionale apo në rast dështimi, pajisjet e aerodromit nuk do të shkaktojnë një rrezik të papranueshëm për sigurinë e aviacionit.

c) Mjetet ndihmëse dhe sistemi i furnizimit të tyre me energji elektrike do të projektohen në mënyrë të tillë që dështimet të mos rezultojnë në informacion të papërshtatshëm, të rremë apo të pamjaftueshëm për përdoruesit apo në ndërprerjen e një shërbimi thelbësor.

d) Do të sigurohen mjete mbrojtëse të përshtatshme për të shmangur dëmtimin apo shqetësimin e këtyre mjeteve.

e) Burime rrezatimi apo prania e objekteve lëvizëse apo të fiksuara nuk do të ndërhyjnë apo të kenë një efekt të kundërt me performancën e komunikimeve aeronautike, pilotimin dhe sistemeve të mbikëqyrjes.

f) Informacioni mbi funksionin dhe përdorimin e pajisjeve të aerodromit do të vihet në dispozicion të stafit përkatës, duke përfshirë udhëzime të qarta për kushtet që mund të krijojnë rreziqe të papranueshme për sigurinë e aviacionit.

4. Të dhënat e aerodromit



a) Do të mbahen dhe do të përditësohen të dhënat lidhur me aerodromin dhe shërbimet e dispo-nueshme.

b) Të dhënat do të jenë të sakta, të kuptueshme, të plota dhe të qarta. Do të mbahen nivele të përshtatshme integriteti.

c) Të dhënat do të jenë të disponueshme për përdoruesit dhe ofruesit përkatës së ASN në kohën e duhur, duke përdorur një metodë komunikimi të sigurt dhe të shpejtë në mënyrë të mjaftueshme.

B. Funksionimi dhe administrimi

1. Operatori i aerodromit është përgjegjës për funksionimin e aerodromit. Përgjegjësitë e operatorit të aerodromit janë si vijon:

a) Operatori i aerodromit do të ketë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me kontratë, të gjitha mjetet e nevojshme për të siguruar sigurinë e operacioneve të mjetit fluturues në aerodrom. Këto mjete do të përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në ambientet, personelin, pajisjet dhe materialet, dokumentet e detyrave, përgjegjësitë dhe procedurat, akses në të dhënat përkatëse dhe ruajtje e dokumentacionit.

b) Operatori i aerodromit do të verifikojë që kriteret e seksionit A do të përmbushen gjithnjë ose do të marrë masat e përshtatshme për të zbutur rreziqet e lidhur me mos përmbushjen. Do të përcaktohen dhe do të zbatohen procedura për të vënë në dijeni të gjithë përdoruesit për këto masa në kohën e duhur.

c) Operatori i aerodromit do të përcaktojë dhe zbatojë një program të përshtatshëm lidhur me administrimin e rrezikut të aerodromit nga kafshët e egra.

d) Operatori i aerodromit do të sigurojë që lëvizjet e mjeteve dhe personave në zonën e lëvizjes dhe zona të tjera operacionale të koordinohen me lëvizjet e mjeteve ajrore, në mënyrë që të shmangen përplasjet apo dëmtimet e mjeteve ajrore.

e) Operatori i aerodromit do të sigurohet që të krijohen dhe të zbatohen procedura për të zbutur riskun lidhur me operacionet e aerodromit në funksionim gjatë dimrit, në kushte të këqija të motit, kur ka pamje të reduktuar ose gjatë natës, nëse është e zbatueshme.

f) Operatori i aerodromit do të marrë masa me organizata të tjera përkatëse për të siguruar vazhdimësinë e përmbushjes së këtyre kriterëve bazë për aerodromet. Këto organizata përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në operatorët e mjeteve fluturuese, ofruesit e shërbimit të pilotimit në ajër, ofruesit e shërbimit në tokë dhe organizata të tjera, aktivitetet ose produktet e të cilave mund të ndikojnë në sigurinë e mjeteve fluturuese.

g) Operatori i aerodromit, ose vetë ose me anë të kontratave me palë të treta, do të sigurohet që ekzistojnë procedura për të furnizuar mjetin ajror me karburant që është i pakontaminuar dhe sipas kushteve korrekte teknike.

h) Manualet për mirëmbajtjen e pajisjeve të aerodromit do të jenë të disponueshme, do të zbatohen në praktikë dhe do të mbulojnë udhëzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit, informacionin mbi riparimet, identifikimin e problemeve dhe procedurat e inspektimit.

i) Operatori i aerodromit do të krijojë dhe zbatojë një plan emergjence të aerodromit, që mbulon skenarët e emergjencës që mund të ndodhin në aerodrom ose në rrethinat e tij. Ky plan do të jetë i koordinuar në mënyrën e duhur me një plan emergjence për komunitetin lokal.

j) Operatori i aerodromit do të sigurohet që në aerodrom të ketë shërbime të përshtatshme për shpëtim dhe zjarrfikës. Këto shërbime do t'i përgjigjen një incidenti apo aksidenti me urgjencën e duhur dhe do të përfshijnë ta paktën pajisjet, agentët shuarës dhe një numër të mjaftueshëm personel.

k) Operatori i aerodromit do të përdorë vetëm personel të trajnuar dhe të kualifikuar për operacionet e aerodromit dhe mirëmbajtjen dhe do të zbatojë trajnime dhe programe kontrolli për të siguruar kompetencën e të gjithë personelit përkatës.

l) Operatori i aerodromit do të sigurohet që çdo person që lejohet të hyjë pa shoqërim në zonën e lëvizjes ose zona të tjera operacionale të trajnohet dhe të kualifikohet siç duhet për këtë akses;

m) Personeli i shpëtimit dhe zjarrfikës do të trajnohet dhe kualifikohet për të vepruar në ambientin e aerodromit. Operatori i aerodromit do të zbatojë trajnime dhe programe kontrolli për të siguruar vazhdimësinë e kompetencës së të gjithë personelit përkatës; dhe

n) I gjithë personeli i shpëtimit dhe zjarrfikës që mund të kërkohet të jetë aktiv në emergjencë të aviacionit do të tregojnë në mënyrë periodike gjendjen e tyre shëndetësore të aftë për të ekzekutuar në mënyrë të kënaqshme funksionet e tyre, duke marrë parasysh llojin e aktivitetit të tyre. Në këtë kontekst, gjendja shëndetësore, duke përfshirë atë fizike dhe mendore, do të thotë të mos vuajë nga asnjë sëmundje apo paaftësi që mund ta bënte këtë personel të paaftë;

i) për të ekzekutuar detyrat e tij të nevojshme për të operuar në emergjencat e aviacionit;



ii) për të kryer detyrat e tyre të caktuara në çfarëdolloj kohe; ose

iii) të perceptojnë ambientin e tyre në mënyrë korrekte.

2. Sistemet e administrimit

a) Operatori i aerodromit do të zbatojë dhe mirëmbajë një sistem administrimi për të siguruar përmbushjen e kriterëve bazë të aerodromeve dhe të ketë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm dhe proaktiv të sigurisë. Sistemi i administrimit duhet të përfshijë struktura organizuese, detyrime, përgjegjësi, politika dhe procedura.

b) Sistemi i administrimit do të përfshijë një program parandalimi të aksidenteve dhe të incidenteve, duke përfshirë një skemë analize dhe raportimi të rasteve. Analiza do të përfshijë palët e listuara në pikën 1(f) më sipër.

c) Operatori i aerodromit do të krijojë një manual aerodromi dhe do të veprojë në përputhje me atë manual. Do të përmbajë të gjitha udhëzimet e nevojshme, informacionin dhe procedurat për aerodromin, sistemin e administrimit dhe për kryerjen e detyrave për personelin operativ.

C. Rrethinat e aerodromit

1. Hapësira ajrore përreth zonave të lëvizjes së aerodromit do të jetë e ruajtur prej pengesave, në mënyrë që të lejohen veprimet e paracaktuara të mjeteve fluturuese në aerodrome pa krijuar një rrezik të papranueshëm të shkaktuar nga zhvillimi i pengesave rreth aerodromit. Në këtë mënyrë, sipërfaqet monitoruese të pengesave do të zhvillohen, zbatohen dhe monitorohen vazhdimisht për të identifikuar penetrimet e palejuara.

a) Çdo shkelje e këtyre sipërfaqeve do të kërkojë një vlerësim për të identifikuar, nëse objekti krijon apo jo një rrezik të papranueshëm. Çdo objekt që paraqet një rrezik të papranueshëm do të hiqet ose do të merret një veprim i përshtatshëm zbutës për mbrojtjen e mjeteve fluturuese që përdorin aerodromin.

b) Çdo pengesë e mbetur do të publikohet dhe, në varësi të nevojës, do të shënohet dhe, aty ku është e nevojshme, do të bëhet e dukshme me anë të dritave.

2. Rreziqe lidhur me aktivitetet njerëzore dhe përdorimin e tokës, të tilla si, por jo vetëm, objektet e listës në vijim do të monitorohen. Rreziku i shkaktuar prej tyre do të vlerësohet dhe do të zbutet në mënyrën e duhur:

a) çdo zhvillim apo ndryshim në përdorimin e tokës në zonën e aerodromit;

b) mundësia e turbulencës së shkaktuar nga pengesat;

c) përdorimi i dritave të rrezikshme, hutuese dhe mashtruese;

d) verbimi i shkaktuar nga sipërfaqe të mëdha shumë pasqyruese;

e) krijimi i zonave që mund të inkurajojnë jetën e kafshëve të egra në rrethinat e zonës së lëvizjes në aerodrom;

f) burime të rrezatimit të padukshëm ose prania e objekteve lëvizëse apo të fiksuara që mund të ndërhyjnë ose të kenë një efekt të kundërt në performancën e komunikimeve ajrore, pilotimit dhe sistemeve të mbikëqyrjes.

3. Do të hartohet një plan emergjence për komunitetin lokal për situata të emergjencës së aviacionit që mund të ndodhin në zonën lokale të aerodromit.

D. Të tjera

Përveç situatave të emergjencës së mjeteve të fluturimit, kur kemi shmangie për në një aerodrom alternativ, ose sipas kushteve të tjera të specifikuara në çdo rast, një aerodrom apo pjesë të tij nuk do të përdoret nga mjetet ajrore të paparashikuara nga projekti dhe procedurat operative të aerodromit.

SHTOJCA VB

KRITERE BAZË PËR ATM/ANS DHE KONTROLLORET E TRAFIKUT AJROR

1. Përdorimi i hapësirës ajrore

a) Të gjithë avionët, duke përjashtuar ata të angazhuar në aktivitetet e përmendura në nenin 1(2)(a), në të gjitha fazat e fluturimit ose në zonën e lëvizjes së aerodromit, do të funksionojnë në përputhje me rregullat e përgjithshme operationale dhe çdo procedure të aplikuar të specifikuar për përdorim të asaj hapësire ajrore.

b) Të gjithë avionët, duke përjashtuar ata të angazhuar në aktivitetet e përmendura në nenin 1(2)(a), do të pajisen me përbërësit e nevojshëm dhe do të funksionojnë në mënyrën e duhur. Përbërësit e përdorur në sistemin ATM/ANS do të përmbushin, gjithashtu, kriteret në pikën 3.

2. Shërbimet

a) Informacioni aeronautik dhe të dhënat për përdoruesit e hapësirës ajrore për qëllimet e lundrimit ajror:

i) të dhënat e përdorura si burim për informacion aeronautik do të jenë të një cilësie të mjaftueshme, të plota, aktuale dhe të siguruara në kohën e duhur;



ii) informacioni aeronautik do të jetë i saktë, i plotë, aktual, i qartë dhe të ketë integritetin e duhur në një format të përshtatshëm për të gjithë përdoruesit;

iii) shpërndarja e këtij informacioni aeronautik për përdoruesit e hapësirës ajrore do të bëhet në kohën e duhur dhe do të përdorë mjete komunikimi të besueshme dhe të shpejta të mbrojtura nga interferenca dhe dëmtimi.

b) Informacion meteorologjik

i) Të dhënat e përdorura si burim për informacion aeronautik meteorologjik do të jenë aktuale të plota dhe me cilësi të mjaftueshme.

ii) Për aq sa është e mundur, informacioni aeronautik meteorologjik do të jetë i saktë, i plotë, aktual, të jetë i qartë dhe me integritetin e përshtatshëm, në mënyrë që të plotësojë nevojat e përdoruesve të hapësirës ajrore.

iii) Shpërndarja e këtij informacioni aeronautik meteorologjik për përdoruesit e hapësirës ajrore do të bëhet në kohën e duhur dhe të përdorë mjete komunikimi të besueshme dhe të shpejta të mbrojtura nga interferenca dhe dëmtimi.

c) Shërbimet e trafikut ajror:

i) Të dhënat e përdorura si burim për sigurimin e shërbimeve të trafikut ajror do të jenë të sakta, të plota dhe aktuale.

ii) Shërbimet e trafikut ajror do të jenë në mënyrë të mjaftueshme të sakta, të plota, aktuale dhe të qarta për të përmbushur nevojat e sigurisë së përdoruesve.

iii) Mjete të automatizuara për sigurimin e informacionit apo këshillimit të përdoruesve do të projektohen, prodhohen dhe mirëmbahen për të siguruar që ato janë në gjendjen e duhur për qëllimin e caktuar.

iv) Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror dhe proceset përkatëse do të sigurojnë një ndarje të përshtatshme midis mjeteve ajrore dhe, në rast se nevojitet, do të asistojnë për mbrojtjen nga pengesat dhe rreziqe të tjera nga ajri dhe do të sigurojnë një koordinim në kohën e duhur me të gjithë përdoruesit përkatës dhe në hapësirat e afërta ajrore.

v) Komunikimi midis shërbimeve të trafikut ajror dhe avionëve dhe midis njësive përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror do të bëhen në kohën e duhur dhe do të jetë i qartë, i saktë, i mbrojtur nga interferenca dhe do të jetë i kuptueshëm nga të gjithë, si edhe, nëse është e mundur, do të pranohet nga të gjithë aktorët e përfshirë.

vi) Mjetet do të jenë në vendin e duhur për të dalluar emergjencat të mundshme dhe, kur nevojitet, të nisin një veprim të efektshëm kërkim shpëtimi. Këto mjete, minimalisht, do të përfshijnë mekanizmat e lajmërimit, procedurat dhe masat koordinuese, pajisje dhe personel për mbulimin e zonës së përgjegjësisë me më shumë efikasitet.

d) Shërbimet e komunikimit

Shërbimet e komunikimit do të arrijnë dhe do të ruajnë një performancë të mjaftueshme lidhur me disponueshmërinë, integritetin, vazhdueshmërinë dhe kohën e duhur. Ato do të jenë të shpejta dhe të mbrojtura nga dëmtimi.

e) Shërbimi i pilotimit

Shërbimet e pilotimit do të arrijnë dhe do të ruajnë një nivel të mjaftueshëm lidhur me udhëzimet, pozicionimin dhe, kur ofrohet, informacionin në kohën e duhur. Kriteret e performancës përfshijnë saktësinë, integritetin, disponueshmërinë dhe vazhdueshmërinë e shërbimit.

f) Shërbimi i mbikëqyrjes

Shërbimet e mbikëqyrjes do të përcaktojnë pozicionin përkatës të avionit në ajër dhe të mjeteve të tjera ajrore apo automjeteve në tokë në sipërfaqen e aerodromit, me një performancë të mjaftueshme lidhur me saktësinë, integritetin, vazhdueshmërinë dhe mundësinë e tyre të dallimit.

g) Menaxhimi i fluksit të trafikut

Administrimi taktik i menaxhimit të fluksit të trafikut ajror do të përdorë dhe do të sigurojë informacion në mënyrë të mjaftueshme të saktë dhe aktual të volumit dhe natyrës së trafikut ajror të planifikuar që influencon në ofrimin e shërbimit dhe do të koordinojë dhe negociojë ridrejtimin ose vonesën e fluksit të trafikut me qëllim reduktimin e rrezikut të situatave të mbingarkuara në ajër apo në aerodrome.

h) Menaxhimi i hapësirës ajrore

Përcaktimi i volumeve specifike të hapësirës ajrore për një përdorim të veçantë do të monitorohet, koordinohet dhe lajmërohet në kohën e duhur me qëllim reduktimin e rrezikut të humbjes së distancës midis mjeteve ajrore në të gjitha rrethanat.

i) Projektimi i hapësirës ajrore

Strukturat e hapësirës ajrore dhe procedurat e fluturimit do të projektohen në mënyrën e duhur, mbikëqyren dhe vlerësohen përpara se të përdoren dhe zhvillohen nga mjeti ajror.

3. Sistemet dhe përbërësit e tyre

a) E përgjithshme

Sistemet ATM/ANS dhe përbërësit që sigurojnë



informacionin përkatës për dhe nga avioni dhe në tokë do të projektohen në mënyrën e duhur, do të prodhohen, instalohen, mirëmbahen dhe do të vihen në funksionim për të siguruar që ata janë në gjendje të kryejnë qëllimin e parashikuar.

b) Besueshmëria, performanca dhe integriteti i sistemit dhe përbërësit

Performanca e sistemeve dhe përbërësve të tyre lidhur me integritetin dhe sigurinë në mjetin ajror, në tokë apo në hapësirë, do të tregojë gatishmërinë e tyre për qëllimin e paracaktuar. Ata duhet të përmbushin nivelin e kërkuar të performancës operationale për të gjitha kushtet e parashikueshme operationale dhe për të gjithë jetën e tyre funksionale.

c) Projektimi i sistemeve dhe i përbërësve:

i) Sistemet dhe përbërësit do të projektohen për të përmbushur kriteret e aplikueshme të sigurisë.

ii) Sistemet dhe përbërësit, të konsideruar së bashku, veçmas dhe në lidhje me njëri-tjetrin, do të projektohen në një mënyrë të tillë që të ekzistojë një marrëdhënie e anasjellë midis mundësisë së ndodhjes së çfarëdolloj defekti mund të rezultojë në një avari totale të sistemit dhe të ketë pasoja të rënda në shërbimet e sigurisë.

iii) Sistemet dhe përbërësit, të konsideruara individualisht dhe në kombinim me njëra-tjetrën, do të projektohen duke marrë parasysh kufizimet e lidhura me performancën dhe kapacitetet njerëzore.

iv) Sistemet dhe përbërësit do të projektohen në një mënyrë që ato të mbrohen nga ndërveprimet e paparashikuara e të dëmshme të elementeve të jashtme.

v) Informacioni i nevojshëm për prodhimin, instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe përbërësve, si edhe informacioni i lidhur me kushtet e pasigurta do t'i sigurohet personelit në një mënyrë të qartë, të vazhdueshme e të padyshimtë.

c) Vazhdimësia e nivelit të shërbimit

Nivelet e sigurisë së sistemeve dhe përbërësve do të ruhen gjatë shërbimit dhe çfarëdo modifikimi të shërbimit.

4. Kualifikimi i kontrollorëve të trafikut ajror

a) Të përgjithshme

Një person që kryen një trajnim si kontrollor i trafikut ajror ose si një student kontrollor i trafikut ajror, duhet të jetë në mënyrë të mjaftueshme i pjekur nga ana arsimore, fizike dhe mendore për të fituar, ruajtur dhe demonstruar njohuritë përkatëse teorike dhe aftësitë praktike.

b) Njohuritë teorike:

i) Një kontrollor i trafikut ajror do të fitojë dhe ruajë një nivel njohurie të përshtatshme me funksionet e

ushtruara dhe në proporcion me rreziqet e lidhura me këtë lloj shërbimi.

ii) Fitimi dhe ruajtja e njohurive teorike do të tregohet nga vlerësimi i vazhdueshëm gjatë trajnimit, ose nga testimet e duhura.

iii) Do të ruhet një nivel i përshtatshëm i njohurive teorike. Përmbushja e kushteve do të tregohet nga testime dhe vlerësime të rregullta. Shpeshësia e testimeve do të jetë në proporcion me nivelin e rrezikut të lidhur me këtë lloj shërbimi.

c) Aftësitë praktike

i) Një kontrollor i trafikut ajror do të fitojë dhe do të ruajë aftësitë praktike të përshtatshme për të ushtruar funksionet e tij/saj. Këto aftësi do të jenë në proporcion me llojet e shërbimit dhe do të mbulojnë të paktën, nëse përshtaten me funksionet e ushtruara, objektet si vijon:

ii) procedurat operationale;

iii) aspektet specifike të detyrave;

iv) situatat jonormale dhe të emergjencave; dhe

v) faktorët njerëzorë.

vi) Një kontrollor i trafikut ajror do të tregojë aftësinë për të kryer procedurat përkatëse dhe detyrat me një nivel kompetence në përputhje me funksionet e ushtruara.

vii) Do të ruhet një nivel i kënaqshëm i kompetencës në aftësitë praktike. Përmbushja e kushteve do të verifikohet nga vlerësimet e rregullta. Shpeshësia e këtyre vlerësimeve do të jetë në proporcion me kompleksitetin dhe nivelin e rrezikut në lidhje me këtë lloj shërbimi dhe detyrave të kryera.

d) Aftësia gjuhësore

i) Një kontrollor i trafikut ajror do të tregojë aftësinë të flasë dhe të kuptojë anglisht në masën në të cilën ai/ajo është i aftë të komunikojë në mënyrë të efektshme vetëm me zë (telefon/ telefon-radio) dhe në situatat konkrete mbi tema të përditshme të lidhura me punën, duke përfshirë situatat e emergjencës;

ii) Kurdoherë që është e nevojshme në një volum të përcaktuar të hapësirës ajrore për qëllime të sigurimit të shërbimit ATS, një kontrollor i trafikut ajror do të ketë, gjithashtu, aftësinë të flasë dhe të kuptojë gjuhën(-t) kombëtare në masën e përshkruar më sipër.

e) Pajisjet e trajnimeve artificiale (STD)

Kur një STD përdoret për trajnimin praktik për ndërgjegjësimin e situatave dhe faktorët njerëzorë ose për të demonstruar që aftësitë janë fituar ose ruajtur, duhet të ketë një nivel performance që lejon simulimin e përshtatshëm të ambientit të punës dhe



situatave operacionale të përshtatshme me trajnimin e siguruar.

f) Kursi i trajnimit

i) Trajnimi do të jepet nga një kurs trajnimi, që mund të përfshijë instruksione teorike dhe praktike, duke përfshirë trajnim në një STD, nëse është e zbatueshme.

ii) Do të përcaktohet dhe do të aprovet një kurs për çdo lloj trajnimi.

g) Instruktorët:

i) Mësimet teorike do të jepen në mënyrën e duhur nga instruktorë të kualifikuar. Ata:

i. do të kenë njohuritë e duhura në fushën ku duhet dhënë mësim; dhe

ii. do të kenë treguar aftësinë për të përdorur teknikat e duhura mësimore.

ii) Mësimi i aftësive praktike do të jepet nga instruktorë të kualifikuar, që kanë kualifikimet si vijon:

i. të përmbushin njohuritë teorike dhe kriteret e eksperiencës në lidhje me mësimin që jepet;

ii. të kenë treguar aftësinë për të mësuar dhe për të përdorur në mënyrën e duhur teknikat mësimore;

iii. të kenë praktikuar teknikat mësimore në ato procedura në të cilat parashikohet të jepet mësim; dhe

iv. të marrin trajnim të rregullt rifreskues për të siguruar ruajtjen e kompetencave mësimore.

iii) instruktorët e aftësive praktike do të jenë ose të kenë qenë autorizuar të veprojnë si kontrollorë të trafikut ajror.

h) Vlerësuesit

i) Personat përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kontrollorëve të trafikut ajror:

i. do të kenë treguar aftësinë për të vlerësuar performancën dhe të kenë zhvilluar teste apo kontrole mbi kontrollorët e trafikut ajror; dhe

ii. do të marrin trajnim të rregullt rifreskues për të siguruar që standardet e vlerësimit të jenë të përditësuara.

ii) vlerësuesit e aftësive praktike do të jenë ose të kenë qenë autorizuar të veprojnë si kontrollorë të trafikut ajror në ato fusha në të cilat bëhet vlerësimi.

i) Gjendja fizike mjekësore e një kontrollori të trafikut ajror

(i) Kriteret mjekësore

i. Të gjithë kontrollorët e trafikut ajror do të tregojnë në mënyrë periodike gjendje shëndetësore fizike për të kryer në mënyrë të kënaqshme funksionet e tyre. Përmbushja e kushteve do të tregohet nga vlerësimi i duhur duke marrë parasysh degradimin e mundshëm

mendor dhe fizik për shkak të moshës;

ii. Demonstrimi i gjendjes shëndetësore, që përfshin gjendjen fizike dhe mendore, do të përfshijë mungesën e demonstruar të çfarëdolloj sëmundjeje apo paaftësie, gjë që e bën të paftë personin që siguron një shërbim të kontrollit të trafikut ajror (KTA):

- për të ekzekutuar siç duhet detyrat e nevojshme për të siguruar një shërbim KTA;

- për të kryer detyrat e caktuara në çfarëdolloj kohe; ose

- për të perceptojë në mënyrën e duhur ambientin e tij/të saj.

(ii) aty ku gjendja shëndetësore nuk mund të tregohet plotësisht, masa zbutëse që garanton sigurinë ekuivalente mund të zbatohet.

5. Ofruesit e shërbimeve dhe organizatat e trajnimit

a) Ofrimi i shërbimit nuk do të ndërmerret në rast mosplotësimi të kushteve vijuese:

i) Ofruesi i shërbimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet kontratave do të ketë mjetet e nevojshme për shkallën dhe fushën e shërbimit. Këto mjete do të përfshijnë, por jo vetëm: sistemet, ambientet, furnizimin me elektricitet, strukturën e administrimit, personelin, pajisjet dhe mirëmbajtjen e tyre, dokumentimin e detyrave, përgjegjësi, procedurave, aksesin në të dhënat përkatëse dhe ne ruajtjen e dokumenteve;

ii) Ofruesi i shërbimit do të zhvillojë dhe do të mbajë të përditësuar manualët e administrimit dhe funksionimit lidhur me sigurimin e shërbimeve të tij dhe do të veprojnë në përputhje me këto manuale. Këto manuale do të përmbajnë të gjitha instruksionet e nevojshme, informacionin dhe procedurat për veprimet, gjithashtu dhe sistemin e administrimit për personelin operativ që të kryejë detyrat e tij;

iii) Ofruesi i shërbimit do të zbatojë dhe do të ruajë një sistem administrimi të bazuar në risk për të siguruar përputhje me kriteret bazë në këtë shtojcë dhe të kërkojë një zhvillim të vazhdueshëm proaktiv të sistemit;

iv) Ofruesi i shërbimit do të përdorë vetëm personel të kualifikuar dhe trajnuar në mënyrë të përshtatshme dhe do të zbatojë programe trajnimit dhe kontrolli për personelin;

v) Ofruesi i shërbimit do të krijojë ndërlidhje formale me të gjithë kontribuesit e tjerë të sigurimit të shërbimit për të garantuar përputhjen me të gjithë kriteret bazë;

vi) Ofruesi i shërbimit do të krijojë dhe do të zbatojë një plan alternativ që të mbulojë emergjencën



dhe situatat anormale që mund të ndodhin në lidhje me shërbimet e tij;

vii) Ofruesi i shërbimit do të krijojë dhe do të ruajë një program sigurie për parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve, një program të analizës dhe raportimit të rasteve, që do të përdoret nga sistemi i administrimit me qëllim kontributin në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë; dhe

viii) Ofruesi i shërbimit do të marrë masa për të verifikuar që kriteret e performancës së sigurisë të çfarëdolloj sistemi apo përbërësi me të cilët ata operojnë të përmbushen në çdo kohë.

b) Sigurimi i shërbimit KTA nuk do të ndërmerret në rast mospërmbushjeje të kushteve vijuese:

i) Parandalimi i lodhjes së personelit që siguron një shërbim KTA do të arrihet nëpërmjet një sistemi turnesh. Ky sistem turnesh ka nevojë të marrë parasysh periudhat e punës, kohën e punës dhe periudhat e përshtatshme të çlodhjes. Kufizimet e vendosura brenda sistemit të turneve do të marrin parasysh faktorët përkatës që kontribuojnë në lodhje të tillë si, në veçanti, heqja e gjumit, ndërprerja e cikleve biologjike 24 orësh (cirkadian), orari i natës, orari i grumbulluar i punës në periudha të veçanta, si edhe ndarja e detyrave të caktuara midis personelit;

ii) Parandalimi i stresit ndaj personelit që siguron një shërbim KTA do të arrihet nëpërmjet programeve të edukimit dhe parandalimit;

iii) Ofruesi i shërbimit KTA do të ketë të gatshme procedura për të verifikuar në mënyrë që gjykimi njohës i personelit që siguron shërbime KTA të mos dëmtohet ose gjendja e tyre shëndetësore të jetë e papërshtatshme;

iv) Ofruesi i shërbimit KTA do të do të marrë parasysh detyrimet operationale dhe teknike, si edhe parimet e faktorit njerëzor në planifikim dhe operatione.

c) Komunikimi, pilotimi dhe/ose sigurimi i shërbimit të mbikëqyrjes nuk do të ndërmerren në rast të mospërmbushjes së kushteve vijuese:

Ofruesi i shërbimit do të informojë përdoruesit përkatës të hapësirës ajrore dhe njësitë ATS në orare të përcaktuara për gjendjen operationale (dhe ndryshimet e saj) të shërbimeve të tyre të siguruar për qëllimet e KTA-së.

d) Organizatat e trajnimit

Një organizatë trajnimi që ofron trajnim për personelin që siguron një shërbim KTA do të përmbushë kriteret e mëposhtme:

i) Do të ketë mjetet e nevojshme për fushën e përgjegjësisë të lidhur me aktivitetin e tyre. Këto mjete përfshijnë, por jo vetëm: ambientet, personelin, pajisjet, metodologjinë, dokumentimin e detyrave, përgjegjësisë dhe procedurave, aksesin në të dhënat përkatëse dhe në ruajtjen e dokumenteve;

ii) Do të zbatojë dhe ruajë një sistem administrimi lidhur me sigurinë dhe standardin e trajnimit, dhe të kërkojë një përmirësim të vazhdueshëm të sistemit; dhe

iii) Do të marrë masa me organizata të tjera përkatëse, sipas nevojës, për të siguruar vazhdimësinë e përmbushjes së këtyre kriterëve bazë.

URDHËR

Nr. 33, datë 25.2.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KËRKESAT PËR VLERËSIMIN DHE ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE QË LIDHEN ME SIGURINË NË SHËRBIMET E TRAFIKUT AJROR”

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 78, pika 4, të ligjit 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kërkesat për vlerësimin dhe zbatimin e ndryshimeve që lidhen me sigurinë në shërbimet e trafikut ajror”; sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Udhëzimi nr. 22, datë 16.10.2008 “Për kërkesat dhe kushtet për vënien në zbatim të ndryshimeve të sistemit e MTA-së”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

RREGULLORE

MBI KËRKESAT PËR VLERËSIMIN DHE
ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE QË LIDHEN ME
SIGURINË NË SHËRBIMET E TRAFIKUT
AJROR

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i sigurisë së vazhdueshme të shërbimeve, si dhe vlerësimi i pavarur, në mënyrë që:

a) të gjitha ndryshimet në sistemet që përdoren për ofrimin e shërbimit të trafikut ajror janë vlerësuar nga ana e sigurisë;

b) të gjitha rreziqet janë reduktuar para implementimit të çdo ndryshimi; dhe

c) një vlerësim i tillë risku dhe zbutja, mbulojnë të tëra sistemet e menaxhimit të trafikut ajror gjatë gjithë jetëgjatësisë së atij sistemi.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Ndryshime që lidhen me sigurinë në shërbimin e trafikut ajror” nënkupton të gjitha ndryshimet që ndikojnë në mënyrën e operimit, ndryshimet që prekin pjesërisht apo tërësisht sistemet, si dhe ndryshime të tjera, siç janë procedurat e kontrollit të trafikut ajror dhe inxhinierike, pajisjet, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe dokumentacionin shoqërues, apo ndryshimet organizative ose futja e standardeve të reja në aviacion. Këtu përfshihen edhe ndryshimet në sisteme si ai i ndriçimit apo i komunikimit tokë-tokë.

2. “Ndryshime madhore” do të thotë një ndryshim që është përshkruar në pikën 1, i cili mund të paraqesë situata të rrezikshme të niveleve të rrezikshmërisë 1 ose 2 (sipas skemës së klasifikimit të rrezikshmërisë në shtojcën B, pjesë integrale e kësaj rregulloreje), si dhe futja e standardeve të reja në aviacion.

3. “Ndryshime minore (të vogla)” do të thotë një ndryshim që është përshkruar në pikën 1, i cili paraqet situata të rrezikshme të niveleve të

rrezikshmërisë 3, 4 ose 5, sipas skemës së klasifikimit të rrezikshmërisë në shtojcën B, pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

4. “AAC” është shkurtim i përdorur për të identifikuar Autoritetin e Aviacionit Civil

Neni 3

Detyrime për zbatimin

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, Autoriteti i Aviacionit Civil do të hartojë një procedurë të brendshme, e cila detajon të gjithë procesin e menaxhimit të një ndryshimi në mënyrë që të udhëzojë stafin që do merret me këtë proces.

2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore:

a) Duhet të hartojnë një procedurë të brendshme, e cila detajon të gjithë procesin e menaxhimit të një ndryshimi që do të zbatohet nga stafi përkatës. Kjo procedurë do të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

b) Do të caktojë një pikë kontakti që do të mbledhë dhe raportojë të gjitha ndryshimet brenda afateve dhe siç kërkohet në këtë rregullore.

Neni 4

Autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e ndryshimeve

Autoriteti i Aviacionit Civil është Autoriteti Kompetent për mbikëqyrjen e ndryshimeve.

Neni 5

Njoftimi i ndryshimeve

1. Ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të njoftojnë Autoritetin e Aviacionit Civil për të gjitha ndryshimet që planifikohen të kryhen.

2. Për të njoftuar ndryshimet pranë AAC-së, do të përdoret formulari i njoftimit të ndryshimeve sipas shtojcës A, pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Afatet e njoftimit të ndryshimeve

1. Për ndryshimet madhore, njoftimi pranë AAC-së duhet të kryhet që në fazën e planifikimit të ndryshimit, ose minimalisht 3 (tre) muaj para datës së vënies në zbatim të ndryshimit.



2. Për ndryshimet minore, njoftimi pranë AAC-së duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e aplikueshme, ose minimalisht 15 ditë para datës së vënies në zbatim të ndryshimit.

3. Në rast se një ndryshim minor kërkon vënie në zbatim në mënyrë të menjëhershme, afati për njoftim do të jetë minimalisht 3 (tre) ditë pas vënies në zbatim të ndryshimit.

Neni 7

Vlerësimi i ndryshimeve

1. Ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të kryejnë një vlerësim të ndryshimeve të planifikuara dhe në bazë të këtij vlerësimi duhet të bëjë një klasifikim të ndryshimeve në:

- a) ndryshime madhore;
- b) ndryshime minore.

2. Për të njëjtin ndryshim, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kryejë një vlerësim tjetër të pavarur nga ai i ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror apo nga palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore. Ky vlerësim ka prioritet nëse rezultatet e dy vlerësimeve nuk përputhen.

Neni 8

Ndryshimet madhore

1. Për ndryshimet madhore, ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të dorëzojnë pranë AAC-së, bashkëngjitur formularit të njoftimit të ndryshimit edhe:

- a) një koncept operacional;
- b) një plan tranzicional për vënien në zbatim të ndryshimit;
- c) një metodologji vlerësimi sigurie (sipas Eurocontrol-SAM ose ekuivalentin e tij), duke përfshirë:
 - metodën e identifikimit të situatës së rrezikshme;
 - identifikimin e vetë situatës së rrezikshme;
 - strategjinë e vlerësimit dhe zbutjes së rrezikut (Vlerësimin e Situatës Funksionale të Rrezikshme (FHA));

- Vlerësimi Paraprak i Sigurisë së Sistemit (PSSA);
- Vlerësimi i Sigurisë së Sistemit (SSA).

2. Autoriteti i Aviacionit Civil, pasi të ketë shqyrtuar të gjithë dokumentacionin, miraton dhe lejon kryerjen e ndryshimit.

3. Ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore nuk duhet të zbatojë asnjë ndryshim madhor pa marrë më parë pranimin nga AAC-ja.

4. AAC-ja, për të shqyrtuar sa më mirë një ndryshim të caktuar dhe në varësi të ndryshimit, mund të kërkojë informacione shtesë, të ndërmarrë inspektime apo auditime, si dhe mund të marrë pjesë gjatë procesit të testimeve të sistemit.

5. Në rast se AAC-ja nuk kthen përgjigje lidhur me njoftimet e marra për ndryshim për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së njoftimit, ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, mund të nisin implementimin e ndryshimit dhe kryerja e këtij veprimi, konsiderohet e miratuar nga AAC-ja.

Neni 9

Ndryshimet minore

Ndryshimet minore mund të zbatohen menjëherë nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, pas njoftimit të AAC nëpërmjet formularit të njoftimit të ndryshimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në përputhje me procedurat e miratuara nga AAC-ja.

Neni 10

Procedura speciale

Në rastet kur një ndryshim, madhor apo minor, është subjekt edhe i ndonjë rregulloreje tjetër, bashkëngjitur dokumentacionit referuar më sipër do të kërkohej nga AAC-ja edhe dokumentacioni që plotëson kërkesat e dala nga këto rregullore.



SHTOJCA A

NJOFTIMI I NDRYSHIMEVE QË LIDHEN ME SIGURINË NË SHËRBIMIN E TRAFIKUT AJROR

Kur një Ofrues Shërbimesh ka qellim të iniciojë një ndryshim në sistemet e tij, duhet të plotësojë formën e mëposhtme:

FORMA E NJOFTIMIT TË NDRYSHIMIT¹

IDENTIFIKIMI I NDRYSHIMIT
Ref. nr. dhe titullin

1. TË DHËNAT E ORGANIZATËS DHE PRANIMI				
Organizata				
Adresa				
Shërbimet/funksionet e ofruara	☐ ATS	☐ MET	☐ AIS	☐ CNS
	☐ ATFM	☐ ASM	☐ OTHER	
Data e certifikimit ²				
Menaxheri i Sigurisë së Korporatës				
Telefon				
E-mail				
Pika e kontaktit përkëtë ndryshim (nëse ka) ³				
Funksioni				
Telefon				
E-Mail				
Data				
Menaxheri i Sigurisë së Organizatës nënshkrimi ⁴				

¹Të plotësohet dhe dërgohet në Autoritetin Kombëtar të Mbikqyrjes për ndryshime në ofrimin e shërbimeve, të cilat mund të ndikojnë në përputhshmërinë me kërkesat e përbashkëta ose me kushtet bashkëngjitur me certifikatë ndryshimesh e lidhura me sigurinë, kushkalla e rrezikshmerisë është 1, 2, 3, 4 ose 5. Referuar Urdhërimit të Ministrit të Transporteve Nr. 115 datë 23.10.2012 "Për Miratimin e Rregullores mbi Kërkesat e Përbashkëta për Ofrimin e Shërbimeve të Lëndimit Ajror", Shtojca II, për një pjesë të tjetër të kësaj lëvizje të rrezikshmerisë.

²Për subjektet që ofrojnë shërbime ATFM ose ASM, datën e pranimit të procedurave të tyre të ndryshuara.

³Pikat e Kontaktit, ose Menaxheri i Sigurisë së Korporatës, nëse nuk është emëruar PeK, do të mbahet i informuar për tejgjatëshkëmbimet ndërmjet AKM/DMSHLA-së dhe organizatës.



2. PERMBLEDHJE E TE DHENAVE TE NDRYSHIMIT			
Përshkrim i shkurtër i ndryshimit			
Arsyet për dhe rezultatet e pritshme të ndryshimit			
Lidhje me ndryshime të tjera			
Lidhje me AKM-te të tjera ⁵			
A është i njoftuar ndryshimi i tanishëm, me parë?	☐ Jo	☐ Po	
Nëse po, identifikoj ndryshimet e rëndësishme që në njoftimin e fundit			
Shërbimet/funksionet që ndikohen	☐ ATS	☐ MET	☐ AIS
	☐ ATFM	☐ ASM	
Klasa e rrezikshmërisë së vlerësuar ⁶	☐ 1	☐ 2	☐ 3
	☐ 5	☐ E pacaktuar	
Faza e projektit aktual	☐ Përkufizimi i nocionit		☐ Projektimi
	☐ Zbatimi		☐ Hyrje në operim
	☐ Operacional		☐ Mospranim
	☐ Tjera:		
Data e pritshme përfundimit/prezantimit në shërbim, të ndryshimit			

⁴Kopjet e shtypura të këtij formulari do të firmosen nga Menaxheri i Sigurisë së Korporatës. Versionet elektronike të pafirmosura, janë pranuar, me kusht që ato janë dërguar nga Menaxheri i Sigurisë së Korporatës.

⁵Per ndryshimet që ndikojnë në shërbimet nderkufitare, njoftimi i ndryshimit, do të paraqitet në të gjitha AKM-te përkatëse dhe ato paralele. Kjo pjesë do të identifikojë qartë të gjithë AKM-te, të cilat janë ose do të njoftohen në lidhje me ndryshimin.

⁶Per shkallët e rrezikshmërisë 1, 2 dhe 3, një dokument do të sigurohet nga aplikanti si një shtojcë që tregon se si shkalla e rrezikshmërisë është vlerësuar. Autoriteti i Aviacionit Civil rezervon të drejtën për të verifikuar se si shkallët e tjera të rrezikshmërisë janë përcaktuar, gjatë çdo aktiviteti në vazhdim të siper. Çdo modifikim që del në vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë, mbi një ndryshim, do t'i komunikohet AKM-se, sa më shpejt që të jetë përcaktuar.



3. PËRGJEGJESITË KRYESORE

Udhëheqësi i projektit i ngarkuar për menaxhimin e përgjithshëm të ndryshimit.	
Emri	
Departamenti/njësia	
Telefon	
E-mail	
Menaxheri i sigurisë për ndryshimin (nëse ka)⁷	
Emri	
Departamenti/Njësia	
Telefon	
E-mail	

MATERIALE UDHËZUESE – FORMA E NJOFTIMIT TË NDRYSHIMIT

Të përgjithshme

Secilës prej pyetjeve në formular mund t'u jepet përgjigje në të njëjtën formë. Megjithatë, rekomandohet të ofrohen shtojcat përkatëse si dokumente të veçantë dhe të paraqitet një përmbledhje e shkurtër në dokument, së bashku me referencën e shtojcës së aplikuar (me detaje).

Pjesa 1: Të dhënat e organizimit dhe pranimit

Kjo pjesë do të identifikojë organizatën që paraqet njoftimin dhe pikën e kontaktit të organizatës.

Pjesa 2: Përmbledhje e të dhënave të ndryshuara

Kjo pjesë do të sigurojë një përmbledhje të ndryshimit të synuar. Gjithashtu do të konsiderohet edhe informacioni si më poshtë:

1. Përshkrim i shkurtër i ndryshimit, i cili përfshin një përmbledhje të ndryshimit. Përshkrimi më i detajuar duhet të përfshihet në materialin bashkëngjitur. Detajet mund të sigurohen përmes përshkrimit të konceptit operacional, specifikimet e prokurimit etj.

2. Argument i cili shpjegon përfitimet që sjell ky ndryshim, veçanërisht për një ndryshim që ndikon në sigurinë.

3. Njoftim për të gjitha AKM-të e përfshira në vlerësimin e ndryshimit, nëse ndryshimi ndikon në

sistemet e ATM-së që përdoren për ofrimin e shërbimit në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e dy ose më shumë AKM-ve.

Në rastet kur marrëveshjet e tjera kanë qenë njoftuar nga OSHLA-ja, njoftimi do të dërgohet te të gjitha AKM-te e përfshira dhe ky njoftim do të identifikojë AKM-të e tjera të përfshira në vlerësimin e ndryshimit. Në këtë rast, AKM-të sa më shpejt të jetë e mundur, do të koordinojnë rishikimet / vlerësimet me AKM-të e tjera, për të shmangur publikimin e punës.

4. Një përditësim i një vlerësimi të mëparshëm të një sistemi të njëjtë ATM, kryer nga OSHLA-ja, mbi bazën e të cilit do të përcaktohet shkalla e vlerësuar e rrezikshmërisë.

5. Njoftim paraprak përpara planifikimit të ndryshimit për AKM-në nga OSHLA-ja. P.sh. OSHLA-ja njofton ndryshimet e planifikuara. Kjo mundëson AKM-në të mbështesë OSHLA-në në sigurimin e kërkesave, planeve, proceseve etj. të cilat plotësojnë informacionin e duhur për AKM-në, që të arrijë një pranim.

Pjesa 3: Përgjegjësitë kryesore

Kjo pjesë do të ofrojë një identifikim të qartë të organizimit për zbatimin e ndryshimit, si dhe menaxherit të sigurisë së caktuar për të mbështetur zbatimin e këtij ndryshimi.

⁷ Personi që është përgjegjës për ofrimin e situatës së sigurisë dhe të gjithë aktivitetet të lidhura me të.



SHTOJCA B

SKEMA E KLASIFIKIMIT TË RREZIKSHMËRISË

Rreziqe			Probabiliteti për fluturime/ore				
			<i>S'ka objektiv</i>	<i>Objektiv 10⁻²</i>	<i>Objektiv 10⁻⁴</i>	<i>Objektiv 10⁻⁵</i>	<i>Objektiv 10⁻⁸</i>
			Çdo ditë	Një here në javë	Një here në muaj	Një herë në vit	Ka shumë mundësi mos të ndodhi asnjëherë- s'ka ndodhur asnjëherë deri tani gjatë kohës jetësore të sistemit
A s h p ë r s i a	Humbje totale e barrierave të Sigurisë	1	A1	A3	A6	B2	B4
	Humbje serioze e barrierave të Sigurisë	2	A2	A4	B1	C2	C6
	Humbje e madhe e barrierave të Sigurisë	3	A5	B3	C1	C5	D6
	Humbje e vogël e barrierave të Sigurisë	4	C3	C4	D1	D4	D7
	Efekt jo i drejtpërdrejt në Siguri	5	D2	D3	D5	D6	D8



Ndreqje gabimi

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 246, datë 19.3.2015, "Për ngarkimin e Gardës së Republikës së Shqipërisë për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrjen me qira financiare të automjeteve në dispozicion të disa funksionarëve publikë dhe Kryeministrit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 25 mars 2015, në faqen 1908, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen si më poshtë:

Lidhja nr. 1

LISTA

E INSTITUCIONEVE QË DO TË MARRIN ME QIRA FINANCIARE AUTOMJETE
NË DISPOZICION

Nr.	Institucioni (autoritet kontraktor)	Automjet në dispozicion të funksionarit publik	Automjet në dispozicion të aparatit të institucionit
1	Presidenca	2	-
2	Kuvendi	4	-
3	Kryeministria	8	14
4	Ministria e Punëve të Jashtme	1	--
5	Ministria e Mbrojtjes	1	-
6	Ministria e Punëve të Brendshme	1	-
7	Ministria e Integritetit Evropian	1	-
8	Ministria e Financave	1	-
9	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	1	-
10	Ministria e Zhvillimit Urban	1	-
11	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	1	-
12	Ministria e Arsimit dhe Sportit	1	-
13	Ministria e Drejtësisë	1	-
14	Ministria e Kulturës	1	-
15	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	1	-
16	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	1	-
17	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	1	-
18	Ministria e Shëndetësisë	1	-
19	Ministria e Mjedisit	1	-
	Gjithsej	30	14

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006